REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

# STRATEGJIA KOMBETARE E DIASPORES SHQIPTARE 2021 -2025

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

# KËSHILLI I MINISTRAVE

**MIRATUAR ME VENDIMIN NR.585 ,DATË 22.07.2020 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**



*Qëllimi për tu bërë varianti më i mirë i vetes fillon nga pranimi i realitetit. Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 është një parashikim për të ardhmen dhe si i tillë ai nuk vetëkufizohet nga frika e të bërit gabim.*

*Diaspora Shqiptare është e ditura e panjohur në raport me historinë kombëtare. Ajo ka brenda kurajon dhe qëllimet për t'i shërbyer vendlindjes pa zhurmë. Si e tillë, ajo është ende historia e pashkruar e kombit shqiptar.*

*Marrëdhënia e shtetit shqiptar me diasporën ka qenë e dyzuar midis mungesës së vëmendjes dhe pamundësisë. Kjo situatë ka pasur koston e vonesës por jo pamundësinë e korrigjimit.*

*E miratuar 2 vite më parë, Strategjia Kombëtare e Diasporës 2018 - 2024 ishte e para e llojit të vet në aplikim. Ajo e kishte parashikuar ndryshimin e vet. Pritshmëritë e aplikimit të saj u realizuan më shpejt se sa parashikohej. Samiti i Dytë i Diasporës Shqiptare i organizuar në mars të 2019 ishte fillimi i këtij diskutimi.*

*Me miratimin e Strategjisë së re, vetëlavdërimi do të ishte arsye për të mos parë dobësitë e natyrshme. Marrëdhënia me diasporën shqiptare është sfiduese pasi cilësitë e saj kanë tejkaluar provën e vlerësimit.*

*Dokumenti Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 është një vlerësim se cili do të jetë statusi shtetëror i marrëdhënies me diasporën shqiptare. Por, ai nuk do të jetë i fundit. Marrëdhënia me diasporën shqiptare shtrihet përtej përkufizimeve të njohura. Kufijtë janë zakone që presin të kapërcehen. Këtë na e kanë mësuar njerëzit të cilët ju kushtohet ky dokument.*

***Pandeli MAJKO***
*Ministër i Shtetit për Diasporën*

# TABELA E PERMBAJTJES

## STRATEGJIA KOMBETARE E DIASPORES


**HYRJE........................................................................................................ 7**

**I.MIGRIMI DHE DIASPORA SHQIPTARE.................................................................. 9**

1.1 PERIUDHAT E MIGRIMIT SHQIPTAR.......................................................... 9

**II. KUSHTET AKTUALE - STATUSI I DIASPORES SHQIPTARE.............................. 13**

2.1 VLERESIMI I GJENDJES.................................................................................. 13
2.2 FAKTORET E MIGRIMIT................................................................................. 14
2.3 FENOMENI I “RRJEDHJES SE TRURIT” ........................................................ 15
2.4 MIGRIMI DHE FQINJET.................................................................................. 16
2.5 FAKTORIZIMI SOCIAL DHE EKONOMIK....................................................... 21
2.6 ORGANIZIMI I DIASPORES............................................................................. 25
2.7 DIASPORA DHE INTEGRIMI NE BE.............................................................. 27
2.8 BASHKEPUNIMI I SHQIPERISE DHE KOSOVES.......................................... 27

**III. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE........................................ 29**

3.1 VIZIONI DHE MISIONI.................................................................................... 30
3.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE........................................................................... 30
3.2.1 RRJETET E DIASPORES ............................................................................... 31
3.2.2 INSTRUMENTE EFEKTIVE ........................................................................... 32
3.2.3 DIASPORA SHQIPTARE DHE ZHVILLIMI EKONOMIK.................................. 34
3.2.4 REMITANCAT – NGA KONSUMI NE ZHVILLIM........................................... 35
3.2.5 KAPITALI NJEREZOR DHE KULTUROR ........................................................ 38
3.2.6 RUAJTJA E IDENTITETIT KOMBETAR........................................................... 39
3.2.7 ARSIMI, EDUKIMI DHE MEDIA..................................................................... 39
3.2.8 ORGANIZIMI I KOMUNITETEVE SHQIPTARE JASHTE VENDIT ..... 40
3.2.9 KRIJIMI I NJE BAZE TE DHENASH PER ORGANIZATAT E DIASPORES.................................................................................................. 40
3.2.10 AVANCIMI I TE DREJTAVE TE DIASPORES ............................................. 41
3.2.11 VOTA DHE TE DREJTAT POLITIKE............................................................. 41
3.2.12 DIPLOMACIA PUBLIKE................................................................................ 42
3.3 SHTYLLAT KRYESORE TE STRATEGJISE DHE AKTIVITETET E CDO SHTYLLE.................................................................................................. 42

**IV. MARREDHENIET SHTETERORE ME DIASPOREN............................................. 45**

4.1 POLITIKA SHTETERORE DHE DIASPORA..................................................... 45

4.2 KESHILLI KOORDINUES I DIASPORES ........................................................ 45
4.3 NENKOMISIONI PARLAMENTAR PER DIASPOREN DHE MIGRACIONIN........................................................................................ 46
4.4 KOMITETI SHTETEROR PER DIASPOREN............................................ 46
4.5 AGJENCIA KOMBETARE E DIASPORES.............................................................. 47
4.6 FONDI SHQIPTAR PER ZHVILLIMIN E DIASPORES................................ 47
4.7 QENDRA E BOTIMEVE PER DIASPOREN....................................................... 47
4.8 QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PER ARBERESHET... 48
4.9 QENDRAT E KULTURES SHQIPTARE ........................................................ 48
4.10 SHERBIMET KONSULLORE DHE DIPLOMACIA.................................... 49

**V. BUXHETI DHE KOSTOT.................................................................................. 50**

**VI. ZBATIMI DHE MONITORIMI.......................................................................... 52**

6.1 MONITORIMI DHE VLERESIMI................................................................. 52
6.2 ANGAZHIMET KRYESORE PER PERIUDHEN 2021-2025.................. 52
6.3 FUNKSIONALITETI I ZHVILLIMIT DHE ZBATIMIT TE STRATEGJISE.................................................................................................. 54
6.4 ZBATIMI I STRATEGJISE............................................................................... 55
6.5 KULTURA ORGANIZATIVE DHE OPERACIONALE............................... 55
6.6 AUDITIMI DHE TRANSPARENCA.................................................................. 56

**PERFUNDIME.......................................................................................................... 56**

**PLANI I VEPRIMIT PER STRATEGJINE 2021 -2025............................................. 58**

**SHTOJCA I** – PLANI I VEPRIMIT TE STRATEGJISE KOMBETARE TE DIASPORES SHQIPTARE 2021 – 2025..................................................................... 60
**SHTOJCA II** – BURIMET E FINANCIMIT DHE AKTIVITETET..................... 97
**SHTOJCA III** – STRUKTURA E INSTITUCIONEVE SHTETERORE PER DIASPOREN........................................................................................ 151
**SHTOJCA IV** - RISHIKIMI I DOKUMENTIT NE PROCESIN E ZBATIMIT 158



# I. MIGRIMI DHE DIASPORA SHQIPTARE

# HYRJE

*Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021 - 2025 përcakton parimet e politikës shtetërore të Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e komuniteteve shqiptare të cilët jetojnë në vendet pritëse në mënyrë të ligjshme. Ajo synon të prodhojë një sintezë të përkushtimit kolektiv të shoqërisë shqiptare ndaj bashkëkombësve të vet, të cilët jetojnë jashtë vendit.*

*Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021 - 2025 nxit zhvillimin e politikave shtetërore për përfshirjen dhe kontributin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit në zhvillimin socio-ekonomik dhe politik të vendit të origjinës. Ajo synon të forcojë dhe lehtësojë marrëdhëniet e Shqipërisë me shtetet pritëse të Diasporës shqiptare.*

*Strategjia e konsideron Diasporën vlerë të shtuar të shoqërisë shqiptare dhe mbështet organizimin e komuniteteve shqiptare në botë me qëllim faktorizimin e tyre për përshpejtimin e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.*

*Dokumenti i Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare 2021 - 2025 kërkon rivlerësimin e arritjeve nga aplikimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024. Strategjia e re kërkon të përshtasë shtetin shqiptar me kushtet e reja të globalizmit dhe procesit të integrimit evropian.*

*Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021 - 2025 është vazhdim i aplikimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 – 2024, e cila u miratua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.259 datë 09.05.2018. Mbi bazën e kësaj të fundit u miratua një legjislacion i ri dhe institucione të reja të specializuara shtetërore.*

*Ngritja e strukturave të reja shtetërore për Diasporën shqiptare kërkoi në vazhdim aplikime praktike dhe të përshtatura me ndryshimet e legjislacionit. Kjo solli diskutimin e ndryshimeve përmirësuese të realizuara me Strategjinë e Re Kombëtare të Diasporës Shqiptare 2021 - 2025.*

*Diaspora është një term i njohur më shumë se 2500 vite më parë. Sot kjo fjalë mund të përcaktohet si "bashkësi migrantësh, që ruajnë lidhjet materiale apo sentimentale me atdheun, duke u adoptuar në mjedisin dhe institucionet e shoqërisë mikpritëse". Vlerësimi i "Diasporës" nuk e konsideron atë të pandryshueshme. Ajo përbëhet nga komunitete ku identiteti dhe cilësitë e të cilëve ndryshojnë me kalimin e kohës.*

*Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia (Lugina) janë hapësira, të cilat përfshijnë shtetet dërguese të shqiptarëve për migrim.*

*Diaspora shqiptare është një mundësi e madhe për zhvillimin e vendlindjes. Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021 - 2025 synon të mbështesë organizimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit, në mënyrë që të përmirësohet kapaciteti i Disaporës. Qëllimi është që ajo të mund të luajë rolin e një partneri të rëndësishëm strategjik për të ardhmen e vendlindjes. Ai do të realizohet me një proces rivlerësimi të marrëdhënies me Diasporën si një faktor i cili do të ushtrojë ndikimin e vet tek atdheu dhe anasjelltas.*

*Objektivi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 është që të prodhojë një kuadër të plotë për angazhimin e Diasporës. Ajo është hartuar në përputhje me Udhëzuesin e Bashkimit Evropian (BE) për Politikat dhe me standardet ndërkombëtare. Strategjia synon të krijojë mekanizma të cilat do të mbështesin komunitetet shqiptare në diasporë si edhe angazhimin bashkëpunues të institucioneve shtetërore.*

*Strategjia synon të hartojë strukturën e politikës shtetërore, të cilat jo vetëm e njohin kontributin e komuniteteve të ndryshme të Diasporës shqiptare, por edhe lehtësojnë dialogun me vendet pritëse për të promovuar marrëveshje dypalëshe në lidhje me Diasporën shqiptare.*

*Dokumenti i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 në prioritetet e veta trajton:*

*•Shkaqet dhe evolucionin e procesit migrator*
*•Vlerësimin e strukturës shtetërore për diasporën*
*•Faktorizimin social dhe politik të diasporës në shoqërinë shqiptare,*
*•Mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare në vendet pritëse,*
*•Organizimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit,*
*•Përmirësimin e shërbimeve konsullore nga strukturat e diplomacisë shqiptare.*
*Dokumenti i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 përbëhet nga dy pjesë:*

*1. Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe*

*2. Plani i Veprimit 2021 - 2025, që përfshin objektivat dhe masat kryesore që duhen zbatuar gjatë periudhës 2021 - 2025.*

*Përqasja dhe rishikimi i dokumentit strategjik do të jetë sipas kërkesave të Vendimit Nr. 290, dt.11.3.2020 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me Sistemin IPSIS.*
*Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i saj i Veprimit 2021-2025 u hartuan me kontributin e Grupit Ndërministror të Punës të kryesuar nga Ministri i Shtetit për Diasporën. Grupi Ndërministror i Punës u mbështet nga një ekip ekspertësh kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët u angazhuan nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në kuadër të programit "Angazhimi i Diasporës shqiptare për zhvillimin ekonomiko-social të Shqipërisë".*

*Në këtë dokument janë përfshirë kontributet dhe propozimet të bëra nga shoqëria civile apo individë të interesuar në procesin e diskutimit publik të tij.*

# I. MIGRIMI DHE DIASPORA SHQIPTARE

Diaspora shqiptare është e vjetër dhe tradicionale.

Komuniteti i parë i diasporës shqiptare daton kur rreth 200 000 njerëz migruan nga vendi i origjinës kur osmanët pushtuan tokat shqiptare në shekullin e XV-të. Komuniteti arbëresh në Itali është një prej diasporave më të vjetra shqiptare i cili ruan rrënjët e veta kulturore dhe gjuhësore. Kjo popullatë është pasardhëse e atyre familjeve shqiptare, të cilat udhëhiqnin Shqipërinë në shekullin e XV. Kur osmanët pushtuan trojet shqiptare ata u vendosën kryesisht në Mbretërinë e Napolit dhe zona të tjera në Itali.
Më vonë, shqiptarët filluan të lëviznin brenda territorit të perandorisë osmane, dhe mjaft prej tyre mbajtën pozita të rëndësishme administrative dhe ushtarake në vende të ndryshme të kësaj perandorie.

Diaspora me origjinë shqiptare e cila gjendet në Turqi është në një numër të konsiderueshëm dhe me status social. Për një kohë të gjatë ishte e rrezikshme të deklarohej prejardhja shqiptare, por në Turqinë e sotme, diaspora shqiptare është e respektuar. Historiografia turke çmon rolin e rëndësishëm që kanë luajtur shqiptarët në hierarkinë osmane, por edhe më vonë në kohën e themelimit të shtetit modern të Turqisë.

Migracioni për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës paraqet një komunitet të konsoliduar në kohë. Në vitin 2012, shoqata më e vjetër kulturore shqiptare “Vatra” festoi përvjetorin e saj të 100-të. Shoqatat shqiptare në SHBA ndihmuan bashkimin e emigrantëve shqiptarë, ruajtjen e ndjenjës kombëtare, hapjen e shkollave, botimin dhe shpërndarjen e librave shqip, mbështetën luftën për liri e pavarësi dhe kundërshtuan ndërkombëtarisht copëtimin e Shqipërisë.
Në Rumani, Kroaci, Bullgari, Ukrainë, Egjipt deri në Argjentinë ekziston një diasporë shqiptare, e cila edhe pse e vjetër ruan lidhjet gjuhësore dhe është në kërkim të identitetit të vet.

## 1.1 PERIUDHAT E MIGRIMIT SHQIPTAR

*Diaspora shqiptare është në procesin e “maturimit" të saj. Ajo është krijuar nga lëvizjet migratore dhe nga shpopullimet me forcë.*

*Lëvizjet migratore të vonëta të shqiptarëve identifikojnë tre faza të migracionit:*

1. *Vala e migrantëve para vitit 1944,*
2. *Diasporën më të vonshme të atyre të cilët u larguan nga vendlindja gjatë viteve 1945-1990*
3. *Migrimi pas rënies së komunizmit, pas vitit 1990.*

*Një kapitull i veçantë i migrimit të shqiptarëve janë edhe lëvizjet shpopulluese të shqiptarëve nga trojet e tyre. Ai më sistemiku për të cilin ekziston një bazë të dhënash të pjesshme është lëvizja nga Kosova në drejtim të Turqisë. Në Kosovë u realizuan tre periudhave të shpopullimit me forcë të shqiptarëve.*

-Periudha e parë ishte deportimi i shqiptarëve nga Kosova në vitin 1910, kur autoritetet serbe dëbuan 120.000 shqiptarë në Turqi.
-Periudha e dytë ishte gjatë viteve 1926-1938, kur rreth 400.000 migruan nën presion në Turqi.
-Periudha e tretë ishte pas Luftës së Dytë Botërore, në 1953-1966, kur rreth 400.000 shqiptarë u detyruan të migronin në Turqi nga Kosova.

Në Shqipërinë e vitit 1989, rreth 19.5% e popullatës i përkiste grup-moshës 15-24 vjeç. Izolimi politik i regjimit komunist dhe ideja e lirisë në Perëndim, u personifikuan si ide të lirisë së lëvizjes dhe migrimin drejt shteteve fqinje, kryesisht në Itali dhe Greqi. Lëvizja jashtë vendit shihej si një investim për të ardhmen dhe për një jetë më të mirë.

**POPULLSIA MESATARE VJETORE DHE DY KOMPONENTËT KRYESORË (SHTESA NATYRORE DHE MIGRACIONI NETO)**




**Burimi:** INSTAT, 2020

*Fig. 1: Popullsia mesatare vjetore dhe dy komponentët kryesorë (Shtesa Natyrore dhe Migracioni Neto), 2019*

Shqipëria ishte vendi me fluksin më të madh të migrimit në Evropë, sipas matjes së raportit mes migrantëve dhe popullsisë. Kjo fazë e migrimit mund të ndahet në katër periudha:

1.Vitet 1991-1992, e cila ishte tërësisht e pakontrolluar, kur përafërsisht 300 000 shqiptarë braktisën vendin.
2.Vitet 1992-1996, kur migruan (afërsisht sa në periudhën 1991-19920), kryesisht ilegalisht, përkundër përmirësimeve të përkohshme të ekonomisë dhe kontrollit më të mirë kufitar.
3.Vitet 1996-1997, si reflektim i krizës së rënies së skemave piramidale të kursimeve të një numri të konsiderueshëm njerëzish. Shqipëria u zhyt në anarki dhe shumë të tjerë u shpërngulën nga frika e dhuna.
4.Nga viti 2009 dhe në vazhdim, pas vendosjes së lëvizjes së lirë të shtetasve shqiptarë në zonën “shengen" të Bashkimit Evropian.

**NUMRI I IMIGRANTËVE, EMIGRANTËVE DHE MIGRACIONI (NETO)**




**Burimi:** INSTAT, 2020

*Fig. 2 Numri i imigrantëve, emigrantëve dhe migracioni (neto)*

Gjatë dekadës së parë së tranzicionit u shfaq një mungesë e kontrollit qeveritar mbi migrimin. Në fillim të viteve 2000, përafërsisht 25% e popullatës së përgjithshme, apo mbi 35% e fuqisë punëtore, kishte emigruar.

Aktualisht, diaspora shqiptare është e pranishme në shtetet e Bashkimit Evropian, Kanada, Australi dhe në Afrikë. Në shumicën e vendeve mikpritëse, shqiptarët kanë themeluar organizatat e tyre.

Migrantët shqiptarë të cilët u larguan nga vendlindja në vitet ‘90, u bashkuan me familjarët apo miqtë e tyre, të cilët jetonin jashtë vendit. Ata u organizuan edhe në rradhët e shoqatave shqiptare, që ekzistonin prej kohësh në shumë vende mikpritëse.

Migrimi është një sfidë e vështirë për institucionet shtetërore dhe shoqërinë shqiptare. Qëllimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare 2021 - 2025 është t’i sigurojë Shqipërisë një politikë gjithëpërfshirëse në standardet e Bashkimit Evropian dhe aplikimin e saj me standardet më të mira ndërkombëtare.

# II. KUSHTET AKTUALE
# STATUSI I DIASPORES SHQIPTARE

# II. KUSHTET AKTUALE - STATUSI I DIASPORES SHQIPTARE

## *2.1 VLERESIMI I GJENDJES*

Në vitin 2004 Shqipëria miratoi për herë të parë "Strategjinë Kombëtare të Migracionit 2005-2010". Ai ishte dokumenti i parë, që provoi të përfshijë interesat e shqiptarëve brenda edhe jashtë vendit në profilin e një politike shtetërore. Strategjia e parë shqiptare për migrimin e vitit 2004 kërkonte, që Shqipëria të konsiderohej vend i aftë për menaxhimin e rrjedhave të migrimit. Ajo u përgatit me financim të BE-së dhe përkrahur nga IOM-i. Pavarësisht dëshirës, synimi kishte pak të bënte me zhvillimin ekonomik të vendit.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2018-2024 u miratua me Vendimin Nr.259 datë 09.05.2018 të Këshillit të Ministrave. Ajo bëri vlerësimin e aftësive të administratës shqiptare në aplikimin e saj dhe në proces u vlerësuan masat dhe rekomandimet për zhvillimin e politikës shtetërore mbi këtë çështje.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025 është vazhdim i aplikimit praktik të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024. Ai është një dokument i cili trajton gjendjen e re të marrëdhënies shtetërore të Shqipërisë me fenomenin migrator dhe diasporën shqiptare.

Kompleksiteti i fenomenit të diasporës kërkon koordinimin e shumë institucioneve dhe organeve shtetërore. Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025 jep rekomandime të cilat do të koordinojnë punën e ardhshme të strukturave përgjegjëse shtetërore. Ai përcakton natyrën e dokumentit strategjik, si një strategji komplekse ndërdisiplinore.

Të njëjtën natyrë pune ndoqi edhe përgatitja dhe përpunimi i Planit Kombëtar të Veprimit 2021 - 2025 i cili është vazhdim i Planit Kombëtar të Veprimit 2018 - 2024. Ky dokument me strukturën e masave të veta, do të bëjë të mundur zbatimin praktik të Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare.

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024 në Kuvendin e Shqipërisë janë miratuar baza ligjore në funksion të politikës shtetërore për diasporën. Ata janë:

•Ligji Nr.115, datë 18.12.2017, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës"
•Ligji Nr.32, datë 07.06.2018, "Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës",
•Ligji Nr.16, datë 05.04.2018, "Për Diasporën",

Bazuar në legjislacionin e mësipërm janë krijuar agjencitë shtetërore të mëposhtme:
-Agjencia Kombëtare e Diasporës
-Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
-Qendra e Botimeve për Diasporën
-Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

Në bazë të legjislacionit të ri të miratuar u krijua për herë të parë, Këshilli Koordinues i Diasporës me 15 përfaqësues. Ata janë nga Bashkimi Evropian (6), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (3), Kanadaja (2), Britania e Madhe (2), Australia (1) dhe Turqia (1). Në takimet zyrtare të Këshillit Koordinues të Diasporës marrin pjesë Presidenti i Republikës, Kryeministri dhe ministrat përgjegjës për interesat e diasporës.

Strategjia Kombëtare e Diasporës Shqiptare 2021 - 2025 është një dokument dinamik, i cili e ka të nevojshëm ndjekjen, përshtatjen dhe monitorimin e vazhdueshëm të saj. Strategjia do të jetë një instrument i vlefshëm për agjencitë shtetërore dhe për qytetarët e interesuar dhe do të nxisë strukturat shtetërore, për realizimin e detyrimeve të parashikuara në të.

## 2.2 FAKTORET E MIGRIMIT

Njerëzit migrojnë kur në vendin e tyre mungojnë burimet dhe mundësitë për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e tyre. Termi "për një jetë më të mirë" përfshin disa faktorë të cilët i detyrojnë shqiptarët të largohen nga vendi. Kjo është e reflektuar në mungesën e njëtrajtshmërisë sociale ndërmjet migrantëve shqiptarë.

*Faktorët kryesorë të migrimit shqiptar janë kryesisht:*

•*Faktori ekonomik:* Shqiptarët janë larguar kryesisht për arsye ekonomike siç janë - mungesa e mundësive të punësimit, - kushtet e vështira të jetesës, veçanërisht në disa zona ku mungojnë kushtet elementare si energjia elektrike, uji dhe strehimi.

•*Siguria publike:* Shqipëria është përballur me flukse masive migratore si pasojë e nivelit të ulët të sigurisë publike apo trazirave në vend. Një numër i madh personash të kualifikuar, me kushte të mira ekonomike, janë larguar nga vendi për një të ardhme më të sigurt për veten dhe familjen e tyre. Kjo dukuri ka ndodhur veçanërisht pas trazirave të vitit 1997 dhe u shoqërua me një valë tjetër largimi.

•*Institucionet e dobëta* çojnë në mungesën e besimit te qytetarët për përmirësimin e situatës në vend, ku korrupsioni dhe krimi i organizuar paralizojnë funksionimin normal të institucioneve shtetërore. Institucionet e dobëta dhe vështirësitë në zbatimin e ligjit gjithashtu, ndikojnë në përpjekjet dhe perspektivat e emigrantëve për t'u kthyer dhe vendosur në vend, veçanërisht kur ata hasin vështirësi në ndërtimin e aktiviteteve private, apo në marrëdhënie me administratën publike.

•*Një rast i veçantë,* janë largimet për shkak të traditës së "gjakmarrjes", të cilat kanë një ngarkesë sociale dhe kulturore të veçantë në zonat veriore të vendit.

Arsyet e largimit kanë ndryshuar peshën me kalimin e kohës. Në një studim i cili tregon arsyet e largimit nga Shqipëria në vitin 2019, sipas INSTAT-it, vlerësohen në pesë kategori faktorët e largimit nga vendi.




*Fig. 3: Faktorët e largimit nga Shqipëria, 2019*

Ndër faktorët kryesorë të migrimit, në kushtet e lëvizjes së lirë në hapësirën e Bashkimit Evropian, mundësia për të punuar jashtë vendit zë vendin e parë. Ai kryeson me rastet e individëve të cilët janë larguar për motive punësimi (83.7%), faktori i bashkimit familjar (9%), i cili ndiqet nga mundësi studimi (3.5%) dhe së fundi arsye të tjera (3.8%).

Migrimi shqiptar nga vetë natyra e tij nuk mund të luftohet me masa represive, por kërkon masa parandaluese. Ato do të jenë të bazuara në shkaqet e migracionit nga një këndvështrim praktik. Ky qëndrim do të konsiderojë përputhjen e aplikimit të politikës shtetërore të Shqipërisë me Politikat e Përbashkëta Evropiane për Migracionin.

## 2.3 FENOMENI I "RRJEDHJES SE TRURIT"

Niveli i lartë i largimit nga vendlindja e njerëzve të kualifikuar është një karakteristikë e migrimit të shqiptarëve të Shqipërisë, krahasuar me shqiptarët nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia.

Në 1990, 40% e arsimtarëve dhe studiuesve u larguan nga Shqipëria. Në fillim të viteve 2000, rreth 60% e të diplomuarve në vendet perëndimore ose ishin larguar nga vendi ose nuk ishin kthyer pas diplomimit.

Shqetësues është fakti se pjesa më e madhe e profesionistëve të kualifikuar kanë gjetur punë në sektorë që ndryshojnë nga kualifikimi i tyre.

Fenomeni i "rrjedhjes së trurit" përfshin akademikët, personat e kualifikuar në fusha të ndryshme, si edhe një numër të konsiderueshëm studentësh shqiptarë që studiojnë në universitete të huaja. Nga Italia e Greqia, "truri" shqiptar i migrimit lëviz në drejtim të Kanadasë, SHBA-së, Gjermanisë, Britanisë së Madhe dhe vendeve të tjera të BE-së.

Në Shqipëri fenomeni "Brain Drain" është etiketuar në mënyrë simbolike si "fenomeni Kanada", duke qenë se politikat e emigracionit të qeverisë së këtij vendi pritës favorizojnë migrimin e njerëzve të kualifikuar. Largimi i personave të kualifikuar dhe të arsimuar nga vendlindja vlerësohet si një dëm i zhvillimit social-ekonomik të një vendi, pasi ata janë forca zhvilluese e çdo vendi.

Marrja e masave për të shmangur largimin e përhershëm të individëve të kualifikuar dhe të arsimuar kërkon nxitjen dhe promovimin e migracionit të përkohshëm, në veçanti të migracionit qarkullues të individëve të kualifikuar.

Qeveria e Shqipërisë synon të aplikojë kthimin vullnetar të emigrantëve të kualifikuar, të përhershëm ose të përkohshëm, nëpërmjet qëndrimeve afat-shkurtra për qëllime konsultimi, mësimdhënie apo trajnimi. Kësaj do t'i shërbejë edhe evidentimi i të gjithë kapaciteteve intelektuale që ndodhen jashtë vendit.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 do të nxisë përfaqësuesit e brezit të ri të talentuar jashtë vendit të tërhiqen drejt një karriere profesionale në vend. Një mundësi tjetër, do të jetë ofrimi i bursave për studime të mëtejshme jashtë vendit dhe krijimi i mundësive për pjesëmarrje në programe për shkëmbime eksperiencash me vendet e treta, me kushtin e detyrimit për t'u kthyer. Ky do të konsiderohet një investim për të ardhmen duke rritur nivelin e akademikëve të rinj. Për të siguruar mundësitë e kthimit të tyre, institucionet (dërguese) do të mbajnë marrëdhënie komunikimi me përfaqësuesit e diasporës së kualifikuar dhe do t'u ofrojnë atyre mundësi punësimi në atdhe.

## 2.4 MIGRIMI DHE FQINJET

Në përzgjedhjen e shtetit mikpritës, faktor kryesor për migracionin e ri shqiptar ishte afërsia gjeografike, kulturore dhe gjuhësore. Fqinjët si Greqia dhe Italia ishin destinacionet kryesore gjatë periudhës së viteve 1992-1995. Vendet e lartpërmendura janë parapëlqyer edhe për shkak të mundësive të pakta financiare për të zbatuar një projekt të kushtueshëm migrimi. Parapëlqimi i migrantëve shqiptarë për shtetet e tjera të Evropës Perëndimore, apo SHBA-së u kufizuan për shkak të gjendjes ekonomike dhe politikave të migrimit në këto vende.

Statistikat e migrimit janë ende të qarta në paqartësinë e tyre. Në vitin 2019, sipas vlerësimeve të tërthorta nga INSTAT, numri i diasporës së re llogaritet të jetë rreth 1,64 milionë shtetas jashtë vendit ose rreth 36% të shtetasve shqiptarë gjithsej, të cilët janë vendosur kryesisht në Greqi dhe Itali. Sipas të dhënave nga Peoplemov.in, në Greqi jetojnë 676.847 shqiptarë, ndërsa në Itali 522.647.

Nëse marrim për bazë të dhënat e "Peoplemov.in", i cili i referohet gjendjes së migracionit, mund të diskutohen këto të dhëna mbi Shqipërinë.




*Fig. 4: Të dhëna nga Peoplemov.in për Shqipërinë*

Italia për shqiptarët përbënte një vend ku kombinohen parapëlqimet kulturore dhe afërsia gjeografike. Jetesa nën regjimin komunist të vendit, kishte bërë që Italia të shihej si simbol i lirisë dhe Perëndimit. Transmetimet në radio dhe televizion ishin rrugët më të rëndësishme përmes së cilave shqiptarët në komunizëm ruanin lidhjet me Perëndimin. Italishtja ishte gjuha më e folur e huaj në Shqipëri ku arti dhe kultura italiane përbënin tërheqje të veçanta. Të gjithë këta faktorë ndihmojnë të kuptohet përse Italia ishte vendi më i kërkuar nga emigrantët shqiptarë. Në Itali numri i shqiptarëve në mesin e vitit 2005 ishte më i larti krahasuar me emigrantët e tjerë në atë vend, respektivisht 13,7% më shumë se rumunët dhe marokenët.

Greqia është shteti tjetër i cili është gjeografikisht i afërt me shqiptarët. Kalimi ilegal i kufirit greko- shqiptar nuk kërkonte shpenzime të mëdha financiare. Shtetasit e të dy vendeve gjithashtu ndajnë ngjashmëri të caktuara kulturore dhe historike. Edhe pse greqishtja nuk flitet në Shqipëri por vetëm në disa rajone jugore ku banon komuniteti grek, migrimi masiv në drejtim të këtij vendi ka përfshirë një numër të shtuar të shqiptarëve. Kjo solli rritjen e lartë të atyre që mund të flisnin greqisht, duke shkurtuar edhe distancën kulturore e gjuhësore mes dy vendeve fqinje.

Studiuesit e përshkruajnë migrimin nga Shqipëria si ekonomik dhe me një nivel të lartë parregullsie, me flukse emigrantësh pa dokumente dhe të zhvilluar shpejt e në mënyrë dinamike. Cilësi të veçantë migrimi shfaq (me shumë vajtje e ardhje) sidomos me Greqinë.

## NUMRI I EMIGRANTËVE, DHE EMIGRANTË PËR 1000 BANORË




*Fig. 5: Numri i emigrantëve, dhe emigrantë për 1000 banorë*

Instituti i Statistikave (INSTAT), në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës ka publikuar dy raporte vjetore, për vitin 2018 dhe për vitin 2019. Ato kanë ofruar të parin vlerësim statistikor zyrtar të Diasporës shqiptare dhe profilit të saj mbi karakteristikat bazë demografike dhe sociale. Në këto raporte, INSTAT ka kryer një vlerësim mbi numrin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, bazuar në krahasimin e dy popullsive, asaj të popullsisë banuese dhe regjistrit civil.

Në raportin e vitit 2018, INSTAT u bazua në numrin e popullsisë së regjistrit civil më 1 janar 2018. Sipas vlerësimit statistikor rezulton se në 1 janar 2018, 1,584,137 individë ishin jashtë territorit të Shqipërisë, ku 828,530 individë janë meshkuj dhe 755,607 janë femra.




**Burimi:** Raporti "Diaspora e Shqipërisë në shifra", 2019, INSTA

*Fig. 6: Numri i shtetasve shqiptarë jashtë vendit, 1 janar 2018*

Në Raportin vjetor të vitit 2019, INSTAT vlerësoi se gjatë këtij viti ka një rritje të numrit të diasporës shqiptare me rreth 3,6 %. Në këtë vlerësim, meshkujt në diasporë kanë patur një rritje më të madhe me rreth 4,1% nga femrat që e kanë rreth 3%..




**Burimi:** Raporti "Diaspora e Shqipërisë në shifra", 2019, INSTA

*Fig. 7: Numri i shtetasve shqiptarë jashtë vendit, 1 janar 2019*

Në vlerësimet e INSTAT do të shërbejë edhe plotësimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile me të dhëna për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një periudhë më të gjatë se tre muaj pa ndërprerje ose për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, në një vit kalendarik. Plotësimi i Regjistrit do të kryhet përmes identifikimit dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit.

Për këtë qëllim, janë miratuar Ligji Nr. 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe Vendimi Nr. 405, datë 04.07.2018 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave mbi detyrimin për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe procedurave përkatëse që ndiqen për këtë qëllim”

Lëvizshmëria e migrantëve që udhëtojnë shpesh mes vendlindjes dhe vendeve mikpritëse është normalizuar për shkak të procesit rregullues (të statusit juridik) në Itali dhe Greqi dhe lëvizjes së lirë pa viza. Ky proces ka krijuar diasporën shqiptare në këto vende e cila fokusohet në stabilizimin e statusit social dhe juridik në vendet mikpritëse për brezin pasardhës.

## 2.5 FAKTORIZIMI SOCIAL DHE EKONOMIK

Një cilësi dalluese e migracionit shqiptar është ndryshimi me shpejtësi i statusit social dhe ekonomik. Greqia dhe Italia janë një shembull i faktorizimit të komunitetit shqiptar të vendosur aty. Në këto vende por edhe në vende të tjera (kryesisht ne vendet e Bashkimit Evropian) po krijohen organizata bazuar në interesat e partive politike në Shqipëri. Ato kanë luajtur dhe luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e bashkatdhetarëve që të marrin pjesë në votimet elektorale (duke udhëtuar drejt Shqipërisë). Në disa parti politike përfaqësuesit e këtyre organizatave janë pjesë e strukturave drejtuese duke rritur influencën politike të migracionit në politikën shqiptare.

Migrantët shqiptarë në vendet e Bashkimit Evropian janë integruar në një shkallë të lartë në jetën sociale dhe ekonomike të vendit pritës. Në vite, ata kanë rregulluar statusin e tyre juridik dhe një pjesë e mirë e migrantëve shqiptarë në Itali dhe Greqi kanë marrë shtetësinë e këtyre vendeve. Duke ju referuar të dhënave të Institutit të Statistikave Italiane, në vitin 2019, llogaritet të ishin 428 332 shqiptarë me leje qëndrimi të rregullt në shtetin italian.

## Komuniteti shqiptar në Itali



**428 332**

Numri i shqiptarëve me leje qëndrimi të rregullt në Itali

### Arsyet e qëndrimit të migrantëve shqiptarë në Itali




Arsye familjare
66.6%

Arsye pune
24.6%

Arsye të tjera
8.8%

### Përbërja e popullsisë migrante në Itali 2019




**Burimi:** Ministria e Punës dhe Politikave Sociale (Itali), 2019

*Fig. 8: Të dhëna për komunitetin shqiptar në Itali*

Ndërkohë, në Greqi, sipas censusit të fundit, llogaritet të ishin 480 851 shqiptarë me leje qëndrimi të rregullt, duke qenë komuniteti më i madh i migrantëve në vend.




**Burimi:** Raporti "Migracioni në Greqi: Zhvillimet e fundit në 2019 dhe Autoriteti Helen i Statistikave (ELSTAT)

*Fig. 9: Të dhëna për komunitetin shqiptar në Greqi*

Sipas të dhënave nga EUROSTAT, shqiptarët zënë vendin e dytë në Bashkimin Evropian për numrin e shtetasve që marrin shtetësinë e një vendi të BE-së. Në vitin 2016 është shënuar dhe numri më i lartë (me 67 510 raste) i qytetarëve shqiptarë që kanë marrë shtetësinë e një vendi të Bashkimit Evropian.




*Fig. 10: Numri i qytetarëve shqiptarë që kanë marrë shtetësinë e një vendi të Bashkimit Evropian*

Me rregullimin e statusit juridik në shoqëritë pritëse, veçanërisht në Itali dhe Greqi por edhe në vende të tjera, migrantët shqiptarë po shkojnë drejt marrjes së një roli të natyrshëm. Votat e tyre po vlerësohen të rëndësishme në proceset elektorale vendase. Kjo po krijon mundësi për përfaqësimin e kandidatëve me kombësi shqiptare në strukturat politike dhe përfaqësuese të vendeve pritëse.

**KANDIDATËT SHQIPTARË NË ZGJEDHJET LOKALE NË DIASPORË DHE PARLAMENTIN EVROPIAN**



**Itali**
142 kandidatë

**Gjermani**
2 kandidatë

**Belgjikë**
17 kandidatë

**SHBA**
4 kandidatë

Ndryshimi social dhe faktorizimi politik i migracionit ka sjellë edhe ndryshime cilësore në marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet pritëse. Ky fenomen, veçanërisht në Itali dhe Greqi ka ndikuar dukshëm në forcimin e marrëdhënieve të Shqipërisë me këto dy vende. Ato janë ngritur në nivelin e partneritetit strategjik duke qenë një shembull se si migracioni dhe diaspora ndikon në marrëdhëniet bilaterale midis dy shteteve.

## 2.6 ORGANIZIMI I DIASPORES

Analiza e gjendjes aktuale tregon se diaspora shqiptare është shumë dinamike. Ajo gjendet në shumë shtete udhëheqëse të botës si në Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani, Greqi, Itali, Turqi, Zvicër, Norvegji, Suedi, Finlandë dhe Francë, por gjithashtu edhe në fuqitë e reja ekonomike siç është Kanadaja dhe Australia.

Diaspora shqiptare është gjithnjë më e organizuar, e arsimuar dhe e gatshme të mbajë kontaktet me vendet e origjinës. Remitancat konsiderohen si një kontribut i rëndësishëm i Diasporës. Niveli aktual i remitancave është i debatueshëm. Mbledhja e të dhënave të sakta është e vështirë pasi një pjesë e tyre transferohen përmes kanaleve informale, si për shembull me dërgesat e parave përmes të afërmëve dhe miqve. Për vlerësimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 interesi kryesor ka të bëjë me të ardhmen e këtyre të ardhurave.

Vlerësimi i organizatave shqiptare të diasporës dhe politikave të migrimit tregojnë për rolin në rritje që mund të luajë diaspora si një ndërmjetësuese mes vendeve mikpritëse dhe vendlindjes.

Organizatat e diasporës shqiptare në Perëndim, po përqendrohen edhe më shumë në mënyrën e organizimit më të mirë të tyre në vendet mikpritëse dhe përparësitë e tyre të brendshme. Ato po adresojnë situatën e anëtarëve të diasporës, të nevojave dhe kërkesave të tyre të ndërlidhura me pjesëmarrjen politike dhe të drejtat e punëtorëve të huaj, shtetësinë dhe të drejtat e komuniteteve fetare.

Një nxitje pozitive në këtë drejtim ishin edhe organizimi në funksion të interesave të diasporës shqiptare të Samitit të Parë (datat 18 - 20 nëntor 2016 në Tiranë) dhe Samitit të Dytë (28 shkurt - 2 mars 2019).

Në nivelin organizativ një ngjarje e rëndësishme ishte edhe krijimi për herë të parë i Këshillit Koordinues të Diasporës. Takimi i parë zyrtar i tij u zhvillua në Ditën Kombëtare të Diasporës, në datë 18.12.2019, në Tiranë. Ai përbëhet nga 15 përfaqësues, nga Bashkimi Evropian (6), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (3), Britania e Madhe (2), Kanadaja (2), Australia (1) dhe Turqia (1).

Cilësia kryesore e diasporës shqiptare është mobilizimi edhe përmes lobimit indirekt për të bindur qeverinë pranuese që të veprojë në favor të mbështetjes të shtetit të prejardhjes. Diaspora shqiptare është një lobiste e fuqishme pranë qeverive dhe institucioneve të vendeve pritëse në mbështetje të zhvillimit dhe demokratizimit të Shqipërisë, Kosovës dhe interesave shqiptare në rajon. Më konkretisht, një angazhim të tillë diaspora shqiptare e ka pasur në përpjekjet për pavarësinë, së pari të Shqipërisë e pastaj të Kosovës. Aftësitë reaguese kanë qenë më të mira se sa ato me të cilat mund të krijohet një vetorganizim më cilësor.

Migrimi mbetet një sfidë e vështirë për institucionet shtetërore dhe shoqërinë shqiptare. Qëllimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 është t'i sigurojë Shqipërisë një politikë gjithëpërfshirëse për diasporën në një linjë me orientimet e politikës së integrimit të Bashkimit Evropian dhe trajtimin e saj me standardet më të mira ndërkombëtare.

Strategjia Kombëtare mbështet migrantët që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në mënyrë të ligjshme. Ajo synon të prodhojë një sintezë të përkushtimit kolektiv të shoqërisë shqiptare ndaj bashkëkombësve të vet, që jetojnë jashtë vendit.

Strategjia Kombëtare nxit zhvillimin e politikave shtetërore për përfshirjen dhe kontributin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit në zhvillimin socio-ekonomik dhe politik të Shqipërisë. Ajo nuk mbulon çështjet që lidhen me shtetasit e huaj që jetojnë ose duan të jetojnë në Shqipëri.

Strategjia synon që nëpërmjet politikave të bashkëpunimit me komunitetet shqiptare në diasporë të forcojë dhe lehtësojë marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tyre pritëse.

Strategjia e konsideron Diasporën vlerë të shtuar të shoqërisë shqiptare dhe parashikon rritjen e aftësive të Qeverisë për politikëbërjen ndaj saj. Ajo mbështet organizimin e komuniteteve shqiptare në botë, në një diasporë të strukturuar, me qëllim faktorizimin e tyre në bashkëveprimin për përshpejtimin e zhvillimit të vendit.

## 2.7 DIASPORA DHE INTEGRIMI NE BE

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025 e vlerëson krijimin e diasporës dhe procesin e migrimit si dy “enë komunikuese". Migrimi ka qenë një temë e rëndësishme e reflektimit të politikave të Bashkimit Evropian gjatë viteve të fundit. Strategjia Evropiane 2021 dhe Programi i Stokholmit pranojnë potencialin e lartë dhe kontributin e madh të migrantëve për BE-në si edhe për ndërtimin e një ekonomie konkurruese dhe të qëndrueshme.

## 2.8 BASHKEPUNIMI I SHQIPERISE DHE KOSOVES

Shqipëria dhe Kosova supozohet të jenë ndër vendet më të varfra të Evropës. Por, ky vlerësim ndodh vetëm nëse shikohet në vlerat e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB). Këto vlera nuk e japin pasqyrën e plotë për forcën ekonomike të kombit shqiptar. Në mesin e pasurive të fshehura të këtyre dy shteteve, duhet të llogaritet edhe diaspora e madhe dhe e shpërndarë nëpër shumë vende të botës, e cila dërgon rregullisht remitanca, duke mbartur kështu përgjegjësi të rëndësishme për mirëqenien e vendlindjes dhe popullsisë së saj.

Strategjia Kombëtare e Diasporës parashikon një bashkëpunim të ngushtë me institucionet e shtetit të Kosovës për një rivlerësim të marrëdhënies me diasporën e përbashkët. Marrëveshjet në fushën e Diasporës midis dy shteteve kanë shërbyer si një hap cilësor në këtë drejtim. Ndërtimi i një Plani Veprimi të përbashkët do të ishte i rëndësishëm sa edhe i detyrueshëm.

Për një periudhë të shkurtër midis dy shteteve janë nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit për politikat e përbashkëta për diasporën shqiptare si më poshtë:

1. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për bashkëpunimin në fushën e diasporës”, nënshkruar në datën 27.11.2017.
2. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për Qendrat Kulturore në Diasporë”, nënshkruar në datën 27.11.2017.
3. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës “Për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës”, nënshkruar në datë 26.11.2018.

Të dyja shtetet do të vlerësojnë nivelin e përbashkët të bashkëpunimit edhe me Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë për të koordinuar me institucionet përgjegjëse të tyre, rast pas rasti, të drejtat e diasporës shqiptare në vendlindje.
Bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Kosovës do të vlerësohet për tu zgjeruar në nivel rajonal. Synimi do të jetë shkëmbimi i eksperiencave më të mira në trajtimin e temave të përbashkëta të cilat kanë lidhje me diasporën.

# III. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

# III. VIZIONI, MISIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

## 3.1 VIZIONI DHE MISIONI

Me Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 është paraqitur qëllimi i institucioneve shtetërore për të pasur një marrëdhënie të re cilësore për angazhimin dhe përfshirjen e diasporës.

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 ka për synim rivlerësimin e angazhimit të diasporës duke u bazuar në strukturën e marrëdhënieve aktuale të shtetit shqiptar me diasporën. Vizioni parashikon angazhimin e komuniteteve të shqiptarëve në diasporë duke kuptuar si interesat e zhvillimit ekonomik të vendit, ashtu edhe rëndësinë e ruajtjes së identitetit kombëtar.

Misioni i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 është fuqizimi i rolit të diasporës shqiptare në zhvillimin ekonomik të vendit dhe me ekspertizë profesionale.

Vlera themelore e këtij dokumenti është krijimi i partneritetit të besueshëm ndërmjet diasporës dhe institucioneve shtetërore të Shqipërisë. Në këtë dokument gjenden angazhimet për ndryshime të politikave dhe praktikës shtetërore për forcimin e marrëdhënies ndërmjet diasporës shqiptare dhe Republikës së Shqipërisë.

## 3.2 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025 përqendrohet në një strukturë objektivash strategjikë të cilët ndihmojnë në fokusin e aktiviteteve që do të organizohen nëpërmjet Planit të Veprimit 2021-2025.

Për objektivat strategjikë të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 është marrë parasysh nevoja për të realizuar një marrëdhënie të rregulluar institucionale në angazhimin e diasporës shqiptare, si edhe përcaktimi i komponentëve kyçë tematikë dhe operacionalë për zbatimin e strategjisë.

Objektivat kryesorë të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 janë:

- Përshtatja e ndryshimeve ligjore me nivelin e politikëbërjes
- Koordinimi i administratës shtetërore për nivelin e ri të politikës shtetërore për diasporën
- Angazhimi i strukturave shtetërorë të krijuara për të përmirësuar dhe fuqizuar bashkëpunimin me komunitetet shqiptare në diasporë.

## 3.2.1 RRJETET E DIASPORËS

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025 do të mbështesë rrjetet ekzistuese të organizimeve të komuniteteve shqiptare në diasporë. Synimi është të nxitet krijimi i rrjeteve profesionale të diasporës për të mbështetur aktivitetet në funksion të qëllimeve të strategjisë. Krijimi dhe forcimi rrjeteve profesionale do të ndihmojnë në realizimin e aktiviteteve të parashikuara në funksion të Planit të Veprimit të Strategjisë.

Zhvillimi i rrjeteve funksionale të biznesit, të mësuesve, të mjekëve, të shkrimtarëve, të mediave, të avokatisë dhe rrjeti i angazhimit të grave do të inkurajohen. Rrjetet profesionale janë vlerësuar si mekanizma partneriteti nëpërmjet së cilave strukturat shtetërore dhe diaspora mund të bashkëpunojnë për të sjellë ndryshime progresive.

Ndërtimi i rrjeteve profesionale në diasporë përfshin edhe planifikimin dhe zbatimin e fushatave të informimit dhe të rritjes së ndërgjegjësimit për:

1. Regjistrimin e migrantëve për votim dhe të drejtën e votës (pas miratimit në Kuvend);
2. Mbrojtjen e identitetit dhe kulturës shqiptare në komunitetet shqiptare të diasporës;
3. Organizimin e informacionit për çështje me interes profesional apo që kanë të bëjnë me zhvillimet e fundit politike, sociale dhe ekonomike në vendin e origjinës.

Me qëllim regjistrimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, është miratuar Ligji Nr. 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” dhe Vendimi Nr. 405, datë 04.07.2018 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave mbi detyrimin për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe procedurave përkatëse që ndiqen për këtë qëllim”.

Në funksion të organizimit të rrjeteve profesionale në diasporë janë miratuar:
- Vendimi Nr.321, datë 15.05.2019 i Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë” dhe zbatimin e ti nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”
- Vendimi Nr.339, datë 06.06.2018 i Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së çmimit “Ambasador i Kombit”

Në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021-2025 parashikohet krijimi i rrjeteve të qëndrueshme të bashkëpunimit me organizata dhe institucione të ndryshme dhe me shoqërinë civile në vendin pritës dhe në Shqipëri. Me anën e çmimit “Ambasador i Kombit” është menduar krijimi i një grupi profesionistësh cilësor edhe si protagonistë të rrjeteve të profesionistëve në diasporë.

## 3.2.2 INSTRUMENTE EFEKTIVE

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025 do të synojë të plotësojë bazën e duhur të instrumenteve efektivë administrativ ose jo, për të realizuar objektivat e saj.

Jashtë vendit këto instrumenta do të shoqërohen me mbështetjen për organizatat shqiptare të diasporës për të krijuar edhe struktura këshillimore vendore në ato qytete apo zona ku janë të përqendruar migrantët shqiptarë. Kjo do të kryhet sipas udhëzuesit të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale dhe Këshillit të Europës. Synimi tjetër do të jetë që nëpërmjet këtyre strukturave ata të kenë mundësi të lobojnë për mbrojtjen e interesave të tyre psh. për marrëveshje dypalëshe për mbrojtjen sociale të migrantëve me vendet pritëse, në mënyrë që migrantët të mund të transferojnë sigurimet shoqërore në vendin e origjinës.

Në bazë të Ligjit Nr.16, datë 05.04.2018 "Për diasporën" u miratua Vendimi Nr.470, datë 26.07.2018 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrave Kulturore për Diasporën". Ato do të jenë nxitëse të një cilësie të re në marrëdhënien shtetërore me komunitetet shqiptare në diasporë.

Me Vendimin Nr.780, datë 06.11.2019 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi" ka filluar edhe trajtimi me persona përgjegjës në trupat diplomatike të marrëdhënies me diasporën.

Brenda vendit krijimi i instrumentave administrativë do të jetë në zbatim të legjislacionit të ri të miratuar dhe do të zhvillohen sipas kërkesave të praktikës së marrëdhënieve me diasporën shqiptare.

Në pushtetin lokal me Ligjin Nr. 38/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" pranë çdo bashkie të vendit do të ngrihet struktura administrative për diasporën dhe migracionin në bashkitë e vendit. Ato do të ofrojnë shërbime dhe informacion për të interesuarit.

Në funksion të këtij ndryshimi ligjor u nënshkrua Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Shoqatës për Autonominë Vendore "Për bashkërendimin e punës për ngritjen e strukturës administrative për diasporën dhe migracionin në qeverisjen vendore", nënshkruar në datë 01.06.2020.

Gjithashtu, u miratua Vendimi Nr. 456, datë 10.06.2020 i Këshillit të Ministrave "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për çështjet, objekt konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

Sipas këtij vendimi, pjesë përbërëse e Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore do të jenë edhe përfaqësues nga Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen.

*Për arsimin dhe mbrojtjen e identitetit* me Ligjin Nr. 48/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ministria përgjegjëse për arsimin krijon regjistrin shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë, si dhe pajis me certifikatë nxënësit pas përfundimit të programit të mësimit të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare në diasporë. Në zbatim të këtij ndryshimi ligjor u miratua Vendimi Nr.104, datë 28.02.2019 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve për krijimin e regjistrit shtetëror të mësuesve të gjuhës shqipe e të kulturës shqiptare dhe dhënien e certifikatës për nxënësit në diasporë".

Në bazë të Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës "Për kurrikulën e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë", nënshkruar në datë 31.05.2018 ka filluar puna e Komisionit të Përbashkët nën koordinimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën.

Për të ndjekur çështjet e arsimit në diasporë janë emëruar dy koordinatorë në nivel zëvendësministri:

- Urdhri Nr.32, datë 10.2.2019 i Kryeministrit "Për një ndryshim në Urdhrin Nr.47, datë 18.02.2019, të Kryeministrit, "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për programet/donatorët të cilët ofrojnë bursa studimi për jashtë vendit" – Koordinatori Shtetëror është caktuar një nga zëvendësministrat e arsimit, sportit dhe rinisë.
- Urdhri Nr.112, datë 30.08.2019 i Kryeministrit "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për realizimin e programit "Jam shqiptar" të gjuhës dhe kulturës shqipe"- Koordinatori Shtetëror është caktuar një nga zëvendësministrat e arsimit, sportit dhe rinisë.

Për të vendosur rregullat e trajtimit të informacionit në arsimin e lartë u miratua Vendimi Nr. 504, datë 24.06.2020 i Këshillit të Ministrave"Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë". Sipas këtij vendimi, baza e të dhënave do të administrohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

*Për çështjen e sigurimeve shoqërore* do të synohet të bëhet edhe një rivlerësim i mënyrës së llogaritjes apo mbledhjes së kontributeve dhe, nëse do të jetë e nevojshme, edhe nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave. Do të kryhet edhe një vlerësim i një Plani të posaçëm Veprimi për pensionet e migrantëve shqiptarë. Në këtë të fundit do të synohet ndihma për personat vulnerabël të Diasporës shqiptare nëpërmjet asistimit, brenda mundësive, të avokatisë dhe të informimit. Për këtë çështje ka dalë edhe Urdhri Nr.43, datë 12.02.2019 i Kryeministrit "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e sigurimeve për shtetasit shqiptar jashtë vendit" – Si koordinator shtetëror është caktuar zëvendësministri për Evropën dhe punët e jashtme.

Me miratimin e Ligjit Nr.1/2020 "Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit Nr. 10, datë 18.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për disa shtesa në ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat"", të ndryshuar, u përjashtuan nga tatimi mbi të ardhurat nga pensionet dhe shpërblimet e tjera të ngjashme të shtetasve të huaj me origjinë shqiptare apo të atyre nga vendet e Bashkimit Evropian, me leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të shtetasve të huaj që kanë marrë shtetësinë shqiptare e janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë dhe që i përfitojnë këto të ardhura sipas legjislacionit të vendit ku përfitojnë pensionin apo shpërblimet e tjera të ngjashme.

*Në fushën e biznesit* dhe ekonomisë u financua krijimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës edhe në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës "Për bashkëpunimin, nxitjen e biznesit dhe informimin e diasporës", nënshkruar në datë 26.11.2018. Ajo u realizua me Vendimin Nr. 514, datë 19.07.2019 të Këshillit të Ministrave "Për financimin e projektit "Për Dhomën e Biznesit të Diasporës – krijimi dhe nxitja e investimeve të diasporës në Shqipëri", dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës". Ajo u zyrtarizua me Vendimin Nr. 6378, datë 12.11.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës. Marrëveshja me Kosovën parashikon edhe krijimin e Bankës së Diasporës.

Për të ndihmuar dhe nxitur marrëdhënien me biznesin po ashtu janë miratuar:

- Urdhri Nr.44, datë 12.02.2019 i Kryeministrit "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për organizimin e Programit Vjetor të Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare"- Koordinator Shtetëror u caktua zëvendësministri i turizmit dhe mjedisit.
- Urdhri Nr.78, datë 17.04.2019 i Kryeministrit "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për marrëveshjet shtetërore në fushën e njohjes së lejeve të drejtimit të automjeteve për shtetasit shqiptarë jashtë vendit". Koordinator shtetëror u caktua zëvendësministri i infrastrukturës dhe energjisë.

*Për personat të cilët vuajnë heqjen e lirisë* jashtë vendit është firmosur Memorandumi i mirëkuptimit midis Ministrit të Shtetit për Diasporën, Ministrisë së Drejtësisë dhe Kryqit të Kuq Shqiptar, në datë 06.12.2017. Në funksion të kësaj çështjeje ka dalë Urdhri Nr.92, datë 17.05.2019 i Kryeministrit "Për ngritjen e grupit të punës dhe caktimin e personit përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që vuajnë heqjen e lirisë jashtë vendit, të drejtave të migrantëve nëpërmjet informimit mbi mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare". Drejtues i këtij grupi pune është caktuar zëvendësministri i drejtësisë.

*Në fushën e informimit* ka dalë Urdhri Nr.36, datë 13.02.2020 i Kryeministrit "Për një ndryshim në Urdhrin Nr.45, datë 12.02.2019, të Kryeministrit, "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për informimin e diasporës". Koordinatori Shtetëror është caktuar drejtori i sistemeve E-gov pranë AKSHI-t. Ai do të koordinojë dhënien e informacionit për komunitetet shqiptare në diasporë nga faqet zyrtare të institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Një rëndësi të veçantë ka pasur fillimi i botimeve vjetore nga Banka e Shqipërisë dhe Instituti i Statistikave (INSTAT) si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare. Ato do të jenë të përvitshme duke shënuar një hap cilësor në informacionin zyrtar për diasporën shqiptare.

Raportet vjetore të Bankës së Shqipërisë kanë qenë për vitin 2018, "Remitancat: Një mbështetje për zhvillim, 2018" dhe për vitin 2029, "Diaspora dhe Pagesat, 2019" .

Raportet vjetore të Institutit të Statistikave (INSTAT) janë si më poshtë për vitin 2018, "Diaspora e Shqipërisë në shifra 2018" dhe për vitin 2019 "Diaspora e Shqipërisë në shifra 2019".

## 3.2.3 DIASPORA SHQIPTARE DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

Përfshirja e Diasporës shqiptare në zhvillimin ekonomik të vendit në Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 do të përqendrohet kryesisht në:

1. Forcimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës;

1. Zhvillimin e një kuadri ligjor për investimet nga diaspora shqiptare;

2. Realizimin e një strukture të rrjeteve të profesionistëve të diasporës shqiptare.

Qëllimi do të jetë të inkurajohen investimet e diasporës, krijimi i ndërmarrjeve të vogla e të mesme në disa fusha, përfshirë bujqësinë, industrinë e ushqimit dhe zhvillimin e zonave rurale. Kjo do të realizohet duke krijuar një klimë të favorshme për investimet nga diaspora nëpërmjet aktiviteteve për stimuj fiskalë, shpërndarje informacioni, duke ulur korrupsionin dhe risqet, apo duke përmirësuar elementë të tjerë nxitës.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 është hartuar duke marrë parasysh pjesëmarrjen aktive të aktorëve të cilët nevojiten për të siguruar klimën që lehtëson dhe favorizon investimet në vendin e origjinës. Ky komponent do të realizohet duke bashkëpunuar me strukturat përgjegjëse në Republikën e Kosovës. Qëllimi do të jetë në hartimin e një plani të përbashkët institucional e cila do të nxisë pjesëmarrjen e diasporës në procesin e zhvillimit ekonomik të vendlindjes.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 synon harmonizimin e planeve vendore dhe atyre sektoriale zhvillimore të cilat zbatohen nga ministritë e linjës, duke i dhënë diasporës një vlerë të shtuar në zhvillimin ekonomik. Përfshirja e diasporës në këtë kontekst do të realizohet në përputhje me synimet dhe interesat e vetë komunitetit të diasporës.
Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 do të inkurajojë bashkërendimin dhe organizojë aktivitete të ndryshme, si "Ditët e Shqipërisë" në vendet pritëse ku gjendet duke u mbështetur në një program vjetor që promovojnë turizmin shqiptar dhe lehtësojnë investimet në vend. Ky është synimi i Urdhrit Nr.44, datë 12.02.2019 të Kryeministrit "Për caktimin e Koordinatorit Shtetëror për organizimin e Programit Vjetor të Aktiviteteve për Diasporën Shqiptare".

## 3.2.4 REMITANCAT – NGA KONSUMI NË ZHVILLIM

Në Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 dërgesat e migrantëve do të konsiderohen si një nga instrumentet e rëndësishme të zhvillimit socio-ekonomik të vendit.

Remitancat, ose dërgesat në para të migrantëve drejt vendlindjes, kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Ato janë përdorur kryesisht për konsumin e përditshëm të familjeve shqiptare. Me anën e dërgesave në para nga migrantët familjet kanë përmbushur nevojat për ushqim, veshmbathje, ilaçe, apo për ndërtimin e shtëpisë.
Shqipëria renditet në listën e vendeve me varësi të lartë tek remitancat, siç njihen ndryshe dërgesat në para. Remitancat përfaqësojnë rreth 9-15% të PBB-së së vendit dhe rreth 15% e të ardhurave të familjeve shqiptare.

## TENDENCA E REMITANCAVE NE VITE




**Burimi:** Banka e Shqipërisë 2019

*Fig. 12: Dinamika e dërgesave në para të migrantëve shqiptarë, 2002-2019*

Dinamika e të ardhurave nga remitancat në Shqipëri ka kaluar tre faza:

1. Rritjen e tyre nga viti 1991 deri në vitin 2007;
2. Rënien në periudhën 2008 - 2013; dhe
3. Ripërtëritjen që prej vitit 2014.

Remitancat vazhduan të rriteshin nga viti 1991 deri në vitin 2007, ku ato arritën nivelin e tyre maksimal. Në vitin 2007, në Shqipëri vlera e prurjeve monetare të remitancave ishte 952 milionë euro. Kjo e bënte atë vendin me varësinë më të madhe ndaj dërgesave në para në rajon, me më shumë se 300 euro për banor. Pas këtij viti, remitancat ranë duke arritur pikën e tyre më të ulët në vitin 2013 në shifrën nën 500 milion euro. Kjo rënie shkaktoi rritje të varfërisë në Shqipëri.
Sipas të dhënave nga Banka Botërore, remitancat u rritën sërish në vitet 2018 – 2019, duke shënuar vlerën 1455 milion dollarë në vitin e fundit.




**Burimi:** Banka Botërore, Prill 2020

*Fig. 13: PERFORMANCA E DËRGESAVE NË PARA NË PERIUDHËN 1992-2019*

Varësia e lartë e Shqipërisë tek remitancat kërkon menaxhim strategjik në trajtimin ekonomik të tyre. Ekzistojnë modele suksesi për të ndërthurur në ekonomi të ardhurat e remitancave me burime të tjera zhvillimi, si tregtia apo investimet e huaja të drejtpërdrejta. Orientimi i dërgesave të remitancave drejt mekanizmave formalë rrit transparencën dhe promovon sistemin bankar duke rritur fuqinë e tregut të remitancave. Në Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 parashikohet promovimi i transfertave me kosto më të ulët nëpërmjet kanaleve formale, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare dhe qeveritë e vendeve pritëse.
Në funksion të koordinimit të politikave shtetërore për remitancat është nënshkruar në datë 11.12.2017 Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Bankës së Shqipërisë, Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Banka e Shqipërisë ka filluar publikimin e Raporteve Vjetore:
- "Remitancat: Një mbështetje për zhvillim, 2018"
- "Diaspora dhe Pagesat, 2019"

Strategjia Kombëtare për Diasporën 2021 - 2025 parashikon në vazhdim bashkërendimin në nivel kombëtar të institucioneve përgjegjëse shtetërore për të koordinuar një plan veprimi të përbashkët për remitancat, i cili do parashikojë:

1. Identifikimin e praktikave më të mira për dërgesat në para në kanalizimin e remitancave në sistemin bankar dhe vlerësimin e hapave praktike që ato të përdoren për zhvillimin e ekonomisë së vendit;
2. Shtrirjen e shërbimeve bankare dhe përmirësimi i tyre nga bashkëpunimi ndërmjet degëve të bankave shqiptare dhe simotrave të huaja për remitancat;
3. Zgjerimin e kapaciteteve të institucioneve të tjera financiare dhe të Postës Shqiptare për të përmirësuar shërbimin e transfertave të dërgesave në para.

Në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit për Remitancat ka nisur realizimi i aktiviteteve vjetore në Bankën e Shqipërisë ndërmjet Guvernatorit të Bankës dhe Ministrit të Shtetit për Diasporën me përfaqësues të sistemit bankar privat në Shqipëri. Ato janë zhvilluar në datën 11.12.2017 dhe në datën 14.12.2018.

## 3.2.5 KAPITALI NJERËZOR DHE KULTUROR

Diaspora shqiptare ka të grumbulluar një kapital të konsiderueshëm jomonetar, në formën e kapitalit human, social dhe kulturor. Ai lidhet me njohuritë e shprehitë profesionale dhe kulturën e punës që migrantët kanë fituar gjatë punës, studimit dhe jetesës në vendet pritëse. Kapitali social ka të bëjë me vlerat sociale që fitojnë migrantët gjatë qëndrimit në vendin pritës. Kapitali kulturor vlerëson vlerat kulturore që fitojnë migrantët, të cilat shërbejnë për të forcuar bashkëjetesën kulturore midis vendeve pritëse dhe dërguese.

Diaspora mund të japë një kontribut të vlefshëm për Shqipërinë jo vetëm duke u kthyer fizikisht në vend, apo duke transferuar kapitalin e vet financiar, por edhe nëpërmjet lidhjeve që ata kanë, apo nëpërmjet njohurive dhe aftësive që ata kanë përfituar. Vlerësohet se shumë profesionistë të kualifikuar nga komunitetet shqiptare mund të ndajnë njohuritë dhe përvojën e tyre me personat që jetojnë në Shqipëri, edhe me anë të kthimit të përkohshëm në Shqipëri.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 do të përkrahë praktikën e “ftesave të hapura” për projekte që promovohen brenda diasporës. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës do të inkurajojë profesionistë të ndryshëm nga diaspora që të aplikojnë në projekte të ndryshme duke bërë të mundur kështu transferimin e njohurive dhe të praktikave më të mira.

Në vlerësim të angazhimit të profesionistëve në diasporë Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës është angazhuar në projektin “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë”, miratuar me Vendimin Nr. 321, datë 15.05.2019 të Këshillit të Ministrave “Për financimin e projektit “Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë” dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”.

Një pjesë e rëndësishme e kapitalit intelektual në diasporë janë edhe studentët shqiptarë apo me origjinë shqiptare që studiojnë jashtë vendit, të cilët përmes njohurive dhe formimit profesional që përfitojnë nga studimet e tyre mund të jenë një forcë kontribuese për vendin e origjinës. Me qëllim identifikimin dhe krijimin e një regjistri të studentëve që studiojnë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, u miratua Vendimi Nr. 504, datë 24.06.2020 i Këshillit të Ministrave“Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”. Sipas këtij vendimi, baza e të dhënave do të administrohet nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 do të kryejë një rivlerësim të bashkëpunimit me donatorët dhe me programet e modelit “Brain Gain” ose “Rikthimi i Trurit” me synim krijimin e strukturave institucionale që bëjnë të mundur tërheqjen e profesionistëve të diasporës për angazhime afatshkurtra dhe afatgjata.

## 3.2.6 RUAJTJA E IDENTITETIT KOMBËTAR

Diaspora shqiptare ka një kontribut të padiskutueshëm në historinë dhe identitetin kombëtar.
Identiteti i diasporës është një konstrukt shoqëror që zhvillohet përgjatë kohës. Në rastin e diasporës shqiptare ky proces i ndërtimit të identitetit është i bazuar në një kuptim të përbashkët të historisë, kujtimeve të riprodhuara dhe të rikujtuara, padrejtësive lidhur me ndarjen e territoreve të banuara me shqiptarë, viktimizimin dhe valët e dhunshme të migrimit shpopullues etj. Këto kujtime të përbashkëta historike i bashkojnë komunitetet shqiptare në vendet mikpritëse me ndjenjën që bashkërisht përbëjnë "një diasporë".

Cilësia kryesore e identitetit kombëtar shqiptar ka qenë dhe mbetet familja. Diaspora shqiptare dhe organizimi i saj ka të bëj shumë me "familjen", marrëdhëniet familjare dhe lidhjet me vendlindjen. Ajo është një diasporë etno-nacionale. Historia dhe gjuha e përbashkët, mitet dhe legjendat, ushqimi, kostumet dhe folklori krijojnë dhe ruajnë identitetin shqiptar.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 parashikon rritjen e kontributit të diasporës dhe bashkëpunimin me institucioneve shtetërore për ruajtjen dhe forcimin e identitetit kombëtar të qytetarëve shqiptarë. Qendrat e Kulturës në Diasporë dhe mësimi me kurrikulën e përbashkët si produkt i Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës "Për kurrikulën e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë", nënshkruar në datë 31.05.2018, do të jenë "infrastruktura" e qëllimit të ruajtjes së identitetit kombëtar në Diasporë.

## 3.2.7 ARSIMI, EDUKIMI DHE MEDIA

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 fokusohet në ruajtjen e identitetit kombëtar, kulturor dhe gjuhësor në komunitetet shqiptare në vendet pritëse. Kjo do të realizohet me një bashkëpunim të ngushtë me diasporën dhe përfshirja në projekte specifike kulturore dhe arsimore do të parandalojë asimilimin e mëtejshëm gjuhësor, veçanërisht tek brezat e dytë dhe të tretë të diasporës.

Diaspora shqiptare, me karakteristikat dhe traditat e saj të veçanta kulturore, i inkurajon brezat e rinj që të ruajnë identitetin e tyre kombëtar, edhe pse jetojnë në shoqëri pritëse apo edhe pse kanë identitete hibride.

Vendimi Nr.469, datë 26.07.2018 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën" e ktheu Qendrën e Botimeve për Diasporën në një koordinuese të institucioneve përgjegjëse shtetërore për çështjen e mësimdhënies jashtë vendit.

Kurrikula e parë e përbashkët për mësimin në diasporë bazohet në Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës "Për kurrikulën e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë", nënshkruar në datë 31.05.2018.

Dy ministritë përgjegjëse të arsimit të Shqipërisë dhe Kosovës kanë organizuar takime vjetore me mësuesit në diasporë. Ato janë:
- Seminari i XIV për mësimin plotësues në gjuhën shqipe në diasporë, 31 korrik-03 gusht 2018, zhvilluar në qytetin e Tiranës.
- Seminari i XV për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, organizuar në Prizren në datat 31.07-03.08.2019.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 vlerëson rolin e mediave audiovizive dhe medias sociale në ruajtjen e gjuhës. Televizioni Publik RTSH krijoi një kanal televiziv kushtuar diasporës shqiptare (TVSH 3). Qëllimi është që transmetuesit publikë do të jenë ligjërisht të detyruar t'i dedikojnë 10 deri 15% të programit (tokësor dhe satelitor) interesave të diasporës dhe migracionit.

Në funksion të këtij qëllimi ka filluar botimi i gazetës "Diaspora Shqiptare" me projektin e bashkëfinancuar nga Konfederata Zvicerane, përfaqësuar nga Departamenti Zviceran i Punëve të Jashtme, duke vepruar përmes Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri dhe Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës "Mbi dhënien e një kontributi në projektin/aktivitetin: Gazeta Shqiptare e Diasporës", nënshkruar në datë 27.12.2019.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 ka për synim promovimin e platformave të reja digjitale dhe të mediave sociale, të cilat do të mund të plotësojnë format tradicionale në ruajtjen e identitetit kombëtar, kulturor dhe gjuhësor.

## 3.2.8 ORGANIZIMI I KOMUNITETEVE SHQIPTARE JASHTË VENDIT

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 ka synim organizimin e komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Organizimi i komuniteteve shqiptare në diasporë ka këto qëllime kryesore:

- Hartëzimin e aftësive të cilat ofron diaspora sipas profesioneve,
- Formimin e rrjeteve të profesionistëve dhe të "Ambasadorëve të Kombit" në diasporë,
- Krijimin e një platforme për komunikimin e diasporës

## 3.2.9 KRIJIMI I NJË BAZE TË DHËNASH PËR ORGANIZATAT E DIASPORËS

Baza e të dhënave për organizatat e diasporës do të jetë një mekanizëm i rëndësishëm për koordinimin e veprimtarisë dhe informacionit.

Baza e të dhënave për organizatat e diasporës do të luajë disa qëllime në:

1. Mbështetjen e të drejtës për të votuar të shtetasve jashtë vendit;
2. Ngritjen e rrjeteve profesionale në diasporë; dhe
3. Funksionimin si një mjet për informimin për potencialin dhe kapacitet e diasporës sipas profesioneve.

Për realizimin e një baze të dhënash është miratuar Vendimi Nr.321, datë 15.05.2019 i Këshillit të Ministrave "Për financimin e projektit "Diaspora shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë" dhe zbatimin e tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës".

## 3.2.10 AVANCIMI I TË DREJTAVE TË DIASPORËS

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 ka qëllim kryesor rivlerësimin e marrëdhënies së shtetit me statusin e ri ligjor të diasporës. Ky proces do të kërkojë veprime të bashkërenduara nga qeveria dhe institucionet shtetërore me organizatat e diasporës shqiptare. Ai do të promovojë politika të qarta dialogu me vendet pritëse për çështje të rëndësishme, si integrimi, mësimi i gjuhës amtare dhe politikat për qytetarinë.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 do të inkurajojë bashkëpunimin shtetëror me institucionet e shteteve pritëse, që mbulojnë çështjet e migrantëve dhe të drejtat e grave e të fëmijëve. Ajo do të nxisë ngritjen e komiteteve dypalëshe konsultative të nivelit të lartë për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të diasporës shqiptare. Në vendet pritëse, organizatat e diasporës do të përkrahen për të mbështetur shqiptarët që punojnë e jetojnë atje, për nevojat që ata mund të kenë, për informacionin dhe shërbimet që mund t'u duhen të gjithëve, përfshirë të rinjve migrantë, për pjesëmarrjen politike, të drejtat e punës, procesin e natyralizimit, të drejtat fetare apo çështje të tjera.

Diaspora mund të jetë një nga faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri, nëpërmjet ndërmjetësimit, ndarjes së ideve, praktikave, vlerave, normave të sjelljes dhe remitancat sociale. Migrantët e rritur e të rinj mund të luajnë një rol kyç për të ndihmuar zhvillimin dhe financimin e partnerëve vendorë.

## 3.2.11 VOTA DHE TE DREJTAT POLITIKE

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 do të ndjekë praktikën e ndryshimeve ligjore të prodhuara nga Urdhri Nr.124, datë 18.09.2019 i Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore për garantimin e të drejtës së votës për shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë".

Me qëllim identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, është miratuar Ligji Nr. 14/2016 "Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe Vendimi Nr. 405, datë 04.07.2018 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave mbi detyrimin për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe procedurave përkatëse që ndiqen për këtë qëllim".
E drejta e votës dhe përfshirja në politikë do të krijojnë një hapësirë të re të protagonizmit të diasporës në shoqërinë shqiptare. Angazhimi në jetën publike dhe politike të përfaqësuesve të diasporës do të parashikojë marrjen e disa hapave për të ndryshuar kuadrin ligjor shqiptar, në mënyrë që të mirëpritet dhe të respektohet roli i diasporës dhe migrimit të rregullt. Përfshirja e përfaqësuesve të diasporës në sistemin zgjedhor dhe politik bën të mundur që angazhimi në ekspertizë dhe mbrojtja e interesave të realizohet brenda sistemit.

## 3.2.12 DIPLOMACIA PUBLIKE

Diplomacia publike ka të bëjë me ndikimin e qëndrimeve dhe opinioneve në politikat e shteteve pritëse nga përfaqësuesit e komuniteteve shqiptare në diasporë. Ajo përmban dimensione të marrëdhënieve ndërkombëtare përtej diplomacisë tradicionale dhe kultivim të opinionit publik në shtetet e tjera.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 do të thellojë më tej diplomacinë publike dhe do të promovojë dhe inkurajojë influencuesit e diasporës, ose "Ambasadorët e Kombit" për të avancuar imazhin pozitiv të kombit shqiptar. Me Vendimin Nr.339, datë 06.06.2018 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret dhe mënyrën e ndarjes së çmimit "Ambasador i Kombit" ky proces është zyrtarizuar.

Institucionet shtetërore ose në bashkëpunim me vendet pritëse apo donatorë të interesuar, do të financojnë organizata gjithëpërfshirëse migrantësh. Qendrat kulturore do të përfshihen në shpërndarjen e informacionit dhe organizimin e aktiviteteve të ndryshme për të ruajtur dhe për të forcuar identitetin kombëtar tek diaspora dhe për të promovuar interesat e Shqipërisë.

## 3.3 SHTYLLAT KRYESORE TE STRATEGJISE DHE AKTIVITETET E CDO SHTYLLE

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 është e mbështetur në pesë qëllime kryesore strategjike, me anë të të cilave synohet arritja e objektivave të sipërpërmendura:

1. Qeverisja dhe menaxhimi i njohurive
2. Avancimi i programit të të drejtave politike dhe sociale të diasporës
3. Programi për kapitalin e diasporës dhe lidhjet e tyre në ruajtjen e kulturës kombëtare
4. Përfshirja e diasporës në programin e zhvillimit ekonomiko-social të vendit
5. Monitorimi dhe Vlerësimi

Brenda çdo qëllimi strategjik janë përcaktuar aktivitete për realizimin e tij.

# PËRMBLEDHJA E AKTIVITETEVE SIPAS SHTYLLAVE PËRKATËSE TË STRATEGJISË

## Shtylla 1 - Marrëdhënia shtetërore me Diasporën

1.1 Krijimi i një kulture të re administrative
1.2 Forcimi i kuadrit ligjor për Diasporën
1.3 Shërbime dhe aktvitete për Diasporën
1.4 Forcimi i kapaciteteve dhe rrjeteve të profesionistëve

## Shtylla 2 - Organizimi i Diasporës

2.1 Mekanizma për mbështetjen e organizimit të Diasporës
2.2 Lidhjet me Diasporën shqiptare
2.3 Çmimi "Ambasador i Kombit"
2.4 Certifikata e Diasporës
2.5 Specialistë dhe studiues të Diasporës Shqiptare

## Shtylla 3 - Ekonomia dhe Biznesi

3.1 Tërheqja e investimeve nga Diaspora
3.2 Formalizimi i dërgesave të diasporës dhe remitancave
3.3 Përfshirja e diasporës në jetën ekonomike të vendit

## Shtylla 4 - Arsimi dhe Mësimdhënia

4.1 Programi i kulturës dhe gjuhës shqipe
4.2 Mësuesit në Diasporë
4.3 Tekstet shkollore për Diasporën
4.4 Studentët në Diasporë

## Shtylla 5 - Media dhe Komunikimi

5.1 Mbështetja e rrjeteve të informimit dhe mediave në Diasporë
5.2 Informimi i diasporës shqiptare

## Shtylla 6 - Monitorimi dhe transparenca

6.1 Monitorimi dhe vlerësimi



# IV. MARREDHENIET SHTETERORE ME DIASPOREN

# IV. MARREDHENIET SHTETERORE ME DIASPOREN

## 4.1 POLITIKA SHTETERORE DHE DIASPORA

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 synon një të ardhme ku Shqipëria do të konsiderohet vend i aftë të menaxhojë rrjedhat e migrimit. Ky qëllim lidhet me zhvillimin ekonomik e social të shoqërisë dhe me imazhin e vendit.

Marrëdhënia shtetërore me diasporën përfshin praktikat administrative të institucioneve përgjegjëse Këto praktika janë të bazuara në modele të cilat do të nxisin administratën  në forcimin e kapaciteteve të saj.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 ka qëllim një raport cilësor të institucioneve shtetërore për diasporën sipas praktikave më të mira evropiane. Ajo do të nxisë transparencën e institucioneve në secilin aspekt të procesit të vendimmarrjes dhe efektivitetin e politikave të cilat do të sigurojnë koherencë në fushat që do të aplikohen.

Në përpjekjet e tyre për të investuar, pjesëtarët e diasporës shpesh përballen me burokraci dhe probleme të natyrave të ndryshme. Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 parashikon një fazë të re të marrëdhënieve shtet-diasporë. Ajo do të rivlerësojë mekanizmat administrativë të politikës shtetërore për diasporën shqiptare në vend.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 do të vlerësojë zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore që vihen në zbatim nga ato institucione që merren me çështje të diasporës dhe migracionit. Rëndësi e veçantë do t'i jepet trajnimit dhe certifikimit të trupit diplomatik shqiptar për çështjet e migracionit, veçanërisht për të drejtat e komuniteteve të diasporës shqiptare.

Nëpërmjet Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 do të kryhet rivlerësim periodik i shërbimeve të strukturave përgjegjëse shtetërore kundrejt diasporës. Në bazë të informacionit që do të mblidhet, do të hartohet raport vjetor për situatën konkrete të komuniteteve shqiptare, ku do të jepen edhe propozime për masat përkatëse që do të përmirësojnë asistencën ndaj tyre.

## 4.2 KESHILLI  KOORDINUES I DIASPORES

Marrëdhënia e re shtet-diasporë do të institucionalizohet me ngritjen e Këshillit Koordinues të Diasporës. Ai gëzon një status të veçantë me institucionet e shtetit në orientimin e procesit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore dhe diasporës shqiptare.

Statusi juridik i Këshillit Koordinues të Diasporës është plotësuar me miratimin e Ligjit Nr.16, datë 05.04.2018 "Për diasporën" dhe akteve nënligjore:

- Vendim Nr.340, datë 06.06.2018 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve të Këshillit Koordinues të Diasporës"
- Vendim Nr.195, datë 05.04.2019 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës"
- Vendim Nr.320, datë 15.05.2019 i Këshillit të Ministrave "Për statusin e anëtarëve të Këshillit Koordinues të Diasporës"

Këshilli Koordinues i Diasporës Shqiptare është një organizim qendror bashkëpërfaqësimi i cili do të drejtojë procesin e bashkëpunimit të institucioneve shtetërore me komunitetet shqiptare jashtë vendit. Ai do të mbështesë krijimin e një rrjeti të organizuar të komuniteteve shqiptare në vendet pritëse dhe shteteve të origjinës.

Takimi i parë zyrtar i Këshillit Koordinues të Diasporës u zhvillua në Ditën Kombëtare të Diasporës, në datë 18.12.2019, në Tiranë. Sipas parashikimeve ligjore në të morën pjesë autoritetet më të larta të shtetit. Përfaqësuesit e këtij Këshilli kryen takime konsultuese me të gjithë spektrin politik të vendit.

## 4.3 NENKOMISIONI PARLAMENTAR PER DIASPOREN DHE MIGRACIONIN

Nënkomisioni parlamentar për Diasporën dhe Migracionin vepron brenda Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme. Ai është krijuar me Vendimin Nr.98, datë 5.10.2017 të Kuvendit të Shqipërisë "Për ngritjen e Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Politikën e Jashtme".

Përgjegjësitë e Nënkomisionit parlamentar për Diasporën dhe Migracionin përfshijnë dhënien e propozimeve, shqyrtimin dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit shqiptar dhe politikave të vendit për diasporën dhe migracionin. Ky nënkomision do të ndihmojë në ndërtimin e kohezionit politik në Kuvend për çështje që kanë të bëjnë me diasporën.

## 4.4 KOMITETI SHTETEROR PER DIASPOREN

Komiteti Shtetëror për Diasporën është një organ konsultativ i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e politikave dhe aktiviteteve shtetërore në fushën e diasporës. Komiteti drejtohet nga Kryeministri dhe përbëhet nga Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Ministri i Kulturës, Ministri i Mjedisit dhe Turizmit, Ministri i Shtetit për Diasporën, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe Drejtori i INSTAT-it.

Komiteti Shtetëror për Diasporën funksionon mbi bazën e Vendimit Nr.690, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe funksionimin e Komitetit Shtetëror për Diasporën" dhe Urdhrit Nr. 231, datë 07.12.2017 të Kryeministrit "Për përbërjen dhe detyrat e sekretariatit teknik të Komitetit Shtetëror për Diasporën".

Fusha e veprimtarisë së Komitetit Shtetëror për Diasporën përfshin:

1. Përgatitjen e orientimeve për hartimin e politikave të reja aktive dhe përkufizimi i përparësive strategjike në fushën e diasporës;
2. Realizimin për propozime për mekanizma ligjorë dhe institucionalë për çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e pozitës së diasporës dhe me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve të saj në vendet ku banojnë;
3. Inkurajimin dhe krijimin e dialogut të institucione përgjegjëse për zbatimin e strategjisë dhe politikat administrative në lidhje me komunitetet e diasporës;
4. Bashkërendimin e aktiviteteve dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën;
5. Mbështetje për realizimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe monitorimin e aktiviteteve të saj.

## 4.5 AGJENCIA KOMBETARE E DIASPORES

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka përgjegjësi për zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të pjesëtarëve të diasporës, për ofrimin e asistencës në lidhje me ruajtjen e gjuhës amtare dhe të trashëgimisë kulturore, si edhe për promovimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës.

Agjencia Kombëtare e Diasporës funksionon mbi bazën e Ligjit Nr.115, datë 18.12.2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës" dhe akteve nënligjore:

- Vendim Nr.114, datë 23.02.2018 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Kombëtare të Diasporës"
- Urdhër Nr. 53, datë 16.03.2018 i Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Diasporës"

Agjencia Kombëtare e Diasporës për veprimtarinë e vet vjetore raporton me shkrim në seancë të veçantë dëgjimore në Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin.

## 4.6 FONDI SHQIPTAR PER ZHVILLIMIN E DIASPORES

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës synon të ofrojë bashkëpunimin dhe ndërveprimin nëpërmjet inkurajimit të projekteve me donatorët në funksion të interesave të komuniteteve shqiptare në vendet pritëse dhe të investimeve të diasporës në mbështetje të zhvillimit të vendit.

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës funksionon në bazën e Ligjit Nr.32, datë 07.06.2018 "Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës" dhe Vendimit Nr.594, datë 09.10.2018 i Këshillit të Ministrave "Për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës".

Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës për veprimtarinë e vet vjetore raporton me shkrim në seancë të veçantë dëgjimore në Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin.

## 4.7 QENDRA E BOTIMEVE PER DIASPOREN

Qendra e Botimeve për Diasporën është përgjegjëse për botimin dhe shpërndarjen e teksteve të miratuara shkollore dhe librave të tjerë që do të ndihmojnë për të mësuar dhe për të ruajtur identitetin kombëtar të diasporës shqiptare.

Qendra e Botimeve për Diasporën funksionon në bazën e Ligjit Nr.16, datë 05.04.2018 "Për diasporën" dhe akteve nënligjore:
- Vendim Nr.469, datë 26.07.2018 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën"
- Urdhër Nr. 76, datë 15.04.2019 i Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Botimeve për Diasporën"

Qendra e Botimeve për Diasporën për veprimtarinë e vet vjetore raporton me shkrim në seancë të veçantë dëgjimore në Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin

## 4.8 QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PER ARBERESHET

Qendra e Studimeve dhe e Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) është institucion kërkimor shkencor për diasporën shqiptare. Misioni i saj është kryerja e studimeve të specializuara për historinë, letërsinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit mes studiuesve të fushës vendas dhe në diasporë e më gjerë, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e strukturës së studimeve mbi komunitetin arbëresh.

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët funksionon mbi bazën e Vendimit Nr.601, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët" dhe Urdhrit Nr. 38, datë 18.02.2020 i Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët"

## 4.9 QENDRAT E KULTURËS SHQIPTARE

Ngritja e Qendrave të Kulturës Shqiptare në vendet pritëse do të arrihet në bashkëpunim me Republikën e Kosovës. Synimi i këtyre qendrave do të jetë ruajtja e identitetit kombëtar, promovimi i imazhit të vendeve të origjinës, si edhe ofrimi i shërbimeve dhe i informacioneve tek komunitetet shqiptare në vendet pritëse.

Me miratimin e Ligjit Nr.16, datë 05.04.2018 "Për Diasporën", Vendimin Nr. 470, datë 26.07.2018 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrave Kulturore për Diasporën" dhe Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës "Për Qendrat Kulturore në Diasporë", nënshkruar në datë 27.11.2017 vlerësimi juridik konsiderohet i përmbushur.

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 do të nxisë krijimin e praktikave të funksionimit të Qendrave të Kulturës Shqiptare sipas modeleve funksionale që janë

## 4.10 SHËRBIMET KONSULLORE DHE DIPLOMACIA

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 do të mbështesë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në vendet me komunitetet më të mëdha të diasporës shqiptare. Ambasadat dhe konsullatat do të përpilojnë raporte periodike për situatën dhe organizimin e diasporës shqiptare. Me qëllim mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve shqiptarë, ambasadat dhe zyrat konsullore të Republikës së Shqipërisë do të kenë në dispozicion ekspertë ligjorë të specializuar për çështjet e migrimit dhe të drejtat e njeriut për rregullat dhe praktikat e imigrimit në vendet pritëse.

Shqipëria ka filluar një praktikë të re të diplomacisë me miratimin e Ligjit Nr.16, datë 05.04.2018 "Për diasporën" dhe të akteve nënligjore:
- Vendimit Nr. 470, datë 26.07.2018 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrave Kulturore për Diasporën"
- Vendimit Nr.780, datë 06.11.2019 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e oficerëve koordinues për çështjet e diasporës shqiptare në konsullatat shqiptare në Itali dhe Greqi"

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021-2025 do të rrisë ndërgjegjësimin tek qytetarët shqiptarë jashtë vendit për përdorimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike që ofrohen nga përfaqësitë shqiptare nëpërmjet platformës konsullore elektronike. Në të do të ketë informacion për organizatat joqeveritare të akredituara në vendin pritës, që ofrojnë asistencë ligjore dhe mbrojtje për komunitetet e të huajve.

## V. BUXHETI DHE KOSTOT

Në Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe në Planin e Veprimit për periudhën 2021-2025 janë identifikuar masa dhe kosto përkatëse për zbatimin e tyre.

Për vitet 2019 dhe 2020 buxheti i institucioneve përgjegjëse shtetërore për diasporën është si më poshtë:

### BUXHETI I INSTITUCIONEVE SHTETËRORE PËR DIASPORËN




*Fig. 15: Buxheti i institucioneve shtetërore për diasporën*

Buxhetet e institucioneve përgjegjëse shtetërore për diasporën i referohen kryesisht krijimit funksional dhe administrativ të strukturave të reja shtetërore. Kostot e realizimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 do të mbulohen nga buxhetet e institucioneve përgjegjëse dhe nga donatorët.

Për llogaritjen e kostove të veprimtarive kryesore të Planit të Veprimit të cilat do të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe donatorët do të bazohet në:

1. Llogaritjen e kostove të burimeve njerëzore që mbështetet tek koha që është parashikuar për kryerjen e aktiviteteve dhe një pagë mesatare ditore e një kategorie të caktuar nëpunësi civil.
2. Përcaktimin e shpenzimeve për shërbime të ndryshme ku merret parasysh kostoja e shërbimeve të institucioneve përkatëse, duke u bazuar tek standardet e miratuara.
3. Financimin e aktiviteteve për hartimin dhe rishikimin e legjislacionit, për monitorimin dhe funksionimin e strukturave të përhershme e cila llogaritet duke marrë në konsideratë kostot që do të jenë në vijimësi, si për shembull pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe ekspertizën e huaj (kur është parashikuar në plan).
4. Realizimin e “aktiviteteve specifike” apo iniciativave të ngjashme ku financimi bazohet kryesisht tek natyra e aktiviteteve me kostot që përcakton tregu për këto lloj shërbimesh.

Në Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe në Planin e Veprimit për periudhën 2021-2025 sa u përket trajnimeve, për shpenzimet është marrë parasysh kostoja e trajnimit për person, ndërsa njësi matëse janë konsideruar kostot e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe/apo kosto të tjera nga trajnime të ngjashme në të shkuarën. Për aktivitete për të cilat informacioni nuk është i plotë, ose është ndjekur metoda analitike e vlerësimit, ose janë gjetur kostot e aktiviteteve të përafërta që janë kryer gjatë zbatimit të strategjisë së mëparshme për vitet 2018-2020, ose është marrë në konsideratë kostoja e produkteve të ngjashme në PBA.

Për Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 dhe Planin e saj të Veprimit, përfundimet për buxhetin do të nxirren nga Komiteti Shtetëror për Diasporën.

# VI. ZBATIMI DHE MONITORIMI

# VI. ZBATIMI DHE MONITORIMI

## 6.1 MONITORIMI DHE VLERESIMI

Në Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 janë përcaktuar kritere të qarta për monitorimin dhe vlerësimin e saj, duke pasur parasysh shpenzimin e fondeve publike dhe shpërndarjen e burimeve të ndryshme nga qeveria dhe donatorët, që bëjnë të mundur dhënien e rezultateve të kësaj strategjie. Për këtë arsye, brenda kësaj strategjie janë përfshirë si pjesë përbërëse e objektivave dhe vizionit të strategjisë edhe treguesit e performancës të cilat do të bëjnë të mundur një hap të dytë rivlerësimi.

Kjo është arsyeja e kornizave vlerësuese dhe mekanizmave për zhvillimin e vazhdueshëm institucional në të gjithë Planin e Veprimit, të cilat do të përmirësojnë kapacitetet administrative për të realizuar qartësi efektive në monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 (shih Shtojcën I).
Zbatimi dhe monitorimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 përfshin aktivitete konkrete të cilët do të sigurojnë qëndrueshmërinë e saj, për të vlerësuar diasporën shqiptare në përputhje si të trajektores së saj historike dhe ashtu edhe atë bashkëkohëse. Objektivat e zbatimit dhe monitorimit deri në vitin 2025 janë hartuar me synimin që:

- Të jenë realiste, të arritshme dhe të shkallëzueshme duke pasur parasysh buxhetet e institucioneve dhe mbështetjen që pritet të vijë nga donatorët;
- Të trajtojnë objektivat e zhvillimit social, ekonomik dhe kulturor të Shqipërisë;
- Të ofrojnë një vlerë të shtuar për strukturat ekzistuese të angazhimit të diasporës, duke hapur edhe fusha të reja përfshirjeje për komunitetet shqiptare jashtë vendit;
- Të inkurajojnë zhvillimin e një marrëdhënieje krenarie dhe besimi ndërmjet institucioneve shtetërore të Shqipërisë dhe diasporës.

Përqasja dhe rishikimi i dokumentit strategjik do të jetë sipas kërkesave të Vendimit Nr. 290, dt.11.3.2020 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me Sistemin IPSIS.

## 6.2 ANGAZHIMET KRYESORE PER PERIUDHEN 2021-2025

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 mbulon një periudhë prej 5 vjetësh për programin e angazhimeve që ajo merr përsipër të realizojë. Aty do të jenë të përfshirë komunitetet shqiptare në diasporë, organizatat ndërkombëtare dhe ekspertët e diasporës. Kjo është arsyeja që programi është menduar të ketë dy cikle prej dy vitesh e gjysëm secili, për periudhën 2021 - 2023, me një rishikim të angazhimeve në vitin 2023 për të riorientuar në këtë mënyrë nevojat apo për të vlerësuar mundësitë e tjera që mund të kenë dalë deri atëherë. Këto angazhime do të përfshiheshin si një kuadër monitorimi dhe vlerësimi, në mënyrë që të sigurohet suksesi i iniciativave dhe i vetë strategjisë. Kjo do të sjellë një rishikim afatmesëm për të çuar më pas në vlerësimin e aktiviteteve në vitin 2023 me synim përforcimin e aktiviteteve për periudhën 2023-2025.




*Fig.16: Roli I qeverisë në arritjen e rezultateve sipas shtyllave, 2021 – 2025*

Në Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 rekomandohet që në vitin 2023 të ketë një rishikim të këtij dokumenti, siç u bë me Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024, me synim vlerësimin e potencialeve të reja për angazhimin dhe përfshirjen e diasporës. Për këtë arsye, janë menduar disa aktivitete të tjera konsultative, si bazë për angazhimet kryesore të parashikuara gjatë periudhës dy vjeçare 2021 – 2023. Në bazë të parashikimeve institucionet përgjegjëse të Shqipërisë do të vijojnë me:

- Fuqizimin e marrëdhënies me diasporën dhe përdorimin e kontributeve të saj për zhvillimin e vendit;
- Idetë e reja që do të lindin nga përfshirja praktike e diasporës;
- Përgatitja e planeve dhe iniciativave fazën e dytë të strategjisë;
- Rezultate konkrete që tregojnë rritjen e kontributit të diasporës gjatë periudhës afatmesme.




*Fig. 17 Programi shtesë i angazhimeve për periudhën 2022 – 2024*

## 6.3 FUNKSIONALITETI I ZHVILLIMIT DHE ZBATIMIT TE STRATEGJISE

Në Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 merren parasysh një sërë masash dhe praktikash, me qëllim rritjen e nivelit të zbatueshmërisë dhe të suksesit të saj. Një pjesë e tyre lidhen me eksperiencën e krijuar nga aplikimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018 - 2024. Këto eksperienca do të merren parasysh nga:

- Institucionet përgjegjëse shtetërore të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e zbatimit dhe qëndrueshmërinë e kësaj strategjie;
- Detyrimet procedurale të shërbimit civil sipas interesave të këtij dokumenti;
- Kapacitetet drejtuese dhe menaxhuese të të gjitha agjencive shtetërore që kërkojnë të arrijnë performancën optimale të kësaj strategjie.

Në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 janë shtjelluar elementë praktikë që sjellin performancën e saj optimale. Kapacitetet qendrore që janë marrë parasysh janë:

- Përcaktimi i treguesve të cilësisë;
- Kapacitetet menaxhuese dhe zhvillimi i tyre;
- Angazhimi dhe komunikimi;
- Bashkërendimi dhe koordinimi shtetëror;
- Menaxhimi financiar dhe vlerësimi;
- Arritja e partneriteteve strategjike me komunitetin e donatorëve;
- Komponentët e administrimit.

## 6.4 ZBATIMI I STRATEGJISE

Format më të suksesshme të strategjive të angazhimit të diasporës janë ato që operojnë brenda një modeli hibrid publik-privat, i cili sjell një rol lehtësues për administratën e qeverinë. Kjo sjell natyrshëm lidhjen e dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 me një sërë projektesh dhe programesh, të cilat, sipas terminologjisë së Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM-it), angazhojnë, lejojnë dhe fuqizojnë komunitetet jashtë vendit për t'u bërë agjentë të zhvillimit në vendet e tyre të origjinës.

Për projektet dhe iniciativat e ndryshme të cilat do të zhvillohen gjatë kohëzgjatjes së Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025, elementët më të rëndësishëm në kuadrin zbatues të cilët do të ndihmojnë pritshmëritë e suksesit të saj janë:

- Krijimi dhe vendosja e një kulture organizative dhe operacionale (shih Shtojcën IV);
- Realizimi i një strukture pune angazhuese dhe komunikimi;
- Përcaktimi i burimeve profesionale dhe koha për t'u angazhuar me diasporën shqiptare;
- Krijimi i një "matrice" për rishikimin e zbatimit dhe për performancën e realizimit.

## 6.5 KULTURA ORGANIZATIVE DHE OPERACIONALE

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 duke pasur parasysh pasojat e gjera që sjell përfshirja e diasporës në fushat sociale, ekonomike dhe kulturore do të ketë bashkëpunim të gjerë ndërmjet të gjitha fushave të veprimit administrativ që ajo angazhon. Ky bashkëpunim do të lehtësojë aplikimin dhe marrjen e rezultatit të pritshëm bazuar tek:

- Ofrimi i shërbimeve me synime të matshme;
- Vendosja në dispozicion e personelit profesional dhe të trajnuar (trajnimi është përfshirë në planin e veprimit të strategjisë);
- Shërbime bashkërenduese me një sërë aktorësh/iniciativash;
- Mbështetje në vazhdimësi për rrjetin e organizatave të diasporës shqiptare jashtë vendit;
- Përfshirje aktive e shoqërisë civile në zbatimin e strategjisë;
- Bashkëpunimi me sektorin privat
- Program i rregullt dhe efikas komunikimi dhe sensibilizimi.

## 6.6 AUDITIMI DHE TRANSPARENCA

Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i saj i Veprimit 2021 - 2024 përbëjnë kuadrin bazë për cilësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore të Shqipërisë dhe komuniteteve shqiptare në diasporë.

Dokumenti i Strategjisë është mekanizmi për angazhimin dhe përfshirjen e Diasporës, në mënyrë që kjo e fundit të bëhet faktor dhe pjesëmarrës i zhvillimit të vendit. Strategjia ofrohet në frymën e bashkëpunimit, bashkë me një sërë drejtimesh dhe aktivitetesh të hartuara për të pasqyruar realitetin aktual jo vetëm të Diasporës shqiptare, por edhe të nevojave dhe potencialit të saj.

Strategjia Kombëtare e Diasporës auditimin dhe transparencën e ka pjesë të vlerësimit të pritshmërive. Strukturat përgjegjëse të diasporës do të raportojnë rregullisht, pranë:

- Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin në përbërje të Komisionit të Politikës së Jashtme në Kuvendin e Shqipërisë,
- Komitetit Shtetëror për Diasporën, i cili drejtohet nga Kryeministri.

Auditimi dhe transparenca e zbatimit të dokumentit të Strategjisë Kombëtare vlen edhe në shmangien e çdo skenari negativ. Zbatimi i suksesshëm i kësaj Strategjie do të përcaktohet nga udhëheqja dhe partneriteti i aktorëve kryesorë, të cilët mund ta çojnë përpara suksesin e saj. Ai do të realizohet brenda një kuadri gjithëpërfshirës dhe transparent. Kjo do ta kthejë Strategjinë në protagoniste si për thellimin e lidhjeve të Diasporës shqiptare me atdheun, ashtu edhe për përcaktimin e tyre si partnerë për zhvillimin e Shqipërisë.

## PERFUNDIME

Strategjia Kombëtare e Diasporës 2021 - 2025 përbën një fazë të zhvillimit të politikës zyrtare për të përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe diasporës shqiptare.

Dokumenti i Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Plani i saj i Veprimit 2021 - 2025 përfaqëson maturimin e politikës shtetërore të Republikës së Shqipërisë për angazhimin dhe përfshirjen e diasporës në zhvillimin e vendit.

Zbatimi i suksesshëm i kësaj Strategjie do të përcaktohet nga bashkëpunimi dhe partneriteti i aktorëve kryesorë të saj. Ajo do të ofrojë thellimin e lidhjeve të diasporës shqiptare me vendin e origjinës, ashtu edhe për përcaktimin e saj si partnere për zhvillimin e Shqipërisë.

Atdheu janë njerëzit! Jashtë tij, çdo shqiptar dhe shqiptare ka marrë një "pjesë" të tij me vete. Edhe për këtë arsye, kjo strategji, konsiderohet më shumë se një akt administrativ.

*SHTOJCA I – PLANI I VEPRIMIT TE STRATEGJISE KOMBETARE TE DIASPORES SHQIPTARE 2021 – 2025 (BASHKËLIDHUR MË VETE)*

*SHTOJCA II – BURIMET E FINANCIMIT DHE AKTIVITETET (BASHKËLIDHUR MË VETE)*

*SHTOJCA III – STRUKTURA E INSTITUCIONEVE SHTETERORE PER DIASPOREN*

*SHTOJCA IV - RISHIKIMI I DOKUMENTIT NE PROCESIN E ZBATIMIT*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

# PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISE KOMBETARE TE DIASPORES SHQIPTARE 2021 -2025

# HYRJE

Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2021 - 2025 parashikon detyrimet, institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore për realizimin e ndryshimeve të synuara të politikës shtetërore të Shqipërisë ndaj komuniteteve shqiptare jashtë vendit.

Strategjia Kombëtare e Diasporës është komplekse dhe shumë sektoriale. Vlerësimi i efektivitetit të rezultateve të saj do të jetë në koordinim midis institucioneve të ndryshme të shtetit shqiptar. Rëndësi të veçantë në këtë proces ka bashkëpunimi me strukturat organizative të diasporës dhe shoqërisë civile.

Plani i Veprimit i Strategjisë Kombëtare të Diasporës parashikon masa konkrete, të cilat do të duhet të zbatohen kryesisht nga Qeveria Shqiptare dhe nga aktorë të tjerë të përfshirë në këtë proces. Masat e Planit të Veprimit janë ndarë në gjashtë grupe:

1. Marrëdhënia shtetërore me diasporën
2. Organizimi i diasporës
3. Ekonomia dhe biznesi
4. Arsimi dhe mësimdhënia
5. Media dhe komunikimi
6. Monitorimi dhe transparenca

Shumica e masave të parashikuara në Planin e Veprimit parashikojnë aktivitete dhe veprime, të cilat do të realizohen brenda afateve të përcaktuara ose periodikisht. Për realizimin e tyre kërkohet ndërhyrja e koordinuar e më shumë se një institucioni shtetëror.

Plani i Veprimit të Strategjisë Kombëtare do të jetë pjesë e veprimtarisë të institucioneve shtetërore të Shqipërisë me qëllim zbatimin e tij. Dokumenti do të shoqërohet me shpjegime të detajuara dhe elementët e nevojshëm për realizimin e tyre.

Plani i Veprimit është matës i suksesit dhe i të kundërtës në aplikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës.

# I. MARREDHENIA SHTETERORE ME DIASPOREN

# I. MARREDHENIA SHTETERORE ME DIASPOREN

## *MASA 1*

Koordinimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse që legjislacioni i ri ngarkon për fushën e marrëdhënieve shtetërore me diasporën me Agjencinë Kombëtare të Diasporës, Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendrën e Botimeve për Diasporën dhe Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. Hartimi i një plani të detajuar për financimin e politikave dhe masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare. Krijimi i një njësie të specializuar për rivlerësimin e legjislacionit për diasporën për të ndërmarrë ndryshimet e nevojshme.

**INDIKATORËT:** Forcimi financiar dhe me personel i Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

## *MASA 2*

Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor të aktiviteteve për diasporën (aktivitetet që përfshinë librin, arsimin, kulturën, turizmin dhe biznesin) dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë vlerësimin e pjesëmarrjes e përfaqësimit në to. Përgatitja e informacioneve vlerësuese për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin e Kuvendit për Diasporën dhe Migracionin.

**INDIKATORËT:** Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor të aktiviteteve për diasporën.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Kulturës
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

*MASA 3*

Ndjekja e procedurave të nevojshme koordinative për të diskutuar çdo vit në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe për të parashikuar në buxhetin vjetor (pasardhës) fondet e nevojshme për të zbatuar Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit deri në vitin 2025.

**INDIKATORËT:** Diskutimi dhe miratimi në parim i nevojave dhe buxhetit vjetor në Komitetin Shtetëror të Diasporës;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Kulturës
Ministri i Shtetit për Diasporën

*MASA 4*

Vlerësimi i përqasjes të strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Diasporën. Ky proces do të kryejë organizimin e politikave shtetërore ekzistuese apo që do të miratohen në të ardhmen në marrëdhënie me politikat për komunitet shqiptare jashtë vendit.

**INDIKATORËT:** Realizimi i një takimi vjetor në nivelin teknik për përqasjen e Strategjisë Kombëtare të diasporës me strategjitë e tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

*MASA 5*

Realizimi i raporteve vjetore nga institucionet përgjegjëse ku të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi për komunitetet shqiptare në shtetet pritëse. Krijimi i një botimi të përbashkët për raportimet për diasporën shqiptare.

**INDIKATORËT**: Realizimi i raporti vjetor për diasporës shqiptare Instituti i Statistikave dhe Banka e Shqipërisë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

*MASA 6*

Rishikimi i kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit me shtetet pritëse me qëllim përfshirjen në këto marrëveshje të formimit profesional, ose për to të diskutohet në veçanti.
Rivlerësimi në bashkëpunim me vendet e BE-së e projekte të veçanta për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve të punësimit duke përfituar edhe nga legjislacioni provizor dhe i veçantë i vendeve pritëse, që kanë mungesë të fuqisë punëtore.

**INDIKATORËT:** Rishikimi i kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit dhe bashkëpunimi me vendet e BE-së për projekte të veçanta. Raportim vjetor në Komitetin Shtetëror të Diasporës.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

## *MASA 7*

Organizimi i nxitjes e forcimit të marrëdhënieve të Shqipërisë me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare dhe bashkëpunimi i programit të punës të shërbimit diplomatik dhe konsullor me fokus të veçantë nga këndvështrimi i forcimit të statusit të diasporës shqiptare.

**INDIKATORËT:** Organizimi i një aktiviteti vjetor për vlerësimin e strukturës së përfaqësimi diplomatik dhe konsullor.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën

## *MASA 8*

Vendosja e koordinimit mbi bazën e një programi të miratuar të projekteve me donatorët ndërkombëtarë për realizimin e masave të Planit të Veprimit apo që mbulojnë interesat e diasporës shqiptare.

**INDIKATORËT:** Bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse në aplikimin për projekte kushtuar diasporës me donatorët kombëtare dhe ndërkombëtare.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2021(periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën

### *MASA 9*

Vlerësimi i akteve të brendshme ligjore dhe marrëveshjeve në fushën e migracionit për zgjerimin e mbrojtjes së interesave të komuniteteve shqiptare jashtë vendit në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ai do të ketë qëllim përafrimin e tyre me Acquis Communautaire dhe realizimin e procedurave për përfundimin e ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare në këtë fushë (nëse nuk janë realizuar ende).

**INDIKATORËT:** Realizimi i një takimi vjetor për rivlerësimin e akteve ligjore ekzistuese në fushën e migracionit dhe zbatimin e procedurave për ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Brendshme
Ministri i Shtetit për Diasporën

### *MASA 10*

Krijimi dhe vijueshmëria e strukturave informuese për orientimin e qytetarëve shqiptarë jashtë vendit në përdorimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike të cilat ofrohen nga përfaqësitë shqiptare (platforma online). Dhënia e informacionit rreth organizatave jo qeveritare të akredituara nga shteti pritës, të cilat ofrojnë asistencë dhe mbrojtje ligjore për komunitetet e huaja.

**INDIKATORËT:** Informim periodik i Komitetit Shtetëror të Diasporës për gjendjen e orientimi i qytetarëve shqiptare jashtë vendit për shërbimet nëpërmjet platformës konsullore online dhe organizim komunikimi me shoqërinë civile në shtetin pritës. Organizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë i 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Drejtësisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## *MASA 11*

Vlerësimi dhe zgjerimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes civile dhe bazave të të dhënave me të dhëna për migrantët dhe rishikim periodik i bazës ligjore për regjistrimin e migrantëve. Përcaktimi i përgjegjësive dhe të dhënave që duhen mbledhur si edhe identifikimi dhe planifikimi i krijimit të rrjetit dhe infrastrukturës së duhur. Organizimi i aktiviteteve publike dhe shoqërinë civile mbi qëllimin e sistemit të regjistrimit dhe votimit të shtetasve jashtë vendit.

**INDIKATORËT:** Zgjerimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes civile me të dhëna për migrantët dhe organizimi i aktiviteteve jashtë vendit. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Brendshme
Ministri i Shtetit për Diasporën

## *MASA 12*

Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse të diasporës në bashkëpunim me shtetin e Kosovës në shërbim të ruajtjes së identitetit kombëtar dhe për të ofruar shërbime e informacion për komunitetet e shqiptarëve në diasporë.

**INDIKATORËT:** Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse në bashkëpunim me shtetin e Kosovës. Realizimi i programimit buxhetor;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2022

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Financës dhe Ekonomisë
Ministria e Kulturës
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## *MASA 13*

Organizimi i një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit dhe të nëpunësve në administratë të specializuar në institucionet të cilat merren me politikat e Diasporës dhe Migracionit. (Plotësimi i rrjetit edhe me emrat dhe detajet e studiuesve dhe nëpunësve shtetërorë nga Agjencia Kombëtare e Diasporës).

**INDIKATORËT:** Krijimi dhe administrimi të një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit. Realizimi vjetor i një aktiviteti në nivel teknik

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

## *MASA 14*

Realizimi i trajnimeve të veçanta për fushën e migracionit me administratën shtetërore dhe lokale dhe realizimi i përfshirjes së tyre në programet e universiteteve shqiptare. Organizimi i trajnimeve periodike në fushën e legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar për nëpunësit që mbulojnë çështje të migracionit. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve që kanë nevojë për trajnime ligjore. Hartimi i moduleve trajnuese në këtë fushë dhe përfshirjen e një moduli të tillë në trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil.

**INDIKATORËT:** : Organizimi i trajnime të përgjithshme dhe të veçanta periodike. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve. Hartimi i moduleve trajnuese. Realizimi i një takimi vjetor në nivel teknik

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë i 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Drejtësisë
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën

## *MASA 15*

Hartimi i manualeve praktike që lidhen me çështjet e migracionit dhe vënia e tyre në dispozicion të zyrtarëve që merren me zbatimin në praktikë të legjislacionit për Migracionin. Identifikimi i akteve ligjore/nënligjore që zbatohen në praktikë nga çdo institucion i cili mbulon çështje të caktuara të diasporës dhe migracionit. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë lidhur me legjislacionin migrator dhe në mënyrë të veçantë me të drejtat e komuniteteve shqiptare në diasporë.

**INDIKATORËT:** : Hartimi i manualeve praktike me aktet ligjore/nënligjore. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë për çështjet e migracionit. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë i 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Brendshme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Drejtësisë

## *MASA 16*

Nxitja e bashkëpunimit shtetëror me institucionet e vendeve pritëse të cilat trajtojnë çështje të migrantëve, të drejtave të grave dhe të drejtave të fëmijëve. Krijimi i komisioneve dypalëshe konsultative të nivelit të lartë me shtetet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare të diasporës dhe funksionimi i tyre në mënyrë periodike për këtë qëllim. Informimi publik për ecurinë dhe zhvillimin e kësaj veprimtarie për publikun e interesuar.

**INDIKATORËT:** Bashkëpunim shtetëror me institucionet e vendeve pritëse. Krijimi i komisioneve dypalëshe konsultative dhe informimi publik për ecurinë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Drejtësisë

## *MASA 17*

Përgatitja dhe shpërndarja e informacionit (broshurave, fletëpalosje, faqe interneti, app në telefonat celularë etj.) që ju drejtohet komuniteteve shqiptare në diasporë, ku të jepet informacion në lidhje me statusin dhe të drejtat e tyre si edhe për shërbimet që ju ofrohen nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore si edhe nga shoqatat e migrantëve me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare.

**INDIKATORËT:** Shpërndarja e informacionit në lidhje me statusin të drejtat si edhe shërbimet që ju ofrohen komuniteteve shqiptare në shtetet pritëse. Realizimi i një takimi vjetor në nivel teknik

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë i 2022 (periodike deri 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Brendshme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## *MASA 18*

Vendosja e kontakteve të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI) me qendër në Bruksel, për të vlerësuar mundësitë e mbështetjes së politikës të mbrojtjes së komuniteteve të shqiptarëve në diasporë në vendet pritëse të BE-së.

**INDIKATORËT:** : Kontakte të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë i 2021

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare e Diasporës
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Brendshme

## *MASA 19*

Nxitja dhe intensifikimi i komunikimeve ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase për mbrojtjen e migrantëve. Identifikimi i organizatave në vendet pritëse për mbrojtën e të drejtave të njeriut dhe të migrantëve në këto vende. Ndërgjegjësim nëpërmjet informacioneve në internet, tryezave dhe takimeve për mbrojtjen sociale dhe shëndetësore në vendet pritëse dhe të origjinës.

**INDIKATORËT:** Realizimi i komunikimeve ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën - Agjencia Kombëtare e Diasporës
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ministria e Drejtësisë

## *MASA 20*

Rivlerësimi periodik i politikës së shërbimeve, procedurave dhe tarifave të tyre. Në bazë të informacioneve të marra nga përfaqësitë dhe hartimi nga Agjencia Kombëtare e Diasporës e një raporti vjetor për gjendjen konkrete të komuniteteve shqiptare në diasporë shoqëruar me propozime masash për përmirësimin e asistencës për ta. Raporti do të diskutohet në Komitetin Shtetëror të Diasporës.

**INDIKATORËT:** Rivlerësim i politikës së shërbimeve dhe hartimi i një raporti vjetor. Raportim në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Arsimit, Sporti dhe Rinisë
Ministria e Drejtësisë

## *MASA 21*

Negocimi për të nënshkruar marrëveshjet dypalëshe për mbrojtjen sociale të migrantëve me vendet pritëse me qëllim që ata të transferojnë sigurimet shoqërore edhe në Shqipëri. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore dhe nëse duhet nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave. (Rivlerësimi i një plan-veprimi të veçantë për çështjen e pensioneve të migrantëve shqiptarë).

**INDIKATORËT:** Negocimi për marrëveshjet dypalëshe me vendet pritëse. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ministria e Drejtësisë

## *MASA 22*

Krijimi i regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit dhe organizimi i një takimi vjetor organizuar në bashkëpunim me zyrën e Avokatit të Popullit dhe organizatën e Kryqit të Kuq Shqiptar për këtë çështje. Diskutimi i vlerësimit të informacionit periodik dhe konkluzioneve për Komitetin Shtetëror të Diasporës.

**INDIKATORËT:** : Krijimi i regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Drejtësisë

## *MASA 23*

Organizimi dhe mbështetja e rrjeteve (edhe ndërkombëtare) të grupeve dhe shoqatave të veçanta të diasporës shqiptare në bazë të interesave, profesioneve të përbashkëta, apo vendndodhjes gjeografike. Krijimi i lehtësirave si p.sh.: botimi në gazeta, apo në faqe interneti e informacioneve që mundësojnë krijimin e grupeve profesionale dhe të interesave të përbashkëta. Ndërmjetësimi për vendosjen e kontakteve midis grupeve “homologe” në vende të ndryshme për të krijuar rrjete funksionale të kësaj natyre.

**INDIKATORËT:** Organizimi dhe mbështetja e grupeve dhe shoqatave të diasporës; Krijimi i projekteve për realizimin e masës. Realizimi i një aktiviteti vjetor.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën

## *MASA 24*

Mbështetja mbi bazën e projekteve të veçanta të organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese për shtetasit e huaj në qytetet ku migrantët shqiptarë janë të përqendruar, mbi bazën e udhëzuesit të përgatitur nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës dhe Këshillit të Evropës.

**INDIKATORËT:** Mbështetja e organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2023

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Drejtësisë

## *MASA 25*

Kryerja e fushatave sensibilizuese lidhur me mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare, të cilat merren me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut si dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, nëpërmjet aktiviteteve si:
• Publikim i këtyre informacioneve në faqen e internetit për migracionin kushtuar kësaj çështjeje,
• Botimi në gazetat shqiptare jashtë vendit,
• Botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve lidhur me këto informacione,
• Publikimi i këtyre të drejtave nëpërmjet faqeve të internetit të krijuara nga komuniteti shqiptar që vepron jashtë vendit.

Raportimi periodik nga ana e qeverisë shqiptare të rasteve të shkeljeve të të drejtave të migrantëve
shqiptarë. (Disa nga strukturat ndërkombëtare që merren me këto të drejta janë si më poshtë:
• Special rapporteur for migrant's rights of the United Nations - Raportuesi Special për të Drejtat e Migrantëve.
• Commissioner for Human Rights of the Council of Europe - Komisioneri për Mbrojtjen e të
Drejtave të Njeriut në Këshillin e Evropës.
• European Court in Human Rights - Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.
• European Commission against Racism and Intolerance (ECRI) of the Council of Europe -
Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për vendet anëtare në Këshillin e Evropës.
• Commission for Petition of European Parliament for the EU - Komisioni i Peticioneve të
Parlamentit Evropian.
• Ombudsman of the EU - Avokati i Popullit i BE-së.

**INDIKATORËT:** Kryerja e fushatave sensibilizuese ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve. Koordinimi për raportimin periodik të rasteve për shkelje të të drejtave të migrantëve shqiptarë. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë i 2023 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Drejtësisë

## *MASA 26*

Koordinimi dhe organizimi i takimeve apo “Ditëve të Shqipërisë” në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar edhe lehtësirat lidhur me investimet në Shqipëri.

**INDIKATORËT:** Koordinimi dhe organizimi i takimeve të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor. Realizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Kulturës
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

## *MASA 27*

Koordinimi me institucionet shëndetësore, publike dhe private, në përgatitjen e një fushate për promovimin e turizmit shëndetësor, lidhur kryesisht me disa shërbime për të cilat Shqipëria ka siguruar avantazhe (dentar, neurokirurgji, kardiokirurgji etj.).

**INDIKATORËT:** Koordinimi me institucionet shëndetësore, publike dhe private, për promovimin e turizmit shëndetësor. Realizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

## *MASA 28*

Përfshirja e komunitetit të shqiptarëve të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës dhe në Shqipëri me qëllim promovimin e tyre (nënshkrimi dhe/ose amendimi i marrëveshjeve dypalëshe me shtetet pritëse të diasporës duke përfshirë edhe interesat e këtyre të fundit në to) dhe nxitja e krijimit të aktiviteteve vjetore për këtë qëllim.

**INDIKATORËT:** Komunitetet shqiptare të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës, me qëllim promovimin e tyre në Shqipëri. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë i 2021

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Kulturës
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën

# II. ORGANIZIMI I DIASPORES

*MASA 29*

Organizimi i plan - veprimit të institucioneve përgjegjëse për diasporën me Këshillin Koordinues të Diasporës për forcimin organizativ të komuniteteve shqiptare dhe përfshirjen në zhvillimin social - ekonomik të Shqipërisë.

**INDIKATORËT:** Miratimi i programit të përbashkët me Këshillin Koordinues të Diasporës.

**AFATI KOHOR**: 6 mujori dytë 2021

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

*MASA 30*

Organizimi i Kuvendit të Diasporës Shqiptare në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të Diasporës si ngjarja më e rëndësishme e komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Organizimi periodik i aktivitetit mbarëkombëtar me qëllim shqyrtimin e politikave aktuale për mobilizimin e diasporës shqiptare, ku do të vlerësohen çështjet si ruajtja e gjuhës dhe kulturës, fenomeni i ikjes së trurit dhe investimet nga diaspora në Shqipëri.

**INDIKATORËT:** Krijimi i Grupit të Punës për përgatitjen dhe organizimin e Kuvendit të Diasporës Shqiptare në bashkëpunim me Këshillin Koordinues të Diasporës. Organizimi periodik i Kuvendit të Diasporës Shqiptare.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2021 (periodike deri në 2025)6 mujori parë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministra e Arsimit, Sportit dhe Rinise

## *MASA 31*

Koordinimi me Republikën e Kosovës në për fushën e marrëdhënieve me diasporën shqiptare në zbatim dhe rivlerësim të marrëveshjeve ekzistuese midis dy shteteve. Përgatitja dhe realizimi i marrëveshjeve dypalëshe në fushën e diasporës me të gjitha vendet të cilat vlerësohen të rëndësishme dhe "prodhuese" të diasporave shqiptare në botë.

**INDIKATORËT:** Krijimi i një Plani-Veprimi të përbashkët me Shtetin e Kosovës. Koordinimi i marrëveshjeve me Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministri i Shtetit për Diasporën

## *MASA 32*

Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në vendet pritëse. Organizimi i aktiviteteve mbi bazën e profesioneve të cilat nxisin rrjetet e profesionistëve dhe identifikimin e burimeve njerëzore.

**INDIKATORËT:** Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në diasporë dhe nxitja e organizimit të rrjeteve të profesionistëve. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021(periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Kulturës

*MASA 33*

Promovimi i rasteve të personaliteteve të suksesshme të diasporës dhe në Shqipëri dhe dhënia e titullit "Ambasador i Kombit". Krijimi i rrjetit të Ambasadorëve të Kombit (formulimi i akteve juridike të nevojshme për këtë çështje).

**INDIKATORËT:** Promovimi i personaliteteve dhe krijimi i rrjetit të Ambasadorëve.

**AFATI KOHOR**: 6 mujori parë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

*MASA 34*

Përgatitja e Certifikatës së Diasporës, e cila mund të aplikohet online dhe krahas regjistrimit të të interesuarit e pajis atë me një dokument të printueshëm ("Jam Shqiptar") i cili mund të vendoset në ambiente të hapura për të pohuar identitetin kombëtar shqiptar. Ajo do të jepet e veçantë për fëmijët që mbarojnë projektin e Shkollës Verore.

**INDIKATORËT:** : Realizimi i projektit të Shkollës Verore dhe shpërndarja e Certifikatës "Jam Shqiptar".

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2021

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

## *MASA 35*

Krijimi i Regjistrit të Diasporës së Kualifikuar dhe zbatimi i programeve kombëtare dhe të përbashkëta me institucione ndërkombëtare me qëllim që të tërhiqen anëtarët e kualifikuar të diasporës për t'i shërbyer ekonomisë së Shqipërisë. Vlerësimi i programeve që nxisin investitorët që të punësojnë staf të kualifikuar nga diaspora jashtë vendit. Mbi bazën e këtyre programeve, koordinimi dhe krijimi i mundësive për studentët shqiptarë që të mirëpriten dhe të ndihmohen nga anëtarë të diasporës shqiptare për të lehtësuar studimet e tyre në universitete të huaja nëpërmjet një rrjeti të ngritur për këtë qëllim në diasporë.

**INDIKATORËT:** Realizimi i Regjistri të Diasporës së Kualifikuar; Programet kombëtare; Vlerësimi i programeve; Koordinimi dhe krijimi i mundësive për studentët shqiptarë. Organizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2023 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## *MASA 36*

Evidentimi i shoqatave kulturore, sportive, arsimore, sociale, shkencore që veprojnë në vendet pritëse si dhe i individëve të talentuar dhe të suksesshëm që veprojnë në diasporë. Krijimi i një regjistri të veçantë për këtë qëllim.

**INDIKATORËT:** Evidentimi i shoqatave dhe krijimi i një regjistri. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Kulturës
Ministri Shtetit për Diasporën

*MASA 37*

Nxitja e organizimeve të Rrjetit të Grave në Diasporë dhe ndërtimi i politikave të veçanta në këtë drejtim. Organizimi në Shqipëri ose jashtë saj i Samitit të Grave të Diasporës. Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm me organizatat dhe me institucionet që mbulojnë këtë çështje në vendet pritëse dhe me shoqërinë civile në Shqipëri për këtë qëllim.

**INDIKATORËT:** Organizime të Rrjetit të Grave në Diasporë; Organizimi i Samitit të Grave të Diasporës;

**AFATI KOHOR**:6 mujori dytë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

## III. EKONOMIA DHE BIZNESI

*MASA 38*

Forcimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës në bashkëpunim me rrjetin e bizneseve në diasporë. Krijimi i Regjistrit të Bizneseve të Diasporës si bazë e organizimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës si protagoniste në marrëdhëniet e biznesit me administratën shtetërore.

**INDIKATORËT:** Aktivitet vjetor me Dhomën e Biznesit të Diasporës; Krijimi i Regjistrit të Bizneseve të Diasporës.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2022

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

## *MASA 39*

Krijimi i strukturave administrative në pushtetin lokal për informimin dhe mbështetjen investimeve nga të interesuarit në diasporë. Ky informim i diasporës do të jetë i koordinuar për mundësitë e investimeve në Shqipëri për motivimin e bizneseve apo migrantëve shqiptarë për të investuar në sektorë të veçantë të ekonomisë.

**INDIKATORËT:** Krijimi i strukturave administrative në nivel lokal; Program për informimin e diasporës për investimet. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Brendshme
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

## *MASA 40*

Vlerësim vjetor për remitancat dhe politikat nxitëse bankare për diasporën shqiptare nën drejtimin e Bankës së Shqipërisë. Përpunimi dhe zbatimi i një politike koherente dhe të plotë për administrimin e dërgesave të diasporës. Rivlerësim për marrjen e masave për të rritur flukset e dërgesave të migrantëve duke motivuar migrantët që sjellin kursimet e tyre në Shqipëri..

**INDIKATORËT:** Aktivitet për vlerësim vjetor për remitancat; Vlerësim i politikave koherente për flukset e dërgesave nga jashtë vendit.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

*MASA 41*

Vlerësimi vjetor i masave për kalimin e dërgesave të migrantëve nga rrugët informale të transferimit në ato formale, dhe më pak të kushtueshme. Vendosja e një dialogu periodik me përfaqësuesit e sistemit bankar të vendit për këtë çështje. Nxitja e shoqërive private për të tërhequr dërgesat e emigrantëve nëpërmjet produkteve financiare (si p.sh.: letra me vlerë).

**INDIKATORËT:** Realizimi i aktivitetit vjetor për formalizimin e dërgesave nga diaspora në dialog me përfaqësuesit e sistemit bankar;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

*MASA 42*

Krijimi i zyrave të posaçme administrative në institucionet përgjegjëse të ekonomisë për trajtimin e diasporës shqiptare sidomos në zbatimin e politikave të dërgesave të migrantëve dhe lehtësimin e tërheqjes së investimeve nga diaspora.

**INDIKATORËT:** Krijimi i zyrave administrative në institucionet përgjegjëse financiare.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2022

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

## *MASA 43*

Bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe sistemin bankar privat për nxitjen e zgjerimit të shërbimeve bankare në vendet pritëse të diasporës si dhe për të afërmit e tyre në Shqipëri (kryesisht në zonat rurale). Nxitja e bankave në vendet pritëse që me ndihmën e shoqatave të migrantëve shqiptarë, të përcaktojnë shërbime "ad hoc" për emigrantët (brenda shkallës së mundësisë dhe negocimit).

**INDIKATORËT:** Aktivitet vjetor për rivlerësimin për përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve bankare.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

## *MASA 44*

Organizimi periodik i takimeve me rrjetet e biznesit në diasporë dhe i shkëmbimit të informacionit funksional nga çdo institucion që mbulon fushën e interesit për të investuar në vendlindje.

**INDIKATORËT:** Takime vjetore me rrjetet e biznesit dhe i shkëmbimit të informacionit.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

## *MASA 45*

Vlerësimi dhe nxitja e migrimit qarkullues ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë me anë të masave favorizuese apo negocimi i marrëveshjeve bilaterale (duke i dhënë përparësi Greqisë dhe Italisë). Realizimi një zyre kontakti dhe koordinimi për vlerësimin dhe monitorimin e gjendjes së tregjeve të huaja të punës dhe me pas ky informacion t'i kalohet institucioneve përgjegjëse.

**INDIKATORËT:** Realizimi i një programi të veçantë për masat favorizuese apo negocimi i marrëveshjeve bilaterale; Ngritja e një zyre kontakti dhe koordinimi për tregjet e huaja të punës. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Bujqësisë

## *MASA 46*

Organizimi i një programi të veçantë aktivitetesh vjetore për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare duke organizuar aktivitete periodike në funksion të rrjeteve të organizuara të prodhuesve shqiptarë dhe rrjetit të bizneseve shqiptare në diasporë të cilët tregtojnë prodhime të natyrave të tilla.

**INDIKATORËT:** Program vjetor me aktivitete për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

## *MASA 47*

Zhvillimi i aktiviteteve vjetore në fushën e prodhimeve vendase në koordinim me bizneset blerëse në diasporë në funksion të krijimit të hartëzimit së restoranteve dhe bizneseve të ushqimit në shtetet pritëse për të ndërlidhur me një projekt të veçantë bizneset shitëse dhe blerëse brenda dhe jashtë vendit.

**INDIKATORËT:** Zhvillimi i aktiviteteve vjetore; Krijimi i hartës së restoranteve dhe bizneseve.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

## *MASA 48*

Krijimin e një programi të veçantë ndihme për institucionet e mikrokreditimit për zbatimin e politikave që synojnë kanalizimin e dërgesave të emigrantëve nëpërmjet marrëveshjeve me institucionet financiare në vendet pritëse. Inkurajimi i shoqatave të migrantëve për nxitjen e zhvillimit lokal nëpërmjet mbledhjes vullnetare të donacioneve nga anëtarët për të financuar projekte të ndryshme në qytetin apo fshatin e tyre.

**INDIKATORËT:** Realizimi i një aktiviteti vjetor në ndihmë për institucionet e mikrokreditimit;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

## *MASA 49*

Rivlerësimi i politikave me qëllim nxitjen e kthimit të migrantëve të kualifikuar. Vlerësimi i ofertës dhe kërkesës për personel të kualifikuar, në tregun e punës shqiptar dhe krijimi i kontakteve ndërmjet migrantëve dhe ndërmarrjeve të mesme e të mëdha në Shqipëri, duke krijuar një bankë të dhënash elektronike me CV e migrantëve të kualifikuar.

**INDIKATORËT:** Krijimi i një banke të dhënash elektronike të profesionistëve në diasporë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Brendshme
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## *MASA 50*

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të jetë koordinuese për realizimin në bashkëpunim me sektorin e biznesit privat një program për shpërndarjen e informacioneve të karakterit ekonomik dhe përpilimin e një programi aktivitetesh vjetore periodike, që nxit marrëdhëniet e biznesit ndërmjet komuniteteve shqiptare në diasporë, me njëri-tjetrin dhe vendlindjen.

**INDIKATORËT:** Realizimi i strukturës së informimit nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për biznesin privat; Përpilimi i një programi aktivitetesh vjetore periodike.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

### *MASA 51*

Realizimi i programit të festave dhe ditëve të shënuara komunitare në bashkëpunim me sektorin privat, organizatat jofitimprurëse apo ato sportive dhe promovimi nga institucionet përgjegjëse të turizmit në tregje të rëndësishme për të rritur flukset turistike.

**INDIKATORËT:** Realizimi i një Programi vjetor aktivitetesh në funksion të sezonit turistik në Shqipëri.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Kulturës

## IV. ARSIMI DHE MESIMDHENIA

### *MASA 52*

Rishikimi i praktikave dhe kushteve për arsimimin e brezave të rinj të diasporës në gjuhën shqipe. Rivlerësimi i hartimit të kurrikulave standarde për mësimdhënien në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë.

**INDIKATORËT:** Realizimi i një aktiviteti vjetor për rishikimin e praktikave dhe kushteve për arsimimin dhe rivlerësimin i hartimit të kurrikulave për mësimdhënien;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Akademia e Shkencave

## *MASA 53*

Vlerësimi vjetor i nevojave për libra për mësimin në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë. Përmirësim periodik i kurrikulave të përbashkëta me Kosovën, për mësimdhënien në gjuhën shqipe. Mbështetje në zbatimin e kurrikulave të përbashkëta.

**INDIKATORËT:** Realizimi i një aktiviteti për vlerësimin vjetor të nevojave dhe cilësisë së librave të kurrikulës së përbashkët me Republikën e Kosovës.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

## *MASA 54*

Koordinimi dhe nxitja e marrëveshjeve të përbashkëta me shtetin e Kosovës për mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë. Rivlerësim për kuadrin ligjor lidhur me përgjegjësinë e shtetit shqiptar për të mundësuar mësimin e gjuhës shqipe për brezin e ri të komuniteteve shqiptare në diasporë.

**INDIKATORËT:** Krijimi i një Komisioni Teknik për vlerësimin e Marrëveshjeve me Republikën e Kosovës për takime e konkluzione vjetore;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## *MASA 55*

Përditësimi i Regjistrit të mësuesve në diasporë dhe i programeve për mbështetje në zbatimin e standardeve për mësuesit në diasporë. Certifikimi i mësuesve dhe hartim i skemës së pensioneve për mësuesit në diasporë. Organizimi i aktiviteteve arsimore vjetore me mësues e nxënës shqiptarë në diasporë.

**INDIKATORËT:** Realizimi i Regjistrit të mësuesve, krijimi i programeve mbështetëse; Organizimi vjetor i aktiviteteve me mësuesit në diasporë.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

## *MASA 56*

Krijimi i një strukture permanente e cila do të ndjekë trajnimin e mësuesve që do të japin mësim në diasporë. Sigurimi i vazhdueshëm i teksteve shkollore për diasporë dhe trajnimi i mësimdhënësve mbi kurrikulat e përbashkëta me Kosovën. Dërgimi i mësuesve me kontratë nga Shqipëria në shtetet pritëse nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.

**INDIKATORËT:** Forcimi i strukturës permanente (Qendrës së Botimeve në Diasporë), për tekstet shkollore dhe trajnimin e mësuesve; Sigurimi i teksteve shkollore dhe trajnimi i mësimdhënësve. Dërgimi mësuesve me kontratë në shtetet pritëse

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

## *MASA 57*

Zhvillimi i projektit "Mëso Shqip" dhe "e-book" (shkarkimi online i teksteve shkollor të vendosura në programin arsimor për diasporën) me qëllim shpërndarjen e librave në të gjithë botën dhe krijimin e lehtësirave për të furnizuar të gjithë me materiale plotësuese të nevojshme për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqipe.

**INDIKATORËT:** Realizimi i projektit "e-book" për shpërndarjen e librave on line

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

## *MASA 58*

Vlerësimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse (duke respektuat legjislacionin vendas), për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe në shkollat e ambientet edukative ekzistuese në këto vende. (Krijimi dhe nxitja e programeve për mësimdhënien e gjuhës shqipe për fëmijët e emigrantëve shqiptarë në bashkëpunim me strukturat përkatëse të vendeve pritëse).

**INDIKATORËT:** Realizimi i një aktiviteti vjetor për vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe  për gjendjen e hapjes së kurseve në gjuhën shqipe;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## *MASA 59*

Vlerësimi dhe orientimi i programeve/donatorëve, të cilët ofrojnë bursa studimore për jashtë vendit drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria. Rivlerësimi për përfshirjen e kushtit të kthimit në Shqipëri (për një periudhë jo më pak se një vit) për të gjithë studentët që marrin bursa studimi për jashtë vendit në kuadër të programeve studimore të donatorëve të ndryshëm për Shqipërinë.

**INDIKATORËT:** Realizimi i informimeve periodike në Komitetin Shtetëror të Diasporës për orientimin e programeve/donatorëve për të cilat ka nevojë Shqipëria;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## *MASA 60*

Krijimi i regjistrit të studentëve shqiptarë që studiojnë në universitetet jashtë vendit dhe mbi fushat ku ata specializohen. Krijimi i një projekti për nxitjen e komunikimit midis tyre jashtë vendit.

**INDIKATORËT:** Krijimi i regjistrit studentëve shqiptarë jashtë vendit dhe fushat ku specializohen; Organizimi i aktiviteteve vjetore për informim.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

### *MASA 61*

Kryerja e një raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve shqiptarë që studiojnë jashtë vendit dhe mbi faktorët që ndikojnë në këtë situatë. Ai do të vlerësohet në Komitetin Shtetëror të Diasporës

**INDIKATORËT:** Realizimi i raportit vlerësues mbi vështirësitë e studentëve dhe faktorët ndikues dhe informimi i Komitetit Shtetëror të Diasporës;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

## V. MEDIA DHE KOMUNIKIMI

### *MASA 62*

Krijimi dhe përditësimi i një banke të dhënash të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës, që funksionojnë në vendet që gjykohen si prioritare për politikat kombëtare mbi diasporën. Krijimi i rrjeteve të televizioneve dhe radiove shqiptare në diasporë dhe realizimi i një plan veprimi për komunikimin dhe trajnimin e gazetarëve në diasporë me projekte stimuluese dhe aktivitete vjetore për këtë qëllim.

**INDIKATORËT:** Realizimi i një banke të dhënash të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës; Realizimi i një aktiviteti vjetor me gazetarët e diasporës;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

## *MASA 63*

Organizimi i rrjetit të informimit për median shqiptare dhe të huaj për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë në strukturat përkatëse të vendeve pritëse si dhe në ato të organizatave ndërkombëtare. Krijimi i Forumit të Medias së Diasporës dhe organizmin e një aktiviteti vjetor.

**INDIKATORËT:** Krijimi i rrjetit të komunikimit dhe informimit për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve. Organizimi vjetor i Forumit të Medias së Diasporës

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2022 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

## *MASA 64*

Vlerësimi i cilësisë së faqeve të internetit të institucioneve shtetërorë për informacion të detajuar për komunitetet shqiptare jashtë vendit duke hapur edhe një seksion që i kushtohet kësaj teme (aty ku është e nevojshme). Realizimi i takimeve periodike (çdo 6 muaj) për vlerësimin dhe koordinimin me "kujdestarët" e faqeve të informacionit të institucioneve për nivelin e informimit që këto faqe ofrojnë për diasporën shqiptare.

**INDIKATORËT:** Raportim periodik për cilësinë e faqeve të internetit të institucioneve. Organizimi i një takimi vjetor me "kujdestarët" e faqeve të informacionit në institucionet shtetërore;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i dytë i 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

*MASA 65*

Planifikimi dhe realizimi i një fushate informuese mbi:
• Çështje që kanë të bëjnë me migracionin dhe diasporën
• Promovimin në shkallë të gjerë të regjistrimit të migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës (pas miratimit);
• Identitetin e shqiptarëve, historinë dhe kulturën shqiptare në diasporë
• Forcimi i Gazetës "Diaspora Shqiptare" me burime informative për çështje që interesojnë migracionin dhe diasporën dhe trajtimet rreth zhvillimeve më të fundit politike, sociale dhe ekonomike në vend;
Reflektimi në këtë fushatë të procesit që diaspora dhe migracioni do të jenë pjesë integrale të zhvillimeve politike dhe ekonomike të Shqipërisë.

**INDIKATORËT:** Organizimi i fushatës informuese për regjistrimin e migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës; Organizimi i një aktiviteti vjetor në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë –2021

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Brendshme
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

*MASA 66*

Rishikimi dhe vlerësimi i zonës së transmetimit nga televizionet dhe radiot shqiptare kombëtare në të gjitha vendet ku ka komunitete të diasporës dhe migrantësh shqiptarë. Krijimi dhe nxitja e programeve televizive në vend për temën e diasporës dhe protagonizmin e saj në shoqërinë shqiptare. Forcimi i kanalit të televizionit publik TVSH 3 për temën e diasporës. Nxitja për marrëveshje me mediat në vendet pritëse, me qëllim transmetimin prej tyre të programeve për komunitetet shqiptare.

**INDIKATORËT:** Realizimi i një aktiviteti vjetor për programet televizive për diasporën; Projekt për forcimin e kanalit të televizionit publik për diasporën TVSH 3;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

*MASA 67*

Krijimi i projekteve mediatike që nxisin krijimin e rrjeteve informuese për studentët dhe koordinimin e institucioneve përgjegjëse për arsimin për promovimin e rritjes së programeve të shkëmbimit dhe internship-it, të universiteteve shqiptare me universitetet në vendet pritëse me prani të lartë të studentëve shqiptarë.

**INDIKATORËT:** Realizimi i një aktiviteti vjetor dhe krijimi i projekteve mediatike dhe i programeve të shkëmbimit dhe internship-it.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

*MASA 68*

Organizimi i një plan veprimi të koordinuar mediatik për nxitjen dhe motivimin e diasporës shqiptare për shfrytëzimin e avantazheve në Shqipëri për qëllime turizmi dhe investimi. Përgatitja nga institucionet përgjegjëse të turizmit e një fushate promocionale, në bashkëpunim me sektorin privat të një pakete që siguron pritshmëritë. Si ikona të kësaj fushate mund të përfshihen figurat të njohura të diasporës në secilin treg.

**INDIKATORËT:** Realizimi i një aktiviteti vjetor dhe plan veprimi mediatik; Përgatitja e një fushate promocionale dhe e një pakete të veçantë për diasporën;

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
Ministria e Kulturës

# VI. MONITORIMI DHE TRANSPARENCA

*MASA 69*

Monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës mbi vlerësime 3 mujore (me Buletin periodik) dhe kryerja e informimit në Komitetin Shtetëror për Diasporën dhe në Nënkomisionin për Migracionin dhe Diasporën. Nënkomisioni kur e gjykon do të propozojë që për çështjen e trajtimit të migracionit dhe diasporës Kuvendi të miratojë një rezolutë për këtë çështje.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori i parë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

*MASA 70*

Vlerësimi nga Nënkomisioni për Migracionin dhe Diasporën dhe Komiteti Shtetëror për Diasporën në mbledhje të veçanta i dokumenteve të raportimit me shkrim të:

- Agjencisë Kombëtare të Diasporës;
- Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
- Qendrës së Botimeve për Diasporën
- Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025)

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën

*MASA 71*

Vlerësimi, diskutimi dhe propozime për ndryshime për dokumentin e Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit në Kuvendin Kombëtar të Diasporës Shqiptare. Këto propozime do shikohen si nismëtare për të kryer ndryshimet e mundshme në proces.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori dytë 2021 (periodike deri në 2025 )

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**

Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

*MASA 72*

Përcaktimi i indikatorëve të cilët do të evidentojnë nivelin e zbatimit të masave të vendosura nga kjo strategji. Detyrimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e strategjisë për hartimin e raporteve periodike për masat të marra duke përfshirë të dhëna sasiore edhe cilësore të monitorimit, bazuar në indikatorët e përcaktuar.

**AFATI KOHOR:** 6 mujori parë 2021 (periodike deri në 2025 )

**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:**
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

# SHTOJCA II – BURIMET E FINANCIMIT DHE AKTIVITETET

# LISTA E AKRONIMEVE

| | |
|---|---|
| **MSHD** | Ministri i Shtetit për Diasporën |
| **MEPJ** | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme |
| **MFE** | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| **MD** | Ministria e Drejtësisë |
| **MK** | Ministria e Kulturës |
| **MSHMS** | Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes |
| **MIE** | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë |
| **AKD** | Agjencia Kombëtare e Diasporës |
| **INSTAT** | Instituti i Statistikave |
| **MASR** | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë |
| **MB** | Ministria e Brendshme |
| **MBZHR** | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural |
| **MSHMS** | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| **MTM** | Ministria e Turizmit dhe Mjedisit |

# BURIMET FINANCIARE

Kjo Shtojcë trajton burimet financiare të nevojshme për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare 2021-2025.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e masave, në peridhën 5 vjecare të aplikimit të Planit të Veprimit nga të gjitha burimet e financimit, të cilat përfshinë ato buxhetore dhe të donatorëve është rreth 1,63 miliardë lekë ose afërsisht 13.06 milionë euro. Burimet nga buxheti i shtetit janë të alokuara në programet buxhetore të institucioneve shtetërore të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e Planit të Veprimit.

Alokimi i fondeve për periudhën 2021-2023 është programuar duke mbajtur në konsideratë tavanet e projektbuxhetit afatmesëm (PBA 2021-2023). Burimet financiare nga buxheti i shtetit mbulojnë rreth 76.8% të kostos së strategjisë, përkatësisht rreth 1.25 miliardë lekë. Ndërsa burimet e financimit të angazhuara nga donatorët dhe burime të tjera mbulojnë 1.7% të kostos së strategjisë ose rreth 27.2 milionë lekë.

Hendeku financiar i pambuluar nga buxheti është 21.4%. Ai është pjesë e kërkesave buxhetore shtesë dhe bisedimeve me donatorët të ndryshëm dhe përbëhet kryesisht nga kosto për aktivitete plotësuese si: organizimi i Kuvendit të Diasporës Shqiptare, krijimi i një programi të veçantë ndihme për institucionet e mikrokreditimit për zbatimin e politikave që synojnë kanalizimin e dërgesave të emigrantëve nëpërmjet marrëveshjeve me institucionet financiare në vendet pritëse, dërgimi i mësuesve me kontratë nga Shqipëria në shtetet pritëse etj.

Shpenzimet e nevojshme për zbatimin e PKV janë nxjerrë duke kostuar më vete secilën nga masat e planit të veprimit. Në llogaritjen e shpenzimeve totale është marrë në konsideratë kohështrirja e masës, numri i përfituesve për aktivitete të caktuara, etj. Kostimi i Planit të Veprimit është realizuar bazuar në praktikën e planifikimit buxhetor.

Tabela 1 paraqet buxhetin në vite sipas objektivave strategjike. 72.9% e shpenzimeve nevojiten për objektivin strategjik B.

*Kursi këmbimit 1Euro=125 lekë*

| Përshkrimi | Buxheti 2021-2025 | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **OBJEKTIVAT** | **Viti 2021** | **Viti 2022** | **Viti 2023** | **Viti 2024** | **Viti 2025** | **TOTALI** |
| Objektivi Specifik A: Forcimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve me diasporën shqiptare | 13.836.000 00 | 33.731.000 00 | 19.891.000 00 | 18.637.000 00 | 18.637.000 00 | 104.732.000 00 |
| Objektivi Specifik B: Mbështetja e organizimeve në diasporë | 206.310.000 00 | 292.096.800 00 | 206.072.000 00 | 280.096.800 00 | 206.072.000 00 | 1.190.647.600 00 |
| Objektivi Specifik C: Krijimi i lehtësive për tërheqjen e investimeve nga diaspora dhe roli i remitancave | 7.600.000 00 | 37.610.000 00 | 31.250.000 00 | 31.250.000 00 | 31.150.000 00 | 138.860.000 00 |
| Objektivi Specifik D: Zbatimi i programeve për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë | 42.944.499 00 | 14.410.998 00 | 26.795.499 00 | 26.795.499 00 | 26.795.499 00 | 150.126.495 00 |
| Objektivi Specifik E: Informimi i diasporës mbi zhvillimet social ekonomike në vendin e origjinës | 5.956.000 00 | 15.654.000 00 | 7.154.000 00 | 7.154.000 00 | 7.154.000 00 | 43.072.000 00 |
| Objektivi Specifik F: Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit të strategjisë Kombëtare të Diasporës | 1.140.000 00 | 912.000 00 | 1.140.000 00 | 912.000 00 | 1.140.000 00 | 5.244.000 00 |
| **TOTAL (1+2+3+4+5)** | **277.786.499 00** | **394.414.798 00** | **292.302.499 00** | **364.845.299 00** | **290.948.499 00** | **1.632.682.095 00** |

Tabela 2 paraqet buxhetin sipas burimeve të financimit dhe hendekun financiar për secilin nga objektivat specifikë.

Tabela 2: Kostimi i zbatimit të planit të veprimit sipas objektivave 2021-2025

| Objektivat strat egjike dhe nën objektivat të mbuluara nga dokumenti strategjik | Kosto Totale (në 000/ Lek) | Financimi (në 000/ Lek) | | Hendeku Financiar (në 000/ Lek) | Komente për objektivat me hendek financiar |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Buxhet | Donatorët | | |
| TOTALI | 1,632,682.095 | 1,253,639.495 | 27,260 | 349,958.600 | |
| Objektivi Specifik A: Forcimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve me diasporën shqiptare | 104,732 | 72,113 | 6,000 | 26,619 | |
| 1.1 Krijimi i një Kulture Administrative | 40,478 | 26,978 | 0 | 13,500 | Nevojiten fonde për ngritjen e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse të diasporës |
| 1.2 Forcimi i kuadrit ligjor për diasporën | 17,654 | 17,654 | 0 | 0 | |
| 1.3 Shërbime dhe aktivitete për diasporën | 28,353 | 16,209 | 6,000 | 6,1440 | Nevojiten fonde për kryerjen e fushatave sensibilizuese ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve dhe organizimi i takimeve të komuniteteve shqiptare në diasporë |
| 1.4 Forcimi i kapaciteteve dhe rrjeteve të profesionistëve | 18,247 | 11,272 | 0 | 6,975 | Nevojiten fonde për trajnimin dhe certifikimin e trupit diplomatik për çështjet e migracionit; organizimi dhe mbështetja e grupeve dhe shoqatave të diasporës |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Objektivi Specifik B: Mbështetja e organizimeve në diasporë | 1,190,647.6 | 1,048,708 | 0 | 141,939.6 | |
| 2.1 Mekanizma për mbështetjen e organizimit | 5,094 | 4,104 | 0 | 990 | |
| 2.2 Lidhjet me Diasporën shqiptare | 166,653.6 | 25,704 | 0 | 140,949.6 | Nevojiten fonde për organizimin e Kuvendeve të Diasporës dhe aktiviteteve mbi bazën e profesioneve |
| 2.3 Çmimi "Ambasador i Kombit" | 4,500 | 4,500 | 0 | 0 | |
| 2.4 Çertifikata e Diasporës | 4,200 | 4,200 | 0 | 0 | |
| 2.5 Specialistë dhe studiues të Diasporës | 1,010,200 | 1,010,200 | 0 | 0 | |
| Objektivi Specifik C: Krijimi i lehtësive për tërheqjen e investimeve nga diaspora dhe roli i remitancave | 138,860 | 50,800 | 21,260 | 66,800 | |
| 3.1 Tërheqja e investimeve nga diaspora | 23,660 | 5,600 | 13,260 | 4,800 | Nevojiten fonde për krijimin e strukturave administrative në nivel lokal informimin e diasporës |
| 3.2 Formalizimi i dërgesave të diasporës dhe remitancave | 71,400 | 1,400 | 8,000 | 62,000 | Nevojiten fonde kryesisht për programin e ndihmës për institucionet e mikrokreditimit |
| 3.3 Përfshirja e diasporës në jetën ekonomike të vendit | 43,800 | 43,800 | 0 | 0 | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Objektivi Specifik D: Zbatimi i programeve për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë | 150,126.495 | 73,126.495 | 0 | 77,000 | |
| 4.1 Programi i kulturës dhe gjuhës shqipe | 16,904 | 16,904 | 0 | 0 | |
| 4.2. Mësuesit në Diasporë | 79,364 | 6,894 | 0 | 72,500 | Nevojite fonde p`r dërgimin e mësuesve me kontratë nga Shqipëria në shtetet pritëse dhe organizimi i aktiviteteve arsimore vjetore me mësues e nxënës shqiptar në diasporë |
| 4.3 Tekstet shkollore për Diasporën | 42,708.495 | 42,708.495 | 0 | 0 | |
| 4.4 Studentët në Diasporë | 11,150 | 6,650 | 0 | 4,500 | Nevojiten fonde p`r kryerjen e një raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve shqiptare që studiojnë jashtë vendit. K`to mund t` financohen dhe nga donator` si projekte. |
| Objektivi Specifik E: Informimi i diasporës mbi zhvillimet social ekonomike në vendin e origjinës | 43,072 | 5,472 | 0 | 37,600 | |
| 5.1 Mbështetja e rrjeteve të informimit dhe mediave në diasporë | 22,292 | 3,192 | 0 | 19,100 | Fondet nevojiten për aktivitete si organizimi vjetor i Forumit të Medias së Diasporës; Projekt për forcimin e Kanalit të televizionit publik për diasporën; projekteve mediatike dhe i programeve të shkëmbimit. Për këto aktivitete mund të bashkëpunohet dhe me donatorë. K`to mund t` financohen dhe nga donator` si projekte. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 5.2 Informimi i diasporës shqiptare | 20,780 | 2,280 | 0 | 18,500 | Fondet nevojiten për aktivitete si organizimi i fushatës informuese për regjistrimin e migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës; organizimi i aktiviteteve të drejtën e votës. Për këto aktivitete mund të bashkëpunohet dhe me donatorë. |
| Objektivi Specifik F: Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit të strategjisë Kombëtare të Diasporës | 5,244 | 5,244 | 0 | 0 | |
| 6.1 Monitorimi dhe vlerësimi | 5,244 | 5,244 | 0 | 0 | |

## *SHTOJCA II – LISTA E AKTIVITETEVE PËR ÇDO MASË*

| Objektivi Specifik A: Forcimi dhe zhvillimi i marrëdhënieve me diasporën shqiptare | | | | | | Treguesit e Rezultatit/-eve: Zhvillimi i kuadrit ligjor kombëtar për angazhimin e diasporës; pasja e niveleve adekuate të personelit për të siguruar zbatimin efikas dhe për të koordinuar angazhimin e diasporës; Ngritja e kapaciteteve institucionale; | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Nën-objektivi | Veprimet që do të ndërmerren | Afati Kohor | Burimet Financiare në mijëra lekë shqiptare | Institucionet përgjegjëse | Rezultatet & Treguesit | |
| 1 | Marrëdhëniet shtetërore me diasporën | Krijimi i një Kulture Administrative<br>1.1.1 Koordinimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse që legjislacioni i ri ngarkon për fushën e marrëdhënieve shtetërore me diasporën me Agjencinë Kombëtare për Diasporën, Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendrën e Botimeve për Diasporën dhe Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët. | 2021-2025 | 2,850 | MSHD<br>MFE | Koordinimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën. | Numri i institucioneve të ngritura për të siguruar zotimin e Shqipërisë për Angazhimin me Diasporën; |
| | | 1.1.2 Hartimi i një plani të detajuar për financimin e politikave dhe masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare. | 2021-2025 | 380 | MSHD<br>MFE | Hartimi i planit për financimin e masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën. | Numri i rekomandimeve specifike të miratuara në përputhje me zbatimin e këtij Plani Veprimi, për të siguruar një shkallë më të lartë përgjegjësie dhe zbatimin e suksesshëm të tij. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1.1.3 Krijimi i një njësie të specializuar për rivlerësimin e legjislacionit për diasporën për të ndërmarrë ndryshimet e nevojshme. | 2021-2025 | 14,400 | MSHD<br>MFE | Një reformë gjithëpërfshirëse ligjore e legjislacionit shqiptar që lidhet me angazhimin e diasporës, së bashku me rekomandimet për ndryshimet ligjore nga ministritë e linjës. | Numri i ndryshimeve ligjore të miratuara çdo vit për të siguruar zotimet e Shqipërisë në angazhimin e diasporën. |
| | | 1.1.4 Ndjekja e procedurave të nevojshme koordinative për të diskutuar çdo vit në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe për të parashikuar në buxhetin vjetor (pasardhës) fondet e nevojshme për të zbatuar Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit deri në vitin 2025 | 2021-2025 | 1,900 | MFE<br>MASR<br>MK<br>MSHD | Diskutimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën dhe parashikimi i fondeve buxhetore të nevojshme për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit. | Numri i mbledhjeve të Komitetit Shtetëror për Diasporën të realizuara për këtë qëllim. |
| | | 1.1.5 Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor të aktiviteteve për diasporën (aktivitetet që përfshinë librin, arsimin, kulturën, turizmin dhe biznesin) dhe përgatitja e informacioneve vlerësuese për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin e Kuvendit për Diasporën dhe Migracionin. | 2021-2025 | 2,090 | MSHD | Miratimi i Proggramit Vjetor për Diasporën. Përgatitja e informacioneve për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin e Kuvendit për Diasporën dhe Migracionin. | Numri i programeve të miratuara; Informacionet e përgatitura për Komitetin Shtetëror për Diasporën dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin. |
| | | 1.1.6 Përgatitja e raporteve vjetore nga institucionet përgjegjëse ku të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi per komunitetet shqiptare në shtetet pritëse. Krijimi i një botimi të përbashkët për raportimet për diasporën | 2021-2025 | 3,230 | MEPJ<br>MSHD<br>MASR | Përgatitja dhe publikimi i raporteve vjetore nga Banka e Shqipërisë dhe INSTAT. Botimi i përbashkët për raportet vjetore. | Numri i raporteve të publikuara. Numri i botimeve të realizuara. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shqiptare. | | | | | |
| | | 1.1.7 Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse të diasporës në bashkëpunim me Kosovën në kuadër të ruajtjes së identitetit kombëtar dhe ofrimit të shërbimeve e informacioneve për komunitetet e shqiptarëve në diasporë. | 2022 | 13,500 | MEPJ<br>MSHD<br>MFE<br>MK<br>MASR | Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse të diasporës. Realizimi i programimit buxhetor.Angazhim i shtuar ndërmjet ambasadave/konsullatave dhe organizatave të komunitetit të diasporës; | Numri i Qendrave Kulturore të ngritura. |
| | | 1.1.8 Rivlerësimi periodik i politikës së shërbimeve, procedurave dhe tarifave të tyre. | 2022 - 2025 | 2,128 | MEPJ<br>MSHD<br>MFE<br>MASR<br>MD | Hartimi i raportit nga Agjencia Kombëtare e Diasporës. Raportim në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | Hartimi i raportit dhe raportimi në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë |
| | | Forcimi i kuadrit ligjor për diasporën<br><br>1.2.1 Vlerësimi i përqasjes të strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e | 2021-2025 | 1,140 | MSHD<br>MASR<br>MFE | Përqasja e Strategjive të tjera aktuale apo që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare të Diasporës. Organizimi i një takimi vjetor në nivel teknik. | Numri i dokumenteve strategjikë të përqasur me Strategjinë Kombëtare të Diasporës. Numri i takimeve vjetore të zhvilluara. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Veprimit për Diasporën. Realizimi i një takimi vjetor në nivelin teknik për këtë qëllim. | | | MSHMS | | |
| | | 1.2.2 Rishikimi i kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit me shtetet pritëse me qëllim përfshirjen në këto marrëveshje të formimit profesional, ose për to të diskutohet në veçanti. Raportim vjetor në Komitetin Shtetëror të Diasporës | 202 - 2025 | 3,040 | MEPJ MSHD MFE | Rishikimi i marrëveshjeve për migracionin dhe të punësimit me vendet pritëse të diasporës shqiptare. Raportim vjetor në Komitetin Shtetëror të Diasporës | Numri i marrëveshjeve të rishikuara. Numri i raportimeve në Komitetin Shtetëror të Diasporës. |
| | | 1.2.3 Organizimi i nxitjes e forcimit të marrëdhënieve të Shqipërisë me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare dhe bashkëpunimi i programit të punës të shërbimit diplomatik dhe konsullor me fokus të veçantë nga këndvështrimi i forcimit të statusit të diasporës shqiptare | 2021-2025 | 3,100 | MEPJ MSHD | Organizimi i një aktiviteti vjetor për vlerësimin e strukturës së përfaqësimi diplomatik dhe konsullor. | Numri i aktiviteteve të zhvilluara. |
| | | 1.2.4 Bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse në aplikimin për projekte kushtuar diasporës me donatorët kombëtare dhe ndërkombëtare. | 2021-2025 | 2,850 | MEPJ MSHD | Bashkëpunimi në realizimin e projekteve për diasporën shqiptare. | Numri i projekteve të realizuara në bashkëpunim me donatorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1.2.5 Vlerësimi i strukturës së akteve ligjore dhe marrëveshjeve në fushën e migracionit për zgjerimin e mbrojtjes së interesave të komuniteteve shqiptare jashtë vendit në përputhje me standardet ndërkombëtare. Realizimi i një takimi vjetor për rivlerësimin e akteve ligjore ekzistuese në fushën e migracionit dhe zbatimin e procedurave për ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare. | 2021-2025 | 2,660 | MEPJ<br>MD<br>MB<br>MSHD | Vlerësimi i kuadrit ligjor në fushën e migracionit. Realizimi i takimit vjetor për këtë qëllim. | Numri i akteve të rishikuara. Numri i takimeve të zhvilluara. |
| | | 1.2.6 Bashkëpunim shtetëror me institucionet e vendeve pritëse. Krijimi i komisioneve dypalëshe konsultative dhe informimi publik për ecurinë. | 2022-2025 | 4,560 | MEPJ<br>MSHD<br>MD | Krijimi i komisioneve dypalëshe. | Numri i komisioneve të krijuara. |
| | | 1.2.7 Vendosja e kontakteve të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI). | 2021 | 304 | MEPJ<br>MSHD<br>AKD<br>MD<br>MB | Vendosja e kontakteve dhe bashkëpunimit me ERLAI. | Vendosja e kontakteve; numri i çështjeve të adresuara apo shërbimeve, si rezultat i vendosjes së bashkëpunimit me këtë grup (ERLAI). |
| | | 1.3 Shërbime dhe aktivitete për diasporën<br><br>1.3.1 Informimi periodik i Komitetit Shtetëror të Diasporës për gjendjen e qytetarëve shqiptare jashtë vendit për shërbimet nëpërmjet platformës konsullore online. Organizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik. | 2021-2025 | 2,280 | MEPJ<br>MD<br>MSHD<br>MASR | Informimi i vazhdueshëm i Komitetit Shtetëror për Diasporën mbi përdorimin e shërbimeve konsullore online nga qytetarët shqiptarë jashtë vendit. | Numri i raportimeve në Komitetin shtetëror të Diasporës. Numri i aktiviteteve të kryera. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1.3.2 Zgjerimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes civile me të dhëna për migrantët dhe organizimi i aktiviteteve jashtë vendit. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | 2021-2025 | 4,125 | MEPJ<br>MB<br>MSHD | Përditësimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile me të dhëna për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Raportimi në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë. | Numri i raportimeve të kryera. |
| | | 1.3.3 Shpërndarja e informacionit në lidhje me statusin të drejtat si edhe shërbimet që ju ofrohen komuniteteve shqiptare në shtetet pritëse. Realizimi i një takimi vjetor në nivel teknik | 2022-2025 | 3,040 | MEPJ<br>MD<br>MB<br>MSHD<br>MASR | Shpërndarja e informacionit mbi statusin dhe të drejtat e komuniteteve shqiptare në dasporë. Realizimi i takimit vjetor në nivel teknik | Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave, fletëpalosjeve, app, etj. Numri i takimeve të zhvilluara. |
| | | 1.3.4 Realizimi i komunikimeve ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | 2021-2025 | 4,180 | MEPJ<br>MSHD<br>AKD<br>MSHMS<br>MD | Vendosja e bashkëpunimit ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase për mbrojtjen e migrantëve. Raportimi në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | Numri i raportimeve të realizuara. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1.3.5 Negocimi për marrëveshjet dypalëshe me vendet pritëse. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | 2021-2025 | 1,824 | MEPJ<br>MSHD<br>MFE<br>MSHMS<br>MD | Negocimi i marrëveshjeve dypalëshe me vendet pritëse në fushën e sigurimeve shoqërore. Raportimi në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | Numri i marrëveshjeve dypalëshe për të cilat vazhdon puna; numri i marrëveshjeve dypalëshe të nënshkruara; numri i marrëveshjeve dypalëshe të diskutuara, të hartuara e të nënshkruara. Numri i raportimeve të kryera. |
| | | 1.3.6 Kryerja e fushatave sensibilizuese ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve. Kordinimi për raportimin periodik të rasteve për shkelje të të drejtave të migrantëve shqiptarë. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | 2023-2025 | 2,679 | MEPJ<br>MSHD<br>MD | Kryerja e fushatave sensibilizuese ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve. Raportimi në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | Numri i fushatave të realizuara. Numri i raportimeve të kryera. |
| | | 1.3.7 Koordinimi dhe organizimi i takimeve të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor. Realizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik | 2021-2025 | 3,465 | MEPJ<br>MSHD<br>MK<br>MTM<br>MIE<br>MSHMS | Organizimi i takimeve apo "Ditëve të Shqipërisë" në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë. Realizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik | Numri i aktiviteteve të kryera. Numri i aktiviteteve vjetore në nivel teknik |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1.3.8 Koordinimi me Institucionet Shëndetësore, publike dhe private, për promovimin e turizmit shëndetësor. Përgatitja e një fushate për promovimin e turizmit shëndetësor. Realizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik | 2022-2025 | 6,000 | MEPJ<br>MSHD<br>MSHMS<br>MTM | Organizimi i fushatës promovuese për turizmin shëndetësor. Organizimi i aktivitetit vjetor në nivel teknik | Numri i takimeve të realizuara. |
| | | 1.3.9 Nënshkrimi dhe/ose amendimi i marrëveshjeve dypalëshe me shtetet pritëse të diasporës për përfshirjen e komunitetit të shqiptarëve të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | 2021 | 760 | MK<br>MEPJ<br>MSHD | Nënshkrimi/amendimi i marrëveshjeve me vendet pritëse. Raportimi në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | Numri i marrëveshjeve të nënshkruara/amenduara. Numri i raportimeve të kryera. |
| | | 1.4 Forcimi i kapaciteteve dhe rrjeteve të profesionistëve<br><br>1.4.1 Krijimi i dhe administrimi të një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit. Realizimi vjetor i një aktiviteti në nivel teknik | 2022-2025 | 1,824 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Krijimi dhe administrimi i rrjetit të studiuesve në fushën e migracionit. Realizimi i aktivitetit në nivel teknik | Numri i studiuesve që bëjnë pjesë në rrjet. Numri i takimeve të realizuara. |
| | | 1.4.2 Organizimi i trajnimeve të përgjithshme dhe të veçanta periodike. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve. Hartimi i moduleve trajnuese. Realizimi i një takimi vjetor në nivel teknik | 2021-2025 | 3,250 | MD<br>MASR<br>MEPJ<br>MSHD | Identifikimi i nevojave për trajnim; Hartimi i moduleve; Realizimi i trajnimeve; Realizimi i takimit teknik vjetor | Numri i trajnimeve të realizuara. Numri i takimeve vjetore teknike të zhvilluara |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1.4.3 Vendosja e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë me qëllim organizimin e trajnimeve në fushën e migracionit. | 2021 - 2025 | 1,900 | MSHD<br>MEPJ<br>MASR<br>MD | Hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit; Organizimi i trajnimeve në fushën e migracionit. | Numri i marrëveshjeve të realizuara; Numri i trajnimeve të zhvilluara. |
| | | 1.4.4 Hartimi i manualeve praktike me aktet ligjore/nënligjore. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë për cështjet e migracionit. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | 2021 - 2025 | 3,600 | MEPJ<br>MB<br>MSHD<br>MD | Hartimi i manualeve; Organizimi i trajnimeve për trupin diplomatik; Raportimi në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | Numri i personave të trajnuar; Numri i trajnimeve të kryera; Numri i raportimeve të realizuara |
| | | 1.4.5 Krijimi i regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | 2022 - 2025 | 1,824 | MEPJ<br>MSHD<br>MD | Krijimi i regjistrit; Raportimi në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | Numri i shtetasve shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit; Numri i raportimeve të kryera |
| | | 1.4.6 Organizimi dhe mbështetja e grupeve dhe shoqatave të diasporës; | 2022 | 3,375 | MEPJ<br>MSHD | Organizimi i rrjeteve sipas profesioneve, fushave të interesit apo vendndodhjes gjeografike; Zbatimi i projekteve të veçanta për këtë qëllim | Numri i rrjeteve të krijuara; Numri i projekteve të zbatuara; |
| | | 1.4.7 Organizimi i aktiviteteve të veçanta vjetore për rrjetet e profesionistëve | 2022 - 2025 | 1,980 | MSHD<br>MEPJ<br>MD | Organizimi i aktiviteteve | Numri i aktiviteteve të zhvilluara; Numri i pjesëmarrësve |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | MSHMS | | |
| | | 1.4.8 Mbështetja e organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | 2023 | 494 | MEPJ<br>MSHD<br>AKD<br>MD | Mbështetja në forcimin dhe zgjerimin e organizatave të diasporës shqiptare. Raportim në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | Numri i strukturave lokale këshilluese të krijuara; Numri i raportimeve të kryera. |

| Objektivi Specifik B: Mbështetja e organizimeve në diasporë | | | | | | Treguesit e Rezultatit/-eve: Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në diasporë dhe nxitja e organizimit të rrjeteve të profesionistëve; Krijimi i Rrjetit të Grave të Diasporës shqiptare; Organizimi i Kuvendit të Diasporës Shqiptare; Krijimi i një regjistri të veçantë të shoqatave shqiptare që veprojnë në vendet pritëse; | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Nën-objektivi | Veprimet që do të ndërmerren | Afati Kohor | Burimet Financiare në mijëra lekë shqiptare | Institucionet përgjegjëse | Rezultatet & Treguesit | |
| 2 | Organizimi i diasporës | 2.1 Mekanizma për mbështetjen e organizimit të diasporës<br><br>2.1.1 Vlerësimi i nivelit organizativ te komuniteteve shqiptare ne vendet pritëse. | 2021-2025 | 3,800 | MSHD<br>MEPJ<br>MASR<br>MK | Vlerësimi i nivelit organizativ te komuniteteve shqiptare ne diaspore dhe nxitja e organizimit të rrjeteve të profesionistëve. | Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë. |
| | | 2.1.2 Organizimi i një plani veprimi me Këshillin Koordinues të Diasporës për forcimin organizativ dhe angazhimin e komuniteteve shqiptare | 2021 | 304 | MSHD<br>MEPJ | Hartimi i një plani veprimi | Miratimi i planit të veprimit |
| | | 2.1.3 Krijimi i një plani veprimi të përbashkët me shtetin e Kosovës | | | MEPJ | Kordinimi me Republikën e Kosovës për fushën e | Hartimi i një plani veprimi; koordinimi i marrëveshjeve me Malin e Zi, Maqedoninë e |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 2021 | 990 | MASR<br>MSHD | marrëdhënieve me diasporën shqiptare në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese midis dy shteteteve. | Veriut dhe Serbinë; Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë |
| | | 2.2 Lidhjet me Diasporën shqiptare<br>2.2.1 Rrjeti i Grave të Diasporës shqiptare | 2022-2025 | 1,824 | MEPJ<br>MSHD<br>MSHMS | Krijimi i Rrjetit të Grave të Diasporës shqiptare; Promovimi i rrjetit. | Identifikimi i grave udhëheqëse të diasporës shqiptare. |
| | | 2.2.2 Organizimi i Samitit të Grave të Diasporës | 2022-2025 | 15,800 | MEPJ<br>MSHD<br>MSHMS | Organizimi i Samitit të Grave të Diasporës; promovimi i rrjetit. | Identifikimi i grave udhëheqëse të diasporës shqiptare. |
| | | 2.2.3 Organizimi i Kuvendit të Diasporës Shqiptare | 2021-2025 | 132,249.6 | MSHD<br>MEPJ<br>MFE<br>MASR | Organizimi i Kuvendit të Diasporës Shqiptare | Krijimi i Grupit te Punës për përgatitjen dhe organizimin e Kuvendit të Diasporës Shqiptare; Organizimi periodik i Kuvendit të Diasporës Shqiptare. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2.2.4 Evidentimi i shoqatave kulturore, sportive, arsimore, sociale, shkencore që veprojnë në vendet pritëse. | 2021-2025 | 2,280 | MEPJ<br>MASR<br>MK<br>MSHD | Krijimi i një regjistri të veçantë të shoqatave shqiptare që veprojnë në vendet pritëse. | Numri i shoqatave të identifikuara; raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin. |
| | | 2.2.5 Organizimi i aktiviteteve mbi bazën e profesioneve të cilat nxisin rrjetet e profesionistëve dhe identifikimin e burimeve njerëzore | 2021-2025 | 14,500 | MSHD<br>MEPJ<br>MASR<br>MK | Organizimi i aktiviteteve mbi bazën e profesioneve të anëtarëve të diasporës | Numri i aktiviteteve të organizuara; numri i personave që kanë marrë pjesë në aktivitete; numri i shteteve ku u organizuan aktivitetet. |
| | | 2.3 Çmimi "Ambasador i Kombit"<br><br>2.3.1 Promovimi i rasteve të personaliteteve të suksesshme dhe dhënia e çmimit | 2021-2025 | 4,500 | MSHD<br>MEPJ | Promovimi i rasteve të personaliteteve të suksesshme dhe dhënia e çmimit | Krijimi i rrjetit të Ambasadorëve; numri i çmimeve të dhëna; frekuenca e dhënies së çmimeve. |
| | | 2.4 Çertifikata e Diasporës<br>2.4.1 Pajisja e pjesëmarrësve në Shkollën Verore me çertifikatën "Jam Shqiptar" | 2021 | 4,200 | MSHD<br>MEPJ | Pajisja e pjesëmarrësve në Shkollën Verore me çertifikatën "Jam Shqiptar" | Realizimi i projektit të Shkollës Verore; numri i pjesëmarrësve në Shkollën Verore; shpërndarja e Certifikates "Jam Shqiptar" |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2.5 Specialistë dhe studiues të Diasporës Shqiptare<br>2.5.1 Krijimi i regjistrit të Diasporës së kualifikuar | 2023-2025 | 1,800 | MSHD<br>MEPJ<br>MFE<br>MIE<br>MASR | Krijimi i regjistrit të Diasporës së kualifikuar | numri i profesionistëve të identifikuar; identifikimi i aftësive, arsimit dhe përvojave të diasporës. |
| | | 2.5.2 Krijimi i mundësive dhe lehtësirave për studentët shqiptarë të studiojnë jashtë | 2023-2025 | 1,000,000 | MSHD<br>MEPJ<br>MFE<br>MIE<br>MASR | Krijimi i mundësive dhe lehtësirave për studentët shqiptarë të studiojnë jashtë nëpërmjet një rrjeti të ngritur në Diasporë | Numri i studentëve që do të studiojnë jashtë; krijimi i rrjetit në Diasporë; Organizimi i një aktiviteti vjetor në nivel teknik |

| Objektivi Specifik C: Krijimi i lehtësive për tërheqjen e investimeve nga diaspora dhe roli i remitancave | | | | | | | Treguesi/-it i/e Rezultatit/-eve: Organizimi i aktiviteteve vjetore me bizneset në diasporë; Krijimi i zyrave të posaçme për tërheqjen e investimeve nga diaspora; marrja e masave për formalizimin e dërgesave |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | Ekonomia dhe biznesi | 3.1 Tërheqja e investimeve nga diaspora<br><br>3.1.1 Forcimi i bashkëpunimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës me bizneset shqiptare në Diasporë nxitja e tyre për anëtarësim pranë kësaj Dhome | 2022 | 760,000 | MFE<br>MSHD<br>MSHMS | Organizimi i një aktiviteti vjetor me bizneset në diasporë; krijimi i Regjistrit të Bizneseve në Diasporë | Numri i aktiviteteve të zhvilluara; numri i bizneseve të përfshira në Regjistër; numri i bizneseve të anëtarësuara pranë Dhomës së Biznesit për Diasporën |
| | | 3.1.2 Krijimi i strukturave administrative në nivel lokal; Program për informimin e diasporës për investimet. | 2022 - 2025 | 4,800 | MB<br>MFE<br>MSHD<br>MSHMS | Krijimi i strukturave administrative lokale, hartimi i programit për informimin e diasporës lidhur me investimet; raportimi në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e | Numri i strukturave administrative lokale të krijuara; numri i raportimeve |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Shqipërisë | |
| | | 3.1.3 Krijimi i zyrave administrative në institucionet përgjegjëse financiare | 2022 | 5,600 | MFE<br>MIE<br>MSHD<br>MEPJ<br>MSHMS | Krijimi i zyrave të posaçme | Numri i zyrave të krijuara |
| | | 3.1.4 Organizimi i takimeve vjetore me rrjetet e biznesit | 2021 - 2025 | 12,500 | MFE<br>MEPJ<br>MIE<br>MSHD<br>MSHMS<br>MBZHR<br>MTM | Organizimi i takimeve vjetore | Numri i takimeve të zhvilluara |
| | | 3.2 Formalizimi i dërgesave të diasporës dhe remitancave<br><br>3.2.1 Kryerja e një vlerësimi vjetor të masave për kalimin e dërgesave të migrantëve nga rrugët informale të transferimit | 2022 - 2025 | 6,000 | MFE<br>MSHD<br>MEPJ | Realizimi i një vlerësimi/studimi vjetor me masa për nxitjen e kalimint të dërgesave në rrugët formale | Numri i vlerësimeve të kryera; shkalla e realizimit të masave të përcaktuara |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në ato formale përmes dialogut me përfaqësuesit e sistemit bankar | | | | | |
| | | 3.2.2 Organizimi i një aktiviteti për vlerësimin vjetor për remitancat; Vlerësim i politikave koherente për flukset e dërgesave nga jashtë vendit | 2022 - 2025 | 1,400 | MFE<br>MSHD<br>MEPJ | Organizimi i një aktiviteti vjetor për remitancat | Numri i aktiviteteve të organizuara |
| | | 3.2.3 Vendosja e bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë dhe bankat e nivelit të dytë për zgjerimin e shërbimeve bankare për diasporën | 2021 - 2025 | 2,000 | MFE<br>MSHD<br>MSHMS | Zgjerimi i shërbimeve bankare për diasporën; vendosja e shërbimeve ad hoc për aq sa është e mundur | Numri i shërbimeve bankare të dedikuara për diasporën |
| | | 3.2.4 Krijimi i një programi të vecantë ndihme për institucionet e mikrokreditimit për zbatimin e politikave që synojnë kanalizimin e dërgesave të emigrantëve nëpërmjet marrëveshjeve me institucionet financiare në vendet pritëse. Realizimi i një aktiviteti vjetor në ndihmë për institucionet e mikrokreditimit | 2022 - 2025 | 62,000 | MFE<br>MSHD<br>MSHMS | Hartimi i programit të ndihmës për institucionet e mikrokreditimit; lidhja e marrëveshjeve përkatëse; Realizimi i një aktiviteti vjetor në ndihmë për institucionet e mikrokreditimit | Numri i marrëveshjeve të lidhura; zbatimi i programit të ndihmës; numri i aktiviteteve të zhvilluara |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3.3 Përfshirja e diasporës në jetën ekonomike të vendit<br>3.3.1 Realizimi i një programi të vecantë për masat favorizuese apo negocimi i marrëveshjeve bilaterale; Ngritja e një zyre kontakti dhe koordinimi për tregjet e huaja të punës. Raportim periodik në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | 2022 - 2025 | 6,000 | MEPJ<br>MSHD<br>MFE<br>MBZHR | Realizimi i marrëveshjeve bilaterale ;ngritja e një zyre kontakti; raportim në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin per Diasporën dhe Migracionin në Kuvendin e Shqipërisë | Numri i marëveshjeve të lidhura; numri i zyrave të krijuara; numri i raportimeve të kryera |
| | | 3.3.2 Organizimi i një programi vjetor me aktivitete për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare | 2022 - 2025 | 13,200 | MEPJ<br>MBZHR<br>MSHD<br>MTM | Hartimi i programit me aktivitete për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare | Numri i aktiviteteve të përfshira në program |
| | | 3.3.3 Zhvillimi i aktiviteteve vjetore; Krijimi i hartës së restoranteve dhe bizneseve të ushqimit në diasporë | 2022 - 2025 | 1,200 | MBZHR<br>MEPJ<br>MSHD<br>MSHMS | Krijimi i hartës së restoranteve dhe bizneseve të ushqimit në diasporë; organizimi i aktiviteve vjetore për promovimin e prodhimeve shqiptare | Numri i bizneseve të ushqimit dhe restoranteve të identifikuara; numri i aktiviteteve të zhvilluara. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 3.3.4 Krijimi i një banke të dhënash elektronike të profesionistëve në diasporë | 2021 - 2025 | 1,900 | MSHD<br>MEPJ<br>MB<br>MFE<br>MIE<br>MASR | Krijimi i një banke elektronike të dhënash me CV të profesionistëve të diasporës | Numri i profesionistëve të kualifikuar të përfshirë në bankën e të dhënave |
| | | 3.3.5 Realizimi i një Programi vjetor aktivitetesh në funksion të sezonit turistik në Shqipëri. | 2021 - 2025 | 21,500 | MTM<br>MSHD<br>MEPJ<br>MK | Hartimi i Programit Vjetor | Miratimi i Programit Vjetor |

| Objektivi Specifik D: Zbatimi i programeve për mësimin e gjuhës shqipe në diasporë | | | | | | Treguesi/-it i/e Rezultatit/-eve:sigurimi i vazhdueshëm i librave shkollorë; zbatimi i kurrikulave të përbashkëta me Kosovën; nxitja e programeve për mësimdhënien në diasporë; mbështetja për mësuesit në diasporë; vlerësimi i programeve që ofrojnë bursa studimi për studentët shqiptarë jashtë vendit | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Nën-objektivi | Veprimet që do të ndërmerren | Afati Kohor | Burimet Financiare në mijëra lekë shqiptare | Institucionet përgjegjëse | Rezultatet & Treguesit | |
| 4 | Arsimi dhe mësimdhënia | 4.1 Programi i kulturës dhe gjuhës shqipe<br><br>4.1.1 Vlerësimi vjetor i nevojave për libra për mësimin në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë. | 2021-2025 | 760 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Sigurimi i vazhdueshëm i librave shkollorë | Realizimi i një aktiviteti për vlerësimin vjetor të nevojave për libra |
| | | 4.1.2 Zhvillimi i kurrikulës për mësimin e kulturës, trashëgimisë dhe gjuhës shqipe jashtë vendit | 2022-2025 | 4,920 | MSHD<br>MASR<br>AKADEMIA E SHKENCAVE | Rishikimi i praktikave dhe kushteve për arsimimin e brezave të rinj të diasporës në gjuhën shqipe dhe rivlerësimi i hartimit të kurrikulave | Realizimi i një aktiviteti vjetor për rishikimin e praktikave dhe kushteve për arsimimin dhe rivlerësimi i hartimit të kurrikulave për mësimdhënien |
| | | 4.1.3 Përmirësimi dhe mbështetja e kurrikulave të përbashkëta me Kosovën për mësimdhënien në gjuhën shqipe. | 2021-2025 | 7,500 | MSHD<br>MASR | Vendosja e bashkëpunimit me institucionet partnere për përmirësimin dhe mbështetjen e kurrikulave të | Realizimi i një aktiviteti për vlerësimin vjetor të nevojave dhe cilësisë së librave; numri I institucioneve partnere; |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | MEPJ | përbashkëta me Kosovën | numri I dokumenteve të përgatitura. |
| | | 4.1.4 Rivlerësimi i marrëveshjeve të përbashkëta me shtetin e Kosovës për mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë. | 2022-2025 | 760 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Zhvillim bashkëpunues me Kosovën përmes hartimit të marrëveshjeve për mbështetjen e mësimit të kulturës dhe gjuhës shqipe në diasporë | Krijimi i një Komisioni Teknik për vlerësimin e marrëveshjeve me Republikën e Kosovës për takime e konkluzione vjetore; |
| | | 4.1.5 Rivlerësim i kuadrit ligjor lidhur me përgjegjësinë e shtetit shqiptar për të mundësuar mësimin e gjuhës shqipe ne diaspore. | 2022-2025 | 1,064 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Rivlerësim i kuadrit ligjor për mundësimin e mësimit të gjuhës shqipe në diasporë | Hartimi i një raporti të detajuar analitik |
| | | 4.1.6 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe. | 2021-2025 | 1,900 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Krijimi dhe nxitja e programeve për mësimdhënien e gjuhës shqipe | Realizimi i një aktiviteti vjetor për vlerësimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe për gjendjen e hapjes së kurseve në gjuhën shqipe; numri i marrëveshjeve. |
| | | 4.2. Mësuesit në Diasporë<br><br>4.2.1 Krijimi i Regjistrit të mësuesve ne diaspore dhe i programeve për mbështetje | 2022-2025 | 760 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Përpilimi i regjistrit të mësuesve të diasporës; duke përfshirë edhe vendndodhjen e tyre | Numri i mësuesve të identifikuar në regjistrin e mësuesve të diasporës; numri i vendeve ku ata shërbejnë. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | në zbatimin e standardeve për mësuesit në diasporë. | | | | dhe shkollat ku ata japin mësim. | |
| | | 4.2.2 Hartimi i programeve për mbështetje në zbatimin e standardeve për mësuesit në diasporë. | 2022-2025 | 1,064 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Krijimi i programeve mbështetëse | Numri i programeve mbështetëse, numri i vendeve ku zbatohen këto programe. |
| | | 4.2.3 Organizimi i aktiviteteve arsimore vjetore me mësues e nxënës shqiptar në diasporë. | 2022-2025 | 10,000 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Organizimi i aktiviteteve arsimore | Numri i aktiviteteve të organizuara; numri i shteteve ku do të organizohen aktivitetet; numri i pjesëmarrësve. |
| | | 4.2.4 Certifikimi i mësuesve | 2022-2025 | 1,216 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Certifikimi i mësuesve | Numri i mësuesve të certifikuar |
| | | 4.2.5 Hartim i skemës së pensioneve për mësuesit në diasporë. | 2022-2025 | 1,824 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Hartim i skemës së pensioneve për mësuesit në diasporë. | Krijimi i një kuadri dhe procesi institucional për çështjet që kanë të bëjnë me pensionet e mësuesve të diasporës |
| | | 4.2.6 Trajnimi i mësuesve që do të japin mësim në diasporë, përfshirë kurrikulat e përbashkëta me Kosovën. | 2021-2025 | 2,000 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Trajnimi i mësuesve që do të japin mësim në diasporë | Krijimi i një strukture permanente e cila do të ndjekë trajnimin e mësuesve; forcimi i strukturës permanente |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | (Qendrës së Botimeve në Diasporë) |
| | | 4.2.7 Dërgimi i mësuesve me kontratë nga Shqipëria në shtetet pritëse | 2021-2025 | 62,500 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Dërgimi i mësuesve nga Shqipëria në shtetet pritëse | Numri i mësuesve; shtetet ku do të dërgohen mësuesit |
| | | 4.3 Tekstet shkollore për Diasporën<br><br>4.3.1 Sigurimi i vazhdueshëm i teksteve shkollore për diasporën | 2021-2025 | 21,157.5 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Sigurimi i vazhdueshëm i teksteve shkollore për diasporën | Numri i librave; shtetet ku do të dërgohen librat |
| | | 4.3.2 Zhvillimi i projektit "Mëso Shqip" dhe "e-book" | 2021 | 21,551 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Shpërndarjen e librave në të gjithë botën dhe krijimin e lehtësirave për të furnizuar të gjithë me materiale plotësuese të nevojshme për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqipe. | Numri i shkarkimeve online i teksteve shkollor të vendosura në programin arsimor për diasporën; realizimi i projektit "e-book" për shpërndarjen e librave online |
| | | 4.4 Studentët në Diasporë<br><br>4.4.1 Vlerësimi dhe orientimi i programeve/donatorëve, të cilët ofrojnë bursa studimore për jashtë vendit drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria. | 2021-2025 | 1,520 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Vlerësimi dhe orientimi i programeve/donatorëve, të cilët ofrojnë bursa studimi | Realizimi i informimeve periodike në Komitetin Shtetëror të Diasporës për orientimin e programeve/donatorëve për të cilat ka nevojë Shqipëria; |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4.4.2 Krijimi i regjistrit të studentëve shqiptarë që studjojnë në universitetet jashtë vendit dhe mbi fushat ku ata specializohen | 2021-2025 | 2,280 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Krijimi i regjistrit të studentëve shqiptarë që studjojnë jashtë | Krijimi i regjistrit të studentëve shqiptarë jashtë vendit; numri i studentëve; identifikimi i fushat ku specializohen. |
| | | 4.4.3 Nxitja e komunikimit midis studentëve shqiptarë që studjojnë jashtë | 2021-2025 | 2,850 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Nxitja e komunikimit midis studentëve shqiptarë që studjojnë jashtë | Numri i aktiviteteve vjetore për informim. |
| | | 4.4.4 Kryerja e një raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve shqiptare që studiojnë jashtë vendit. | 2022-2025 | 4,500 | MSHD<br>MASR<br>MEPJ | Kryerja e një raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve shqiptare që studiojnë jashtë vendit. | Realizimi i raportit vlerësues; identifikimi i vështirësive të studentëve dhe i faktorëve ndikues; informimi i Komitetit Shtetëror të Diasporë. |

| Objektivi Specifik E: Informimi i diasporës mbi zhvillimet social ekonomike në vendin e origjinës | | | | | | Treguesi/-it i/e Rezultatit/-eve: Krijimi i databazës për mediat shqiptare në diasporë; Organizimi i fushatave informuese; Zbatimi i projekteve për fuqizimin e rolit të medias në diasporë; Organizimi i aktiviteteve periodike | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Nën-objektivi | Veprimet që do të ndërmerren | Afati kohor | Burimet Financiare në Mijëra lekë shqiptare | Institucion përgjegjës | Rezultatet & Treguesit | |
| 5 | Media dhe Komunikimi | 5.1 Mbështetja e rrjeteve të informimit dhe mediave në diasporë<br><br>5.1.1 Realizimi i një banke të dhënash të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës dhe organizimi i një aktiviteti vjetor me gazetarët e diasporës | 2022 - 2025 | 1,368 | MSHD<br><br>MEPJ | Krijimi dhe përditësimi i një banke të dhënash të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës; Krijimi i rrjeteve të televizioneve dhe radiove shqiptare në diasporë; Organizimi i një aktiviteti vjetor për këtë qëllim | Numri i gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës të identifikuara; numri i aktiviteteve të realizuara |
| | | 5.1.2 Krijimi i rrjetit të komunikimit dhe informimit për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve. | 2022-2025 | 1,834 | MSHD<br><br>MEPJ | Krijimi i një rrjeti informimi me qëllim sensibilizimin ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve; | Numri i fushatave sensibilizuese; |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 5.1.3 Organizimi vjetor i Forumit të Medias së Diasporës | 2022-2025 | 1,600 | MSHD<br>MEPJ | Organizimi i Forumit të Medias në Diasporë | Numri i pjesëmarrësve në aktivitet |
| | | 5.1.4 Realizimi i një aktiviteti vjetor për programet televizive për diasporën; Projekt për forcimin e Kanalit të televizionit publik për diasporën TVSH 3; | 2021- 2025 | 10,000 | MSHD<br>MEPJ | Organizimi i aktivitetit; Zbatimi i projektit për kanalin TVSH3 | Numri i pjesëmarrësve në aktivitet; përgatitja e projektit; Financimi i projektit; Zbatimi i tij |
| | | 5.1.5 Krijimi i projekteve mediatike dhe i programeve të shkëmbimit dhe internship-it. Realizimi i një aktiviteti vjetor | 2021- 2025 | 7,500 | MSHD<br>MEPJ<br>MASR | Miratimi dhe zbatimi i projekteve mediatike; Zbatimi i programeve të internship-it; organizimi i një aktiviteti vjetor | Përgatitja e projekteve; Financimi i projektit; Numri i programeve të internship-it; numri i aktiviteteve të zhvilluara |
| | | 5.2 Informimi i diasporës shqiptare<br>5.2.1 Raportim periodik për cilësinë e faqeve të internetit të institucioneve. Organizimi i një takimi vjetor me "kujdestarët" e faqeve të informacionit në institucionet shtetërore | 2021 - 2025 | 2,280 | MSHD<br>MEPJ<br>AKSHI | Kryerja e raportimit mbi cilësinë e faqeve të internetit të institucioneve dhe informacionit që ofrojnë për diasporën; Organizimi i takimit vjetor | Numri i raportimeve të kryera; Numri i takimeve të realizuara |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 5.2.2 Organizimi i fushatës informuese për regjistrimin e migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës; | 2021 | 5,000 | MEPJ<br>MB<br>MSHD<br>MIE<br>MFE | Organizimi i një fushate informuese dhe ndërgjegjësimi për regjistrimin e migrantëve; | Numri i vendeve ku do të shtrihet fushata informuese; Realizimi i broshurave apo informacioneve në internet për këtë qëllim |
| | | 5.2.3 Organizimi i një aktiviteti vjetor në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë lidhur me të drejtën e votës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit | 2021 | 3,500 | MEPJ<br>MB<br>MSHD<br>MIE<br>MFE | Organizimi i aktivitetit; | Numri i pjesëmarrësve; |
| | | 5.2.4 Realizimi i një aktiviteti vjetor dhe plan veprimi mediatik; Përgatitja e një fushate promocionale dhe e një paketë të vecantë për diasporën | 2021-2025 | 10,000 | MSHD<br>MEPJ<br>MK | Realizimi i një fushate promovuese me qëllim tërheqjen e diasporës; Organizimi i një aktiviteti vjetor | Numri i aktiviteteve të realizuara; Numri i pjesëmarrësve |

| Objektivi Specifik F: Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit të strategjisë Kombëtare të Diasporës | | | | | | Treguesi/-it i/e Rezultatit/-eve: Publikimi i Buletinit periodik; Raportimi i institucioneve përgjegjëse; Diskutimi i propozimeve për rishikimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. | Nën-objektivi | Veprimet që do të ndërmerren | Afati kohor | Burimet Fnanciare në Mijëra lekë shqiptare | Institucion përgjegjës | Rezultatet & Treguesit | |
| 6 | Monitorimi dhe transparenca | 6.1 Monitorimi dhe vlerësimi<br><br>6.1.1 Publikimi i Buletinit periodik çdo 3 muaj mbi zbatimin e Planit të Veprimit. Informimi i Komitetit Shtetëror për Diasporën dhe Nënkomisionit për Migracionin dhe Diasporën | 2021-2025 | 2,280 | MSHD<br>MEPJ | Publikimi i Buletinit periodik; Përgatitja e informacioneve dhe raportimeve për Komitetin Shtetëror për Diasporën dhe Nënkomisionin për Migracionin dhe Diasporën | Numri i Buletinëve të publikuar; Numri i raportimeve të kryera. |
| | | 6.1.2 Raportimi me shkrim në Nënkomisionin për Migracionin dhe Diasporën i Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët | 2021-2025 | 950 | MSHD | Raportimi i institucioneve shtetërore për diasporën në Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin | Numri i raportimeve të kryera |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 6.1.3 Vlerësimi dhe diskutimi mbi rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës në Kuvendin Kombëtar të Diasporës Shqiptare | 2021-2025 | 684 | MSHD MEPJ | Diskutimi mbi propozimet për ndryshimin/rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit | Marrja e propozimeve për ndryshimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit |
| | | 6.1.4 Hartimi i raporteve nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit | 2021-2025 | 1,330 | MSHD MEPJ | Përgatitja dhe raportimi nga institucionet përgjegjëse | Numri i raportimeve të kryera |

| | | |
|---|---|---|
| **SHTYLLA 1** | **MARRËDHËNIA SHTETËRORE ME DIASPORËN** | **28 MASA** |
| **SHTYLLA 2** | **ORGANIZIMI I DIASPORËS** | **9 MASA** |
| **SHTYLLA 3** | **EKONOMIA DHE BIZNESI** | **14 MASA** |
| **SHTYLLA 4** | **ARSIMI DHE MËSIMDHËNIA** | **10 MASA** |
| **SHTYLLA 5** | **MEDIA DHE KOMUNIKIMI** | **7 MASA** |
| **SHTYLLA 6** | **MONITORIMI DHE TRANSPARENCA** | **4 MASA** |

# SHTYLLA 1 MARREDHENIA SHTETERORE ME DIASPOREN

## Aktiviteti 1.1 Krijimi i një kulture të re administrative

M1, M2, M3, M5, M12, M20

## Aktiviteti 1.2 Forcimi I kuadrit ligjor për diasporën

M4, M6, M7, M8, M9, M16, M18

## Aktiviteti 1.3 Shërbime dhe aktivitete për diasporën

M10, M11, M17, M19, M21, M25, M26, M27, M28

## Aktiviteti 1.4 Forcimi I kapaciteteve dhe rrjeteve të profesionistëve

M13, M14, M15, M22, M23, M24

| MASAT E PERFSHIRA NE SHTYLLEN 1 |
|---|
| Kordinimi i institucioneve shtetërore përgjegjëse që legjislacioni i ri ngarkon për fushën e marrëdhënieve shtetërore me diasporën me Agjencinë Kombëtare për Diasporën, Fondin për Zhvillimin e Diasporës, Qendrën e Botimeve për Diasporën dhe Qendrën e Studimeve dhe Botimeve për Arbëreshët. Hartimi i një plani të detajuar për financimin e politikave dhe masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare. Krijimi i një njësie të specializuar për rivlerësimin e legjislacionit për diasporën për të ndërmarrë ndryshimet e nevojshme. |
| Miratimi në Komitetin Shtetëror për Diasporën i programit vjetor të aktiviteteve për diasporën (aktivitetet që përfshinë librin, arsimin, kulturën, turizmin dhe biznesin) dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë vlerësimin e pjesëmarrjes e përfaqësimit në to. Përgatitja e informacioneve vlerësuese për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin e Kuvendit për Diasporën dhe Migracionin. |
| Ndjekja e procedurave të nevojshme koordinative për të diskutuar çdo vit në Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe për të parashikuar në buxhetin vjetor (pasardhës) fondet e nevojshme për të zbatuar Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e Veprimit deri në vitin 2025. |
| Vlerësimi i përqasjes të strategjive të tjera kombëtare ekzistuese apo që do të miratohen me Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Diasporën. Ky proces do të kryejë organizimin e politikave shtetërore ekzistuese apo që do të miratohen në të ardhmen në marrëdhënie me politikat për komunitet shqiptare jashtë vendit. |
| Realizimi i raporteve vjetore nga institucionet përgjegjëse ku të pasqyrohen të dhënat dhe vlerësimi per komunitetet shqiptare në shtetet pritëse. Krijimi i një botimi të përbashkët për raportimet për diasporën shqiptare. |
| Rishikimi i kuadrit të marrëveshjeve ekzistuese për migracionin me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë. Negocimi i kuadrit të marrëveshjeve të punësimit me shtetet pritëse me qëllim përfshirjen në këto marrëveshje të formimit profesional, ose për to të diskutohet në veçanti. Rivlerësimi në bashkëpunim me vendet e BE e projekte të veçanta për të lehtësuar zbatimin e marrëveshjeve të punësimit duke përfituar edhe nga legjislacioni provizor dhe i veçantë i vendeve pritëse, që kanë mungesë të fuqisë punëtore. |
| Organizimi i nxitjes e forcimit të marrëdhënieve të Shqipërisë me vendet pritëse të komuniteteve shqiptare dhe bashkëpunimi i programit të punës të shërbimit diplomatik dhe konsullor me fokus të veçantë nga këndvështrimi i forcimit të statusit të diasporës shqiptare |
| Vendosja e kordinimit mbi bazën e një programi të miratuar të projekteve me donatorët ndërkombëtarë për realizimin e masave të Planit të Veprimit apo që mbulojnë interesat e diasporës shqiptare. |

| |
|---|
| Vlerësimi i akteve të brendshme ligjore dhe marrëveshjeve në fushën e migracionit për zgjerimin e mbrojtjes së interesave të komuniteteve shqiptare jashtë vendit në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ai do të ketë qëllim përafrimin e tyre me Acquis Communautaire dhe realizimin e procedurave për përfundimin e ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare në këtë fushë (nëse nuk janë realizuar ende). |
| Krijimi dhe vijueshmëria e strukturave informuese për orientimin e qytetarëve shqiptarë jashtë vendit në përdorimin e shërbimeve konsullore dhe diplomatike të cilat ofrohen nga përfaqësitë shqiptare (platforma online). Dhënia e informacionit rreth organizatave jo qeveritare të akredituara nga shteti pritës, të cilat ofrojnë asistencë dhe mbrojtje ligjore për komunitetet e huaja. |
| Vlerësimi dhe zgjerimi i Regjistrit Kombëtar të Gjendjes civile dhe bazave të të dhënave me të dhëna për migrantët dhe rishikim periodik i bazës ligjore për regjistrimin e migrantëve. Përcaktimi i përgjegjësive dhe të dhënave që duhen mbledhur si edhe identifikimi dhe planifikimi i krijimit të rrjetit dhe infrastrukturës së duhur. Organizimi i aktiviteteve publike dhe shoqërinë civile mbi qëllimin e sistemit të regjistrimit dhe votimit të shtetasve jashtë vendit. |
| Ngritja e Qendrave Kulturore Shqiptare në vendet pritëse të diasporës në bashkëpunim me shtetin e Kosovës në shërbim të ruajtjes së identitetit kombëtar dhe për të ofruar shërbime e informacion për komunitetet e shqiptarëve në diasporë. |
| Organizimi i një rrjeti për studiuesit e huaj e shqiptarë të specializuar në fushën e migracionit dhe të nëpunësve në administratë të specializuar në institucionet të cilat merren me politikat e Diasporës dhe Migracionit. (Plotësimi i rrjetit edhe me emrat dhe detajet e studiuesve dhe nëpunësve shtetërorë nga Agjencia Kombëtare e Diasporës). |
| Realizimi i trajnimeve të veçanta për fushën e migracionit me administratën shtetërore dhe lokale dhe realizimim i përfshirjes së tyre në programet e universiteteve shqiptare. Organizimi i trajnimeve periodike në fushën e legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar për nëpunësit që mbulojnë çështje të migracionit. Identifikimi i nevojave dhe ekspertëve që kanë nevojë për trajnime ligjore. Hartimi i moduleve trajnuese në këtë fushë dhe përfshirjen e një moduli të tillë në trajnimet e nëpunësve të shërbimit civil. |
| Hartimi i manualeve praktike që lidhen me çështjet e migracionit dhe vënia e tyre në dispozicion të zyrtarëve që merren me zbatimin në praktikë të legjislacionit për Migracionin. Identifikimi i akteve ligjore/nënligjore që zbatohen në praktikë nga çdo institucion i cili mbulon çështje të caktuara të diasporës dhe migracionit. Trajnimi dhe certifikimi i trupit diplomatik të Shqipërisë lidhur me legjislacionin migrator dhe në mënyrë të veçantë me të drejtat e komuniteteve shqiptare në diasporë. |
| Nxitja e bashkëpunimit shtetëror me institucionet e vendeve pritëse të cilat trajtojnë çështje të migrantëve, të drejtave të grave dhe të drejtave të fëmijëve. Krijimi i komisioneve dypalëshe konsultative të nivelit të lartë me shtetet pritëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare të diasporës dhe funksionimi i tyre në mënyrë periodike për këtë qëllim. Informimi publik për ecurinë dhe zhvillimin e kësaj veprimtarie për publikun e interesuar. |

| |
|---|
| Përgatitja dhe shpërndarja e informacionit (broshurave, fletëpalosje, faqe interneti, app në telefonat celularë etj.) që ju drejtohet komuniteteve shqiptare në diasporë, ku të jepet informacion në lidhje me statusin dhe të drejtat e tyre si edhe për shërbimet që ju ofrohen nga përfaqësitë diplomatike dhe konsullore si edhe nga shoqatat e migrantëve me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare. |
| Vendosja e kontakteve të rregullta me Grupin Evropian të Autoriteteve Rajonale dhe Lokale në fushën e Imigracionit (ERLAI) me qendër në Bruksel, për të vlerësuar mundësitë e mbështetjes së politikës të mbrojtjes së komuniteteve të shqiptarëve në diasporë në vendet pritëse të BE-së. |
| Nxitja dhe intensifikimi i komunikimeve ndërmjet organizimeve shqiptare në diasporë dhe shoqatave vendase për mbrojtjen e migrantëve. Identifikimi i organizatave në vendet pritëse për mbrojtën e të drejtave të njeriut dhe të migrantëve në këto vende. Ndërgjegjësim nëpërmjet informacioneve në internet, tryezave dhe takimeve për mbrojtjen sociale dhe shëndetësore në vendet pritëse dhe të origjinës. |
| Rivlerësimi periodik i politikës së shërbimeve, procedurave dhe tarifave të tyre. Në bazë të informacioneve të marra nga përfaqësitë dhe hartimi nga Agjencia Kombëtare e Diasporës e një raporti vjetor për gjendjen konkrete të komuniteteve shqiptare në diasporë shoqëruar me propozime masash për përmirësimin e asistencës për ta. Raporti do të diskutohet në Komitetin Shtetëror të Diasporës. |
| Negocimi për të nënshkruar marrëveshjet dypalëshe për mbrojtjen sociale të migrantëve me vendet pritëse me qëllim që ata të transferojnë sigurimet shoqërore edhe në Shqipëri. Rishikimi i praktikave të mbledhjes së kontributit vullnetar për sigurimet shoqërore dhe nëse duhet nënshkrimi i marrëveshjeve ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe bankave. (Rivlerësimi i një planveprimi të veçantë për çështjen e pensioneve të migrantëve shqiptarë). |
| Krijimi i regjistrit për shtetasit shqiptarë që vuajnë heqjen e lirisë në burgje jashtë vendit dhe organizimi i një takimi vjetor organizuar në bashkëpunim me zyrën e Avokatit të Popullit dhe organizatën e Kryqit të Kuq Shqiptar për këtë çështje. Diskutimi i vlerësimit të informacionit periodik dhe konkluzioneve për Komitetin Shtetëror të Diasporës. |
| Organizimi dhe mbështetja e rrjeteve (edhe ndërkombëtare) të grupeve dhe shoqatave të veçanta të diasporës shqiptare në bazë të interesave, profesioneve të përbashkëta, apo vendndodhjes gjeografike. Krijimi i lehtësirave si p.sh: botimi në gazeta, apo në faqe interneti e informacioneve që mundësojnë krijimin e grupeve profesionale dhe të interesave të përbashkëta. Ndërmjetësimi për vendosjen e kontakteve midis grupeve "homologe" në vende të ndryshme për të krijuar rrjete funksionale të kësaj natyre. |
| Mbështetja mbi bazën e projekteve të veçanta të organizatave të diasporës shqiptare për krijimin e strukturave lokale këshilluese për shtetasit e huaj në qytetet ku migrantët shqiptarë janë të përqendruar, mbi bazën e udhëzuesit të përgatitur nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Evropës dhe Këshillit të Evropës. |

| |
|---|
| Kryerja e fushatave sensibilizuese lidhur me mundësitë e ndryshme për të apeluar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve, në strukturat e vendeve pritëse si dhe në ato ndërkombëtare, të cilat merren me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut si dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, nëpërmjet aktiviteteve si:<br>• Publikim i këtyre informacioneve në faqen e internetit për migracionin kushtuar kësaj çështjeje,<br>• Botimi në gazetat shqiptare jashtë vendit,<br>• Botimi dhe shpërndarja e fletëpalosjeve lidhur me këto informacione,<br>• Publikimi i këtyre të drejtave nëpërmjet faqeve të internetit të krijuara nga komuniteti shqiptar që vepron jashtë vendit.<br>Raportimi periodik nga ana e qeverisë shqiptare të rasteve të shkeljeve të të drejtave të migrantëve<br>shqiptarë. (Disa nga strukturat ndërkombëtare që merren me këto të drejta janë si më poshtë:<br>• Special rapporteur for migrant's rights of the United Nations - Raportuesi Special për të Drejtat e Migrantëve.<br>• Commissioner for Human rights of the Council of Europe - Komisioneri për Mbrojtjen e të<br>Drejtave të Njeriut në Këshillin e Evropës.<br>• European Court in Human rights - Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të drejtave të Njeriut.<br>• European Commission against Racism and Intolerance (ECRI) of the Council of Europe -<br>Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës për vendet anëtare në Këshillin e Evropës.<br>• Commission for Petition of European Parliament for the EU - Komisioni i Peticioneve të<br>Parlamentit Evropian.<br>• Ombudsman of the EU - Avokati i Popullit i BE-së. |
| Koordinimi dhe organizimi i takimeve apo "Ditëve të Shqipërisë" në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë mbi bazën e një programi vjetor si dhe aktivitete të tjera periodike për turizmin shqiptar edhe lehtësirat lidhur me investimet në Shqipëri. |
| Koordinimi me Institucionet Shëndetësore, publike dhe private, në përgatitjen e një fushate për promovimin e turizmit shëndetësor, lidhur kryesisht me disa shërbime për të cilat Shqipëria ka siguruar avantazhe (dentar, neurokirurgji, kardiokirurgji etj.). |
| Përfshirja e komunitetit të shqiptarëve të diasporës në jetën kulturore të vendit pritës dhe në Shqipëri me qëllim promovimin e tyre (nënshkrimi dhe/ose amendimi i marrëveshjeve dypalëshe me shtetet pritëse të diasporës duke përfshirë edhe interesat e këtyre të fundit në to) dhe nxitja e krijimit i aktiviteteve vjetore për këtë qëllim |

## SHTYLLA 2 ORGANIZIMI I DIASPORES

### Aktiviteti 2.1 Mekanizma për mbështetjen e organizimit të diasporës

M29, M30, M31, M32

### Aktiviteti 2.2 Lidhjet me Diasporën shqiptare

M36, M37

### Aktiviteti 2.3 Çmimi "Ambasador i Kombit"

M33

### Aktiviteti 2.4 Çertifikata e Diasporës

M34

### Aktivitet 2.5 Specialistë dhe studiues të Diasporës Shqiptare`

M35

| MASAT E PERFSHIRA NE SHTYLLEN 2 |
|---|
| Organizimi i plan - veprimit të institucioneve përgjegjëse për diasporën me Këshillin Koordinativ të Diasporës për forcimin organizativ të e komuniteteve shqiptare dhe përfshirjen në zhvillimin social - ekonomik të Shqipërisë. |
| Organizimi i Kuvendit të Diasporës Shqiptare në bashkëpunim me Këshillin e Kordinimit të Diasporës si ngjarja e më e rëndësishme e komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Organizimi periodik i aktivitetit mbarëkombëtar me qëllim shqyrtimin e politikave aktuale për mobilizimin e diasporës shqiptare, ku do të vlerësohen çështjet si ruajtja e gjuhës dhe kulturës, fenomeni i ikjes së trurit dhe investimet nga diaspora në Shqipëri. |
| Kordinimi me Republikën e Kosovës në për fushën e marrëdhënieve me diasporën shqiptare në zbatim dhe rivlerësim të marrëveshjeve ekzistuese midis dy shteteteve. Përgatitja dhe realizimi i marrëveshjeve dypalëshe në fushën e diasporës me të gjitha vendet të cilat vlerësohen të rëndësishme dhe “prodhuese” të diasporave shqiptare në botë. |
| Vlerësimi i nivelit organizativ të komuniteteve shqiptare në vendet pritëse. Organizimi i aktiviteteve mbi bazën e profesioneve të cilat nxisin rrjetet e profesionistëve dhe identifikimn e burimeve njerëzore. |
| Promovimi i rasteve të personaliteteve të suksesshme të diasporës dhe në Shqipëri dhe dhënia e titullit “Ambasador i Kombit”. Krijimi i rrjetit të Ambasadorëve të Kombit (formulimi i akteve juridike të nevojshme për këtë çështje). |
| Përgatitja e Certifikatës së Diasporës, e cila mund të aplikohet online dhe krahas regjistrimit të të interesuarit e pajis atë me një dokument të printueshëm (“Jam Shqiptar”) i cili mund të vendoset në ambiente të hapura për të pohuar identitetin kombëtar shqiptar. Ajo do të jepet e vacantë për fëmijët që mbarojnë projketin e Shkollës Verore. |
| Krijimi i Regjistrit të Diasporës së Kualifikuar dhe zbatimi i programeve kombëtare dhe të përbashkëta me institucione ndërkombëtare me qëllim që të tërhiqen anëtarët e kualifikuar të diasporës për t’i shërbyer ekonomisë së Shqipërisë. Vlerësimi i programeve që nxisin investitorët që të punësojnë staf të kualifikuar nga diaspora jashtë vendit. Mbi bazën e këtyre programeve, koordinimi dhe krijimi i mundësive për studentët shqiptarë që të mirëpriten dhe të ndihmohen nga anëtarë të diasporës shqiptare për të lehtësuar studimet e tyre në universitete të huaja nëpërmjet një rrjeti të ngritur për këtë qëllim në diasporë. |
| Evidentimi i shoqatave kulturore, sportive, arsimore, sociale, shkencore që veprojnë në vendet pritëse si dhe i individëve të talentuar dhe të suksesshëm që veprojnë në diasporë. Krijimi i një regjistri të veçantë për këtë qëllim. |
| Nxitja e organizimeve të Rrjetit të Grave në Diasporë dhe ndërtimi i politikave të veçanta në këtë drejtim. Organizimi në Shqipëri ose jashtë saj i Samitit të Grave të Diasporës. Krijimi i një rrjeti bashkëpunimi të qëndrueshëm me organizatat dhe me institucionet që mbulojnë këtë çështje në vendet pritëse dhe me shoqërinë civile në Shqipëri për këtë qëllim. |

# SHTYLLA 3 EKONOMIA DHE BIZNESI

## Aktiviteti 3.1 Tërheqja e investimeve nga diaspora

M38, M39, M42, M44, M50

## Aktiviteti 3.2 Formalizimi i dërgesave të diasporës dhe remitancave

M40, M41, M43, M48

## Aktiviteti 3.3 Përfshirja e diasporës në jetën ekonomike të vendit

M45, M46, M47, M49, M51

| MASAT E PERFSHIRA NE SHTYLLEN 3 |
| --- |
| Forcimi i Dhomës së Biznesit të Diasporës në bashkëpunim me rrjetin e bizneseve në diasporë. Krijimi i Regjistrit të Bizneseve të Diasporës si bazë e organizimit të Dhomës së Biznesit të Diasporës si protagoniste në marrëdhëniet e biznesit me administratën shtetërore. |
| Krijimi i strukturave administrative në pushtetin lokal për informimin dhe mbështetetjen investimeve nga të interesuarit në diasporë. Ky informimim i diasporës do të jetë i kordinuar për mundësitë e investimeve në Shqipëri për motivimin e bizneseve apo migrantëve shqiptarë për të investuar në sektorë të veçantë të ekonomisë. |
| Vlerësim vjetor për remitancat dhe politikat nxitëse bankare për diasporën shqiptare nën drejtimin e Bankës së Shqipërisë. Përpunimi dhe zbatimi i një politike koherente dhe të plotë për administrimin e dërgesave të diasporës. Rivlerësim për marrjen e masave për të rritur flukset e dërgesave të migrantëve duke motivuar migrantët që sjellin kursimet e tyre në Shqipëri. |
| Vlerësimi vjetor i masave për kalimin e dërgesave të migrantëve nga rrugët informale të transferimit në ato formale, dhe më pak të kushtueshme. Vendosja e një dialogu periodik me përfaqësuesit e sistemit bankar të vendit për këtë çështje. Nxitja e shoqërive private për të tërhequr dërgesat e emigrantëve nëpërmjet produkteve financiare (si p.sh: letra me vlerë). |
| Krijimi i zyrave të posaçme administrative në institucionet përgjegjëse të ekonomisë për trajtimin e diasporës shqiptare sidomos në zbatimin e politikave të dërgesave të migrantëve dhe lehtësimin e tërheqjes së investimeve nga diaspora. |
| Bashkëpunim me Banken e Shqipërisë dhe sistemin bankar privat për nxitjen e zgjerimit të shërbimeve bankare në vendet pritëse të diasporës si dhe për të afërmit e tyre në Shqipëri (kryesisht në zonat rurale). Nxitja e bankave në vendet pritëse që me ndihmën e shoqatave të migrantëve shqiptarë, të përcaktojnë shërbime “ad hoc” për emigrantët (brenda shkallës së mundësisë dhe negocimit). |
| Organizimi periodik i takimeve me rrjetet e biznesit në diasporë dhe i shkëmbimit të informacionit funksional nga çdo institucion që mbulon fushën e interesit për të investuar në vendlindje. |
| Vlerësimi dhe nxitja e migrimit qarkullues ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë me anë të masave favorizuese apo negocimi i marrëveshjeve bilaterale (duke i dhënë përparësi Greqisë dhe Italisë). Realizimi një zyre kontakti dhe koordinimi për vlerësimin dhe monitorimin e gjendjes së tregjeve të huaja të punës dhe me pas ky informacion t’i kalohet institucioneve përgjegjëse. |
| Organizimi i një programi të veçantë aktivitetesh vjetore për promovimin e prodhimeve bujqësore dhe ushqimore shqiptare duke organizuar aktivitete periodike në funksion të rrjeteve të organizuara të prodhuesve shqiptarë dhe rrjetit të bizneseve shqiptare në diasporë të cilët tregtojnë prodhime të natyrave të tilla. |

| |
|---|
| Zhvillimi i aktiviteteve vjetore në fushën e prodhimeve vendase në koordinim me bizneset blerëse në diasporë në funksion të krijimit të hartëzimit së restoranteve dhe bizneseve të ushqimit në shtetet pritëse për të ndërlidhur me një projekt të vecantë bizneset shitëse dhe blerëse brenda dhe jashtë vendit. |
| Krijimin e një programi të vecantë ndihme për institucionet e mikrokreditimit për zbatimin e politikave që synojnë kanalizimin e dërgesave të emigrantëve nëpërmjet marrëveshjeve me institucionet financiare në vendet pritëse. Inkurajimi i shoqatave të migrantëve për nxitjen e zhvillimit lokal nëpërmjet mbledhjes vullnetare të donacioneve nga anëtarët për të financuar projekte të ndryshme në qytetin apo fshatin e tyre. |
| Rivlerësimi i politikave me qëllim nxitjen e kthimit të migrantëve të kualifikuar. Vlerësimi i ofertës dhe kërkesës për personel të kualifikuar, në tregun e punës shqiptar dhe krijimi i kontakteve ndërmjet migrantëve dhe ndërmarrjeve të mesme e të mëdha në Shqipëri, duke krijuar një bankë të dhënash elektronike me CV e migrantëve të kualifikuar. |
| Rivlerësimi periodik i politikës së shërbimeve, procedurave dhe tarifave të tyre. Në bazë të informacioneve të marra nga përfaqësitë dhe hartimi nga Agjencia Kombëtare e Diasporës e një raporti vjetor për gjendjen konkrete të komuniteteve shqiptare në diasporë shoqëruar me propozime masash për përmirësimin e asistencës për ta. Raporti do të diskutohet në Komitetin Shtetëror të Diasporës. |
| Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të jetë koordinuese për realizimin në bashkëpunim me sektorin e biznesit privat një program për shpërndarjen e informacioneve të karakterit ekonomik dhe përpilimin e një programi aktivitetesh vjetore periodike, që nxit marrëdhëniet e biznesit ndërmjet komuniteteve shqiptare në diasporë, me njëri-tjetrin dhe vendlindjen. |
| Realizimi i programit të festave dhe ditëve të shënuara komunitare në bashkëpunim me sektorin privat, organizatat jofitimprurëse apo ato sportive dhe promovimi nga institucionet përgjegjëse të turizmit në tregje të rëndësishme për të rritur flukset turistike. |

# SHTYLLA 4 ARSIMI DHE MESIMDHENIA

## Aktiviteti 4.1 Programi i kulturës dhe gjuhës shqipe

M52, M54, M58

## Aktiviteti 4.2 Mësuesit në Diasporë

M55, M56

## Aktiviteti 4.3 Tekstet shkollore për Diasporën

M53, M57

## Aktiviteti 4.4 Studentët në Diasporë

M59, M60, M61

| MASAT E PERFSHIRA NE SHTYLLEN 4 |
|---|
| Rishikimi i praktikave dhe kushteve për arsimimin e brezave të rinj të diasporës në gjuhën shqipe. Rivlerësimi i hartimit të kurikulave standarde për mësimdhënien në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë. |
| Vlerësimi vjetor i nevojave për libra për mësimin në gjuhën shqipe dhe njohjen e trashëgimisë kulturore shqiptare për fëmijët në diasporë. Përmirësim periodik i kurikulave të përbashkëta me Kosovën, për mësimdhënien në gjuhën shqipe. Mbështetje në zbatimin e kurikulave të përbashkëta. |
| Koordinimi dhe nxitja e marrëveshjeve të përbashkëta me shtetin e Kosovës për mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë. Rivlerësim për kuadrin ligjor lidhur me përgjegjësinë e shtetit shqiptar për të mundësuar mësimin e gjuhës shqipe për brezin e ri të komuniteteve shqiptare në diasporë. |
| Përditësimi i Regjistrit të mësuesve në diasporë dhe i programeve për mbështetje në zbatimin e standardeve për mësuesit në diasporë. Certifikimi i mësuesve dhe hartim i skemës së pensioneve për mësuesit në diasporë. Organizimi i aktiviteteve arsimore vjetore me mësues e nxënës shqiptarë në diasporë. |
| Krijimi i një strukture permanente e cila do të ndjekë trajnimin e mësuesve që do të japin mësim në diasporë. Sigurimi i vazhdueshëm i teksteve shkollore për diasporë dhe trajnimi i mësimdhënësve mbi kurikulat e përbashkëta me Kosovën. Dërgimi i mësuesve me kontratë nga Shqipëria në shtetet pritëse nga Agjencia Kombëtare e Diasporës. |
| Zhvillimi i projektit “Mëso Shqip” dhe “e-book” (shkarkimi online i teksteve shkollor të vendosura në programin arsimor për diasporën) me qëllim shpërndarjen e librave në të gjithë botën dhe krijimin e lehtësirave për të furnizuar të gjithë me materiale plotësuese të nevojshme për mësimin e gjuhës dhe kulturës shqipe. |
| Vlerësimi dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet arsimore në vendet pritëse (duke respektuat legjislacionin vendas), për hapjen e kurseve në gjuhën shqipe në shkollat e ambientet edukative ekzistuese në këto vende. (Krijimi dhe nxitja e programeve për mësimdhënien e gjuhës shqipe për fëmijët e emigrantëve shqiptarë në bashkëpunim me strukturat përkatëse të vendeve pritëse). |
| Vlerësimi dhe orientimi i programeve/donatorëve, të cilët ofrojnë bursa studimore për jashtë vendit drejt fushave të ekspertizës për të cilat ka nevojë Shqipëria. Rivlerësimi për përfshirjen e kushtit të kthimit në Shqipëri (për një periudhë jo më pak se një vit) për të gjithë studentët që marrin bursa studimi për jashtë vendit në kuadër të programeve studimore të donatorëve të ndryshëm për Shqipërinë. |

| |
|---|
| Krijimi i rregjistrit të studentëve shqiptarë që studjojnë në universitetet jashtë vendit dhe mbi fushat ku ata specializohen. Krijimi i një projekti për nxitjen e komunikimit midis tyre jashtë vendit. |
| Kryerja e një raporti vlerësues mbi vështirësitë e studentëve shqiptare që studiojnë jashtë vendit dhe mbi faktorët që ndikojnë në këtë situatë. Ai do të vlerësohet në Komitetin shtetëror të Diasporës. |

# SHTYLLA 5 MEDIA DHE KOMUNIKIMI

## Aktiviteti 5.1 Mbështetja e rrjeteve të informimit dhe mediave në diasporë

M62, M63, M66, M67

## Aktiviteti 5.2 Informimi i diasporës shqiptare

M64,M65

| MASAT E PERFSHIRA NE SHTYLLEN 5 |
|---|
| Krijimi dhe përditësimi i një banke të dhënash të gazetave, faqeve të internetit, radiove dhe televizioneve të diasporës, që funksionojnë në vendet që gjykohen si prioritare për politikat kombëtare mbi diasporën. Krijimi i rrjeteve të televizioneve dhe radiove shqiptare në diasporë dhe realizimi i një plan veprimi për komunikimin dhe trajnimin e gazetarëve në diasporë me projekteve stimuluese dhe aktiviteteve vjetore për këtë qëllim. |
| Organizimi i rrjetit të informimit për median shqiptare dhe të huaj për të apeluar dhe sensibilizuar ndaj shkeljeve të të drejtave të migrantëve shqiptarë në strukturat përkatëse të vendeve pritëse si dhe në ato të organizatave ndërkombëtare. Krijimi i Forumit të Medias së Diasporës dhe organizmin e një aktiviteteti vjetor. |
| Vlerësimi i cilësisë së faqeve të internetit të institucioneve shtetërorë për informacionin të detajuar për komunitetet shqiptare jashtë vendit duke hapur edhe një seksion që i kushtohet kësaj teme (aty ku është e nevojshme). Realizimi i takimeve periodike (çdo 6 muaj) për vlerësimin dhe koordinimin me “kujdestarët” e faqeve të informacionit të institucioneve për nivelin e informimit që këto faqe ofrojnë për diasporën shqiptare. |
| Planifikimi dhe realizimi i një fushate informuese mbi:<br>• Çështje që kanë të bëjnë me migracionin dhe diasporën<br>• Promovimin në shkallë të gjerë të regjistrimit të migrantëve dhe informimi për të drejtën e votës (pas miratimit);<br>• Identitetin e shqiptarëve, historinë dhe kulturën shqiptare në diasporë<br>• Forcimi i Gazetës “Diaspora Shqiptare” me burimeve informative për çështje që interesojnë migracionin dhe diasporën dhe trajtimet rreth zhvillimeve më të fundit politike, sociale dhe ekonomike në vend;<br>Reflektimi në këtë fushatë të procesit që diaspora dhe migracioni do të jenë pjesë integrale të zhvillimeve politike dhe ekonomike të Shqipërisë. |
| Rishikimi dhe vlerësimi i zonës së transmetimit nga televizionet dhe radiot shqiptare kombëtare në të gjitha vendet ku ka komunitete të diasporës dhe migrantësh shqiptarë. Krijimi dhe nxitja e programeve televizive në vend për temën e diasporës dhe protagonizmin e saj në shoqërinë shqiptare. Forcimi i kanalit të televizionit publik TVSH 3 për temën e diasporës. Nxitja për marrëveshje me mediat në vendet pritëse, me qëllim transmetimin prej tyre të programeve për komunitetet shqiptare. |
| Krijimi i projekteve mediatike që nxisin krijimin e rrjeteve informuese për studentët dhe koordinimin e institucioneve përgjegjëse për arsimin për promovimin e rritjes së programeve të shkëmbimit dhe internship-it, të Universiteteve shqiptare me Universitetet në vendet pritëse me prani të lartë të studentëve shqiptarë. |
| Organizimi i një plan veprimi të kordinuar mediatik për nxitjen dhe motivimin e diasporës shqiptare për shfrytëzimin e avantazheve në Shqipëri për qëllime turizmi dhe investimi. Përgatitja nga institucionet përgjegjëse të turizmit e një fushate promocionale, në bashkëpunim me sektorin privat të një pakete që siguron pritshmëritë. Si ikona të kësaj fushat e mund të përfshihen figurat të njohura të diasporës në secilin treg. |

## SHTYLLA 6 – MONITORIMI DHE TRANSPARENCA

| Aktiviteti 6.1 | Monitorimi dhe vlerësimi |
| --- | --- |
| | M69, M70, M71, M72 |

| MASAT E PERFSHIRA NE SHTYLLEN 6 |
|---|
| Monitorimi i Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës mbi vlerësime 3 mujore (me Buletin priodik) dhe kryerja e informimit në Komitetin Shtetëror për Diasporën dhe në Nënkomisionin për Migracionin dhe Diasporën. Nënkomisioni kur e gjykon do të propozojë që për çështjen e trajtimit të migracionit dhe diasporës Kuvendi të miratojë një rezolutë për këtë çështje. |
| Vlerësimi nga Nënkomisioni për Migracionin dhe Diasporën dhe Komiteti Shtetëror për Diasporën në mbledhje të veçanta i dokumenteve të Raportimit me shkrim të:<br>Agjencisë kombëtare të Diasporës;<br>Fondit Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës<br>Qendrës së Botimeve të Diasporës<br>Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët |
| Vlerësimi, diskutimi dhe propozime për ndryshime për dokumentin e Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit në Kuvendin Kombëtar të Diasporës Shqiptare. Këto propozime do shikohen si nismëtare për të kryer ndryshimet e mundshme në proces. |
| Përcaktimi i indikatorëve të cilët do të evidentojnë nivelin e zbatimit të masave të vendosura nga kjo strategji. Detyrimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e strategjisë për hartimin e raporteve periodike për masat të marra duke përfshirë të dhëna sasiore edhe cilësore të monitorimit, bazuar në indikatorët e përcaktuar. |

# SHTOJCA III – STRUKTURA E INSTITUCIONEVE SHTETERORE PER DIASPOREN

# STRUKTURA SHTETERORE PER DIASPOREN



# KOMITETI SHTETEROR PER DIASPOREN



# STRUKTURA E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS



# STRUKTURA E FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS



# STRUKTURA E QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN



# QENDRA E STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PER ARBERESHET



# SHTOJCA IV – RISHIKIMI I DOKUMENTIT NE PROCESIN E ZBATIMIT

# SHTOJCA IV – RISHIKIMI I DOKUMENTIT NE PROCESIN E ZBATIMIT

## RISHIKIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN SHQIPTARE DHE I PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT

### HYRJE

Marrëdhënia me diasporën shqiptare për Republikën e Shqipërisë është një cilësi e cila do të ndryshojë me kalimin e kohës. Në Strategjinë Kombëtare për Diasporën dhe Planin e Veprimit 2021 - 2025 nisur nga nevoja e rishikimit të dokumentit, parashikohet zhvillimi i rishikimit të saj në tre faza vlerësuese.
Në procesin e rishikimit si bashkëshoqërues i Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare dhe i Planit të Veprimit 2021 - 2025 këto tre faza përshkruajnë metodologjinë e cila do të ndiqet që nga forcimi i kapaciteteve të strukturave shtetërore dhe marrëdhënies me diasporën shqiptare deri tek kalimi në një strategji të re të përshtatur në zbatim të përmirësimit të politikës shtetërore për diasporën shqiptare.

### FAZA 1 (2021 DERI NË MES TË VITIT 2023): KRIJIMI I KULTURËS ADMINISTRATIVE

Faza e Parë do të vlerësojë bashkëveprimin e politikës shtetërore me Strategjinë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e saj të Veprimit 2021-2025 në të cilat do të përcaktohet nevoja për të pasur aparatin dhe infrastrukturën e duhur institucionale për këtë lloj angazhimi. Në mënyrë të veçantë theksi do të vihet në forcimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore për diasporën, të krijuara apo që do të krijohen, si vijon:

- Nënkomisioni parlamentar për Diasporën dhe Migracionin
- Komiteti Shtetëror për Diasporën
- Këshilli Koordinues i Diasporës
- Agjencia Kombëtare e Diasporës
- Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
- Qendra e Botimeve për Diasporën
- Qendrat e Kulturës Shqiptare jashtë vendit
- Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët
- Strukturat Administrative për Diasporën dhe Migracionin në pushtetin lokal

Në këtë fazë përveç forcimit të kuadrit institucional, i rëndësishëm do të jetë edhe zgjerimi dhe promovimi i transparencës në vlerësimin dhe veprimin e politikave shtetërore për diasporën. Ky do të jetë një proces i cili do të koordinohet nga ministri përgjegjës për diasporën i cili do të realizojë:

- Angazhimin e institucioneve shtetërore sipas fushës së përgjegjësisë;
- Administratën profesionale për arritjen e qëllimeve të vendosura për diasporën shqiptare;
- Krijimin e një sistemi të lidhur llogaridhënieje operacionale si themeli për funksionimin e aktiviteteve të strategjisë;
- Angazhimin e institucioneve shqiptare për të krijuar një kuadër të plotë bashkëveprimi në zbatimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planin e saj të Veprimit 2021-2025




*Kuadri institucional shtetëror për angazhimin e diasporës*

## FAZA 2 (MESI I VITIT 2023 – 2024) RISHIKIMI AFATMESËM: BASHKEVEPRIMI INSTITUCIONAL DHE ANGAZHIMI I KOORDINUAR SEKTORIAL

Në Fazën e Dytë të vlerësimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021-2025 do të verifikohet harmonizimi i veprimit administrativ të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e saj. Ai do të krijojë një proces për rekomandimet me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të identifikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës Shqiptare, si dhe kontributin e partnerëve të tjerë joqeveritarë, kombëtarë apo ndërkombëtarë.

Ky vlerësim do të shtjellojë kalimin e rëndësishëm nga faza e dytë në fazën e tretë me synim përcaktimin e qëllimeve të rishikimit afatmesëm të dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021-2025.
Gjatë konsultimeve për rishikimin e strategjisë u rekomandua që procesi i harmonizimit, të bëhet në mënyrë që të jetë i zbatueshëm në sistemin administrativ, patur parasysh që fillimi i aktiviteteve do të bëhet operacional në mënyrë sistematike në vitin 2022 në përputhje me dokumentin e rishikuar të Strategjisë dhe të Planit të Veprimit 2021-2025. Ky mekanizëm do të plotësohet me takimet e përbashkëta të Komitetit Shtetëror për Diasporën dhe raportimet në Nënkomisionin Parlamentar për Diasporën dhe Migracionin. Këto të fundit do të kenë një përgjegjësi të vecantë për kuadrin monitorues dhe vlerësues me një strukturë rivlerësuese të grupit të punës, i cili do të funksionojë si më poshtë:

## FORMATI I GRUPIT TË PUNËS: PËRBËRJE GJITHËPËRFSHIRËSE E GRUPEVE TË PUNËS

| |
|---|
| **PËRFAQËSUES I MINISTRIT TË SHTETIT PËR DIASPORËN** |
| **DREJTUESIT E INSTITUCIONEVE SHTETËRORE PËR DIASPORËN DHE PËRFAQËSUES TË SEKTORËVE PËRGJEGJËS SHTETËRORË TË PËRCAKTUAR NË PLANIN E VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN SHQIPTARE 2021-2025** |
| **PËRFAQËSUES E PARTNERËVE JOQEVERITARË, SI ORGANIZATA APO SHOQATA LIDHUR ME ÇËSHTJET E DIASPORËS** |

### FAZA 3 – STRATEGJIA E TËRHEQJES/DALJES: SHKALLËZIMI I VIZIONIT TË ZHVILLIMIT

Në Fazën e Tretë do të përcaktohen konkluzionet dhe synimet e angazhimit për zhvillimin e dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021-2025. Duke qenë dokument i rishikuar, ai ka ndërtuar metodën bazë të rivlerësimit fillestar. Synimi kryesor është forcimi i veprimit shtetëror dhe administrativ për statusin e marrëdhënies midis Republikës së Shqipërisë dhe Diasporës Shqiptare. Ky moment i rëndësishëm përfaqëson cilësinë e fazës së tretë për rivlerësimin e vizionit afatgjatë të marrëdhënies me diasporën shqiptare për periudhën në vazhdim.

Kornizat dhe aktivitetet e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021-2025 janë projektuar për të ofruar më pas, shkallëzimin dhe rishikimin e ecurisë së çdo aktiviteti dhe çdo shtylle veprimi. Aktivitetet e Planit të Veprimit do të ofrojnë një bazë veprimi të planifikuar për institucionet përgjegjëse shtetërore. Ato janë të organizuara në mënyrë që këto institucione të arrijnë ta shkallëzojnë vizionin e tyre për zhvillimin dhe organizimin e aktiviteteve të reja për përfshirjen e diasporës.

Gjatë rishikimit përfundimtar të dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021-2025 rekomandohet një proces i cili do ta lejojë qeverinë shqiptare të largohet/tërhiqet nga qeverisja e strategjisë, kur kjo të jetë e aplikueshme. Kështu do të jetë e mundur që qeveria shqiptare dhe partnerët e tjerë të projektojnë fazën tjetër të kësaj strategjie dhe të përdorin komponentët e ndërgjegjësimit të ndikimit të saj për të shkallëzuar vizionin dhe synimet për angazhimin e diasporës.

Me procesin e shkallëzimit do të lindin presione të reja si në projektim, ashtu edhe në zbatim. Rekomandohet që brenda procesit të rishikimit të strategjisë, të prodhohet një strategji "daljeje" me disa hapa të cilët do ta lejojnë qeverinë dhe partnerët e saj të sigurojnë trashëgiminë për shkallëzimin e vizionit për zhvillimin për hapin tjetër të politikës shtetërore për diasporën shqiptare.

## PËRFUNDIMI

Në hartimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021-2025 sigurohet që transparenca dhe llogaridhënia të vazhdojnë të maturohen me zhvillimin e saj. Ai do të vetëkrijojë mekanizmin i cili do ta shtyjë përpara strategjinë drejt aplikimit dhe zhvillimit për t'u zbatuar bazuar mbi nevojat dhe mundësitë shtetërore të Republikës së Shqipërisë.

Qasja me tre faza në procesin e rishikimit ofrohet si udhërrëfyes, në mënyrë që kuadri i politikës shtetërore të plotësohet me frymën e bashkëpunimit institucional dhe me partnerët kombëtarë e ndërkombëtarë. Për këtë arsye, kjo shtojcë vetëvlerëson që veprimi i Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe Planit të Veprimit 2021-2025 të rrisin mundësitë e suksesit dhe vetëkorrigjimit duke u krijuar hapësira për të zhvilluar strategjinë e ardhshme në vitet në vijim.

Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i saj i Veprimit 2021-2025 është hartuar në mënyrë të tillë që të krijohet një kulturë pune, e cila bazohet në bashkëpunimin e institucioneve shtetërore për diasporën me institucionet e tjera përgjegjëse, si dhe partnerë të tjerë. Kjo në vetvete do të rrisë besimin e diasporës tek mekanizmat e zbatimit, gjë që do të kontribuojë tek zhvillimi dhe përfshirja e diasporës shqiptare për të ardhmen e kombit. E ardhmja është zgjedhje. Strategjia është rrugëtimi drejt saj.

## GRUPI NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS

Pandeli Majko
Ministri i Shtetit për Diasporën – Kryetar

Etjen xhafaj
Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme – Anëtar

Kostandin Shkurti
Zëvendësministri për Arsimin, Sportin dhe Rininë – Anëtar

Dajna Sorensen
Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë – Anëtar

Ornela Çuçi
Zëvendësministri për Turizmin dhe Mjedisin – Anëtar

Romina Kuko
Zëvendësministri i Brendshëm – Anëtar

Fjoralba Caka
Zëvendësministre e Drejtësisë – Anëtar

Bardhylka Kospiri
Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – Anëtar

Ermira Gjeci
Zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – Anëtar

Kestrina Ramallari
Përfaqësues i Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes – Anëtar

Meri Kumbe
Zëvendësministre e Kulturës – Anëtar

Irakli Koçollari
Përfaqësues i Akademisë së Shkencave – Anëtar

Elsa Dhuli
Titullari i INSTAT – Anëtar

Sonila Hysi
Titullari i Agjencisë Kombëtare të Diasporës – Anëtar



www.diaspora.gov.al